

Maj 2021
Numri: 158
E përnuajshme

Revistë edukative-kulturore - www.progresibotime.com

ETIKA

Shqipëri: 200 Lekë
Kosovë: 1.5 Euro
Maqedoni: 90 Den
Evropë: 7 Euro



**BOTA SHPIRTËRORE
E RINISË**




revistaetika



progresibotime

E çfarë mund të jetë tjetër
qëndrimi indiferent,
pandjenja dhe injorant përballë
mrekullive të pafundme
madhështore, që prej
grimcës më të vogël, e deri tek
trupi më i madh, prej botës
mikro, e deri në atë makro,
të cilat ndriçojnë më së miri
mendjen dhe zemrën,
përveçse një çoroditje
dhe falimentim i mendjes!?



Profeti (a.s.), thotë:

“Ditën e Kiametit asnjë rob
nuk do të bëjë qoftë edhe një hap
pa u pyetur se ku e ka kaluar jetën
e tij, se çfarë ka bërë me dijen e
tij, se ku e ka (tuar dhe shpenzuar
pasurinë e tij dhe se ku e ka
konsumuar trupin e tij.” (Tirmidhi,

Kiamet, 1/2417)

“Allahu i Madhëruar e do të riun e
pjekur, që nuk sillet si fëmijë, që
është drejtuar kah e mira dhe ka
braktisur dëshirat e kënaqësitë (e
ulëta të egos).” (Ahmed, IV, 151.)



Maj 2021

VITI: XV

NUMRI: 158

BOTUESI

Shtëpia botuese "Progresi"

DREJTOR

Albert Halili

KRYEREDAKTOR

Alban Kali

REDAKTOR

Zija Vukaj

PËRKTHYES

Albert Halili

Fatmir Sulaj

Ilir Hoxha

DIZAJN

Bledar Xama

ADRESA

Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"

Shkodër; Shqipëri

MOBILE

+355 67 340 6182

E-MAIL

rev.etika@gmail.com

WEBSITE

www.progresibotime.com

KOSOVË

Rr: Ardan Zurnaxhiu; pn. Ralin

Prizren; Kosovë

Mob: +377 45 639 143

Prishtinë; Kosovë

Mob: +377 44 566 577

MAQEDONI

Drvarska 28; Stara Carsija

Skopje; Maqedonija

Mob: +389 7145 6003

ABONIMI VJETOR

Shqipëri: 2000 lekë

Kosovë: 15 Euro

Maqedoni: 900 Denar

Evropë: 80 Euro

Ju bëjmë të ditur se materialet e sjella në redaksi pavarësisht nëse botohen apo jo nuk i kthehen autorit. Koha e botimit të një materiali përcaktohet nga redaksia. Honoraret e shkrimeve autoriale ose përkthimeve duhet të vini t'i tërhiqni pranë Shtëpisë Botuese "Progresi" ose pranë zyrave të përfaqësimit në Kosovë dhe Maqedoni.

Allahu Teala e ka krijuar njeriun me trup dhe shpirt. Shpirtin tonë e ka lidhur me zemrën në një formë që nuk mund t'ia kuptojmë të fshehtë. Për shkak se zemra ka këtë lidhje me shpirtin, është shndërruar në sinonim të shpirtit. Për këtë arsye, kur të themi dhimbja e zemrës, kemi si qëllim dhimbjen e shpirtit. Përndryshe ka shumë zemra të mbushura plot me besim dhe dritë edhe pse sipas mjekësisë janë të sëmura, ka edhe shumë zemra të tjera që fizikisht janë të shëndetshme, por që përbrenda janë të ndotura me mohim të fesë dhe rebelim ndaj Zotit. Aspekti shpirtëror i njeriut është aq i fshehtë sa që këtë nuk e kuptuan dot as engjëjt, as Iblisi që u ka dhënë mësim engjëjve. Engjëjt reagues duke thënë: "Përse e krijon njeriun ndërkohë që na ke ne?" Ndërsa Iblisi tha: "Unë jam krijuar nga zjarri. Kurse Ademi është krijuar nga dheu. Unë jam më i lartë se ai." Aspekti më interesant i kësaj çështjeje është se edhe vetë njeriu nuk ia di vlerën vetes së tij. Edhe pse është krijuar për pafundësinë dhe për të qenë mëkëmbësi i Zotit, e ka braktisur atë detyrë të madhe dhe është zhytur në punë krejt të thjeshta. Për të shpëtuar nga këto përzgjedhje të gabuara mistikët e kanë konsideruar të domosdoshme që njeriu ta njohë qëllimin e krijimit dhe veten e tij. Ndërmjet mistikëve është bërë e famshme kjo fjalë e urtë: "Ai që e njeh veten, e njeh edhe Zotin."

Shekulli ynë nga njëra anë po dëshmon çdo ditë që kalon zbulimin e të fshehtave në lidhje me aspektin fizik dhe mjekësor të njeriut dhe nga ana tjetër po bën sehir ndaj shtimit të injorancës në lidhje me strukturën shpirtërore të tij (njeriut). Njeriu modern dhe veçanërisht të rinjtë po i konsumojnë të gjitha energjitë e tyre pas karrierës dhe dëfrimeve momentale. Ndërsa plotësimin e nevojave shpirtërore po e lënë për në vitet e pensionit. Për shkak të kësaj, natyrisht që zemra po ngurtësohet ngaqë nuk i është dhënë ushqimi i vet dhe nuk është shfaqur kujdes ndaj saj. Si rrjedhojë, po e humbet shëndetin shpirtëror.

Esenca e të gjitha ushqimeve që hamë është dheu. Kurse ata që ushqehen vetëm me dhe, e humbin gjallërinë e tyre. Njeriu në të njëjtën kohë duhet të ulet edhe në sofrën e njerëzve të devotshëm dhe duhet të marrë prej tyre ushqime shpirtërore. Sepse njerëzit e devotshëm që janë miq të Allahut (xh.xh.), e ngjallin shpirtin tonë me ligjëratat e tyre. Kur shpirti të fitojë gjallëri, edhe trupin arrin prehjen. Në të kundërt, njerëzit do të presin te dera e psikologëve dhe psikiatristëve duke përjetuar kriza psikologjike siç i shohim shpesh përgjatë ditëve të sotme. Ndërkohë që përpiqen të mbrojnë trupat, ua shesin shpirtat shejtanit.

Nëse e privojmë shpirtin nga këto ushqime për të cilat ka nevojë, do të kemi dhimbje të mëdha. Shpirti, të cilit nuk i është plotësuar kjo nevojë, na paralajmëron në formën e shqetësimeve, fobive dhe depresioneve. Nëse i marrim parasysh këto paralajmërime në kohën e duhur, mund të bëhet një kapërcim shpirtëror dhe kështu mund ta arrijmë prehjen e paqen që na e ka premtuar Zoti (xh.xh.). Sepse Allahu i Lartësuar në Librin Fisnik të Tij na njofton se nuk ka frikë e pikëllim për miqtë e Tij dhe se ata gjenden në një prehje të madhe shpirtërore. (Shik. Junus, 62.)

Përmbajtja

Jahja (a.s.) si një model i rinisë
Murat Kaja

17



10

Dhembjet shpirtërore të rinisë
Prof. dr. Sulejman Derin



Brezi i ri, brezi i vjetër
Ali Riza Temel

14




12



Festa e vërtetë
Osman Nuri Topbash

34

- 5 Hixhret nga robëria e botës virtuale
drejt vendeve të vërteta
Mehmet Lutfi Arslan
- 12 Vlera të pastra për botën
e pastër të të rinjve
Doç. dr. Kerim Bulladë
- 20 Koha për të nisur rrugën
Selim Ajdën
- 22 Para se të vijë dita e pendimit
Ajdën Tallaj
- 24 Jeta që nuk vihet në pyetje
nuk është e jetuar
Mehmet Bash
- 25 Siratu'l Mustekim
Rabia Brodbeck
- 28 Trajtimi me drejtësi dhe ndërgjegje
M. Sami Ramazanollu



44

Religjioni dhe civilizimi 29

Ali Byjyqçapar

Çfarë mbetet dhe çfarë harrohet? 30

Nuredin Jëlldëz

Një Ajet 32

Rinia dhe koha e seherit 39

Sadik Dana

Një shkrim me pikëpyetje 42

Neslihan Nurturk

Marrëdhënia ndërmjet devotshmërisë 44

dhe udhëzimit në Kuran

Durak Pusmaz

Mbi natyrën e vërtetë të lumturisë 46

Shah Velijullah Dehlevi


Përballë zgjidhjes së infektuar 48

M. Ali Eshmeli

Ajo që fitojmë dhe humbasim 54

Ajla Agabegym

40



Besimtarët e përgëzuar me "Selam-Paqe"
Xhafer Durmush

Mëshira e Profetit (a.s.)
Naim Drijaj

52

SI MUND TË SHPËTOJË RINIA E INTERNETIT?

Hixhret nga robëria e botës virtuale drejt vendeve të vërteta

— Mehmet Lutfi Arslan —

Rinia gjithmonë vlerësohet me klishe të caktuara. Të bëhesh si i çmendur, të mos e pëlqesh të përhershmen, të shfaqësh sjellje kontradiktore dhe të veprosh pa e llogaritur fundin... Pothuajse të gjitha këto klishe janë të vërteta. Përfundimisht, ngaqë rinia është një periudhë përgjatë zhvillimit të njeriut, te të gjithë shfaqet me qëndrime dhe sjellje të ngjashme. Çdo i pjekur që ia ka dalë mbanë për ta analizuar sadopak qoftë rininë e tij, nuk e ka të vështirë nga ky aspekt që të formojë marrëdhënie

me të rinjtë. Por sigurimi i vazhdimësisë dhe cilësisë së kësaj marrëdhënieje është i lidhur ngushtë me të kuptuarin e mundësive dhe problemeve specifike të secilit brez. Ndryshimet që burojnë nga ndryshimi i kohës e ndajnë çdo brez nga të tjerët. Klishtë edhe pse janë të vërteta në një përqindje të madhe, çdo brez i neglizhon kushtet specifike dhe cilësitë e veçanta që i përkasin. Në fakt, ato që e bëjnë interesante historinë e tensionuar ndërmjet të mëdhenjve dhe të rinjve dhe që i bëjnë të pangjashëm njëri me tjetrin janë ndryshimet specifike dhe të veçanta që u përkasin brezave të tyre. Andaj një marrëdhënie e përhershme dhe një miqësi produktive e bëjnë të nevojshme njohjen e këtyre, pasjen kujdes ndaj këtyre dhe marrjen parasysh të këtyre në mënyrë të vazhdueshme.

KATËR BREZA TË NDRYSHËM

Mirë, por si mund t'i njohim këto cilësi specifike nëse secili brez ka cilësitë specifike të tij? Ndryshimet në qëndrime dhe në sjellje ndërmjet brezave janë bërë temë e shumë studimeve shkencore. Këto ndryshime shkurtimisht konsistojnë në përgjithësime të caktuara rreth qasjes, mendimeve dhe ndjenjave ndaj kësaj bote të secilit brez. Gjëja që e zgjedh dhe fakti se përse e zgjedh çdo brez është një fushë që e do dhe përvetëson shumë marketingu modern. Studimet e bëra në këtë fushë mbështeten te analiza afatgjata dhe demografike shumë dimensionale. Burimi themelor i frymëzimit të këtyre studimeve që shumica prej tyre janë me bazë në SHBA, flasin rreth faktit se çfarë lloj sjelljesh konsumatore nxjerrin në pah ndryshimet që lindin ndërmjet brezave që ndjekin njëri-tjetrin. Sipas këtyre studimeve që synojnë të bëjnë një analizë të konsumatorit dhe tregut në kuptimin përfundimtar, brezat që kanë dalë në pah përgjatë procesit të këtyre shtatëdhjetë viteve të fundit mund të radhiten si më poshtë:



1. Brezi me rekord lindjesh (ata që kanë lindur ndërmjet viteve 1946-1970)

2. Brezi X (ata që kanë lindur përgjatë viteve 1970)

3. Brezi Milenium (ata që kanë lindur përgjatë viteve 1980)

4. Brezi i internetit (ata që kanë lindur pas viteve 1990)

Me thënë të drejtën, ky klasifikim me burim përndimor mund të diskutohet sesa përputhet me shoqërinë dhe kulturën tonë. Si një vend që nuk ka marrë pjesë në luftën e dytë botërore (Turqia), mund të themi se klasifikimi i mësipërm nuk përputhet me ne që në nenin e parë. Brezi me rekord lindjesh është një emërtim që u është vënë fëmijëve të atyre që janë kthyer nga lufta. Po ashtu edhe nenin e dytë mund të eliminojmë duke u nisur nga fakti se trauma që shkaktoi një luftë e cila e dogji dhe e shkatërroi perëndimin, ndikoi jo vetëm te fëmijët e luftëtarëve, por edhe te nipërit e tyre. Për ata që kanë lindur përgjatë viteve 1970, mund të hetojmë sesi e kemi neglizhuar ndikimin e përplasjeve ndërmjet të djathtës dhe të majtës që u përjetua te ne në atë periudhë. Madje mund të themi se një klasifikim i tillë që na përket ne duhet të bëhet duke marrë parasysh procesin që filloi me luftën e Pavarësisë. Edhe nëse këto i konsiderojmë të gjitha të sakta dhe nëse e injorojmë klasifikimin e brezave me bazë perëndimin, është e pamundur që ta injorojmë cilësimin e bërë për ata që kanë lindur në vitin 1990 dhe më vonë, sepse ndryshimi dhe transformimi që ka pësuar brezi në fjalë e ka dhënë të njëjtin rezultat pothuajse në çdo vend të rruzullit tokësor. Brezi që ka lindur pas vitit 1990 është brezi i internetit. Ky brez është formuar me globalizmin, me kulturën e konsumit që ka ndikuar negativisht dhe që u ka dhënë formë të gjithëve dhe me marifetin e medias. Ky brez ka formuar vetë rininë aktuale si brezi që reflekton të njëjtat veçori për një kohë të gjatë pa njohur ndonjë ndryshim fetar, kombëtar dhe kulturor.

Sipas studimit “Rinia 2017 bazuar në Statistika” i Institutit të Statistikave të Turqisë (TÜİK) që u botua në mes të vitit 2018, më shumë se 16 % e popullsisë së Turqisë përbëhet nga të rinjtë ndërmjet moshave 15-24 vjeçare. Në këtë grup që formohet afërsisht nga 13 milionë njerëz, ata që kanë lindur më herët kanë ardhur në këtë botë në vitin 1995. Për këtë arsye, ajo që mund ta themi në lidhje me këtë brez që më i madhi i tij është 24 vjeç, është e qartë: Të gjithë të rinjtë tanë janë brezi i internetit sipas klasifikimit të mësipërm. Po ashtu, sipas një rezultati tjetër të të njëjtit studim, ndërkohë që përdorimi i internetit nga kjo grup moshë ishte 87.5 përqind në vitin 2016, në vitin 2017 ishte ngritur në 90 përqind. Edhe marrëdhënia që ka ky brez me teknologjinë e telefonit inteligjent që akoma ka një të kaluar prej dhjetë viteve, është shumë interesante. Sipas studimeve të bëra, këta të rinj kalojnë afërsisht 5 deri në 9 orë në ditë me telefonat e tyre.

FËMIJËT E TRI LËVIZJEVE (VEPRIMEVE)

Rinia e ditëve të sotme apo Brezi i Internetit sipas klasifikimit të mësipërm, ka formuar terren për daljen në pah të një brezi që posedon cilësi të ngjashme në të gjitha shoqëritë që kanë arritur një shkallë të caktuar zhvillimi. Cilësia dalluese që e bën të ndryshëm këtë brez nga të tjerët është marrëdhënia me teknologjinë dixhitale. Brezi i internetit, më shumë sesa fakti që e njeh më mirë teknologjinë e re në krahasim me brezat e tjerë, posedon një lloj rehatie dhe privilegji që ia ka dhënë fakti se kanë lindur në mes të teknologjisë. Siç nuk e njeh realitetin e ujit një peshk që jeton në ujë, edhe këta të rinj nuk mund ta mendojnë privimin nga teknologjia e lartë në të cilën gjenden. Këta të rinj që as nuk e çojnë ndërmend eksperiencën e një jete pa internet, shihet qartë se janë shumë më pak të përgatitur ndaj vështirësive në krahasim me prindërit e tyre që janë rritur me ndërprerjen e rrymës elektrike. Por fakti se e njohin kaq mirë teknologjinë, është e vërtetë se ka formuar te ata një këndvështrim, arsyetim dhe imagjinatë krejt tjetër. Ata nuk i shohin si prindërit e tyre botën, veten dhe marrëdhëniet. Ky ndryshim nuk buron nga përplasia e natyrshme e brezave, por nga vendi që ka pushtuar në jetën e këtyre të rinjve tragjedia e shekullit, teknologjia. Ja pra, kjo është pika që i ka bërë anormalë këta të rinj dhe marrëdhëniet me ta.

Dallimi ndërmjet këtij brezi që quhet “vendasit dixhitalë” dhe të tjerët, domethënë “të shpërngulurit dixhitalë” është ky: Ata (brezi dixhital) beson se bota ndryshon me tri lëvizje. Të lexosh, të vështrosh, të kontaktosh, të hash, të pish, të bësh allishverish, shkurtimisht, të bësh punë të çdo lloji në çdo fushë të kësaj jete duke u nisur nga këto tri lëvizje që janë klikimi, tërheqja zvarrë dhe zmadhimi, a mund të



thuhet se të rinjtë nuk kanë të drejtë? Me thënë të vërtetën, të rinjtë kanë të drejtë dhe e drejta e tyre do të shtohet sa më shumë që teknologjitë dixhitale të sundojnë çdo fushë të jetës së tyre. Zhvillimet që bëhen shkak shumicën e rasteve për mahni dhe çudi te të shpërngulurit dixhitalë, janë shndërruar në një fenomen të zakonshëm dhe të domosdoshëm për të rinjtë e internetit. Ja që shqetësimi për t'u përputhur me shpejtësinë dhe diversitetin e kësaj bote i preokupon ata aq sa t'i ndalojë për të bërë ndonjë punë apo për t'u marrë me ndonjë gjë tjetër. Andaj ata janë të dënuar ndaj shterpësisë që mund të përkufizohet vetëm me teknologjinë.

CILËSITË E TË RIUT TË INTERNETIT

I riu i internetit është aq afër saqë mund të arrihet me tri lëvizje, por në të njëjtën kohë është aq larg saqë mund të dalë duarsh dhe nga zemra po me tri lëvizje. Dinamika më dalluese e jetës së këtyre të rinjve që marrin cilësi të reja me çdo mjet, kurs, program e përditësim dhe që nuk merren dot vesh lërinë me prindërit, por as me vëllezërit dhe motrat e tyre ngaqë janë ballë për ballë me më shumë dije që prodhohet brenda dy viteve në aventurën e të gjithë njerëzimit, është marrëdhënia e tyre me teknologjinë. Teknologjia, e cila mund të emërtohet si fitneja e ditëve të sotme, është faktori më kryesor që i cakton cilësitë specifike për këtë brez. Profesori i psikologjisë, Jean M. Tëenge këto cilësi i radhit si më poshtë duke u mbështetur te data-base Monitorimi i së Ardhmes (Monitoring the Future) që ka filluar të ndërtohet në vitin 1975 në Universitetin e Michiganit dhe që ndjek besimin, sjelljet dhe zakonet më të paktën e 50.000 të rinjve që nga ai vit e deri më sot:

1. Piqen vonë dhe mbeten të varur për një kohë më të gjatë ndaj prindërve
2. Kalojnë pesë orë apo më shumë kohë në ditë përballë ekranit
3. Bisedat dhe komunikimet dëshirojnë t'i bëjnë jo ballë për ballë, por në botën virtuale
4. Ndjehen të vetmuar dhe të braktisur
5. Interesi ndaj fesë dhe përshpirtshmërisë sa vjen dhe u pakësohet
6. Shfaqin më shumë kujdes ndaj rregullit ngaqë kanë shumë shqetësime për sigurinë
7. Qëndrojnë larg martesës
8. Posedojnë një këndvështrim më tolerant dhe liberal kundrejt çështjeve të shoqërisë

Pamundësia për t'u rritur, asocializimi, vetmia, psikologjia: "Rroftë një mijë vjet gjarpri që s'më prek mua." – dhe shqetësimi... Nga ana tjetër, një tolerancë e pabazë kundrejt të gjithëve dhe ndaj çdo gjëje dhe një mosbesim interesant kundrejt të gjithë-

ve dhe çdo gjëje... Cilësitë në fjalë të të rinjve që formohen me internet, tregojnë se teknologjia për ata është shndërruar në një qëllim më shumë sesa një mjet. Si çdo gjë që kthehet në të kundërt kur e tepron, edhe teknologjia është bërë shkak që të rinjtë të vetmohen dhe të shndërrohen në tipa asocialë ndërkohë që do të mundësonte socializimin duke i hequr pengesat e komunikimit. Të rinjtë që përpiqen për ta arritur kënaqësinë e lumturinë dhe për ta plotësuar nevojën e komunikimit nëpërmjet medias sociale, po shndërrohen në skllavë të një bote mashtruese me identitete false dhe përmbajtje të ulëta. Edhe pse kjo botë mashtruese reklamohet si alternativë ndaj bashkëveprimeve natyrale dhe të vërteta, sikundër asaj që premton, është një vetmi që e kalb socializimin dhe prodhon izolim e pakënaqësi. Sprova e këtyre të rinjve që zgjedhin rehatinë, palodhshmërinë dhe qetësinë e socializmit në fjalë në vend të vështirësisë dhe përpjekjes që kërkojnë marrëdhëniet e vërteta njerëzore, është teknologjia të cilën po e përdorin më shumë se gjithë të tjerët.

TEKNOLOGJIA ËSHTË FITNE

Teknologjia me shpejtësinë, orientimin dhe intensitetin e saj po nxjerr në pah një stil jetese brenda dhe drejt vetes. Kjo i bën të pakuptimta përpjekjet e tjera. Marrëdhënia e të rinjve me teknologjinë i lë në hije qëllimet e krijimit të tyre siç janë realizimi i potencialeve të tyre, gjetja e vullnetit të tyre dhe zbulimi se pse janë një plus në këtë botë. Teknologjia dhe veçanërisht media sociale e imponojnë veten si një vlerë, një qëllim dhe mrekulli. Nisur nga ky këndvështrim, ajo po qëndron përballë të rinjve si burimi i fitnes më të madhe. Fitne do të thotë diçka që është çështje sprove. Teknologjia në këtë kontekst është pengesa më e madhe për të rinjtë ngaqë nuk i lejon ata ta zhvillojnë veten. Për shkak se kjo pengesë i ka rrethuar ata nga të gjitha anët, është e pamundur të mos vihet re sesa të vështirë e kanë punën të rinjtë. Mirë, por çfarë duhet të bëjmë atëherë?

Gjëja e parë që duhet të bëjmë është që t'ua mundësojmë atyre të shpërngulen nga bota virtuale në botën reale. Ata që ia japin vendit nderin, cilësinë dhe vlerën, nëse mund të shprehemi me gjuhën e të rinjve, janë ata që gjenden në atë vend. Për t'ua mundësuar të rinjve socializimin e vërtetë duhet që t'ua mundësojmë atyre të formojnë marrëdhënie reale, të vërteta dhe të drejtpërdrejta me njerëz dhe



personalitete shembullore. Duket qartë se duhet të shtohet tërheqja e të mirës, të vërtetës dhe të bukurës, në mënyrë që vendin e marrëdhënieve të vërteta të mos e zërë bota virtuale, false dhe mashtruese. Aftësia më e madhe e sistemit të ri të komunikimit është se ai mund ta lustronjë e prezantonjë të njohurën nga masat e gjera dhe ta shfaqë gjënë e ulët si rrezatuese. Mundësia dhe avantazhi që kemi ne është që të kthehemi mbrapa te bota e marrëdhënieve reale. Shijen e të vërtetës sonë mund ta kuptojmë vetëm nëpërmjet gjendjes dhe transformimit të kësaj gjendjeje mund ta realizojmë me partneritete cilësore dhe të qëllimshme. Andaj duhet t'i shtojmë takimet e mirëfillta, sublime e të dobishme dhe nevojat e të rinjve për edukim, socializim dhe marrëdhënie nuk duhet t'i lëmë në dorën e sistemit të komunikimit që ka dalë në pah nëpërmjet fitnes teknologjike. Andaj median sociale dhe portalet e ngjashme duhet t'i përdorim në mënyrë të kufizuar, nuk duhet t'i konsiderojmë ato si sisteme që na mbartin drejt marrëdhënieve reale dhe mund t'i pranojmë si të vlefshme përdërisa nuk e kalojnë cilësinë e të qenët mjet. Ne duhet t'u japim alternativa të tjera të rinjve që nuk njohin metodë tjetër të socializimit përveç mjeteve teknologjike. Andaj duhet t'i orientojmë ata drejt vendeve të treta cilësore dhe të dobishme përveç shtëpisë dhe shkollës. Sprova më e madhe e të rinjve të internetit është bota magjepsëse virtuale në të cilën kanë lindur. Ata nuk dëshirojnë të dalin jashtë kësaj bote, sepse nuk ndjejnë nevojë për ndonjë alternativë tjetër. Mirësia më e madhe që mund t'u bëhet këtyre të rinjve është që t'i vetëdijësojmë për ekzistencën e vendeve të vërteta alternativë, për nevojën që ata kanë ndaj këtyre dhe për kënaqësinë që mund t'u falin këto vende. Atyre duhet t'u tregojmë se zhvillimi dhe pjekuria e vërtetë arrihen nëpër këto vende. Se çfarë funksionesh mund të kenë vendet alternativë që do të jenë kundërhelmi i botës virtuale me gjithë kënaqësinë, lumturinë dhe singëritetin që të falin, mund ta kuptojmë nëpërmjet shembullit të "shpellës".

SHPËTIMI ËSHTË TE SHPELLA

Një sure e Librit tonë të Shenjtë, Kuranit Fisnik, është surja Kehf, domethënë shpella. Shpella ishte një vend i qetë në të cilin u strehuan një grup të rinjsh besimtarë që kishin ikur nga e keqja e një mbreti zullumqar dhe shoqërie të tillë që kishin devijuar nga tevhidi. Të rinjtë që Zoti (xh.xh.), i vendosi në gjumë aty për 300 vite radhazi, kaluan

nga devijimi në udhëzim, nga humbja në urtësi dhe nga mëkati në mëshirë. Vullneti për të mos u kapluar nga rrjedha e një bote në të cilën kishin lindur, i orientoi ata drejt kërkimit të një bote alternativë. Ja pra, shpella në këtë kontekst iu tregua atyre si një alternativë shpëtimi. Ata të rinj që Kurani Fisnik i emërton si djelmosha (trima), falë vendosmërisë dhe dinamizmit të tyre, u mbrojtën me anë të gjumit në një vend alternativë në të cilin ishin strehuar për shkak të popullit të tyre femohues. Ata u zgjuan në një kohë të pastër, të dëlirë dhe të çiltër pas një segmenti kohor për të cilin nuk ishin të vetëdijshëm sesi kishte kaluar.

Të rinjtë që kanë lindur në ambientin e internetit duhet të bëjnë kërkime për një botë tjetër alternativë të cilës mund t'i drejtohen, në mënyrë që ta shpëtojnë besimin e tyre. Ata që do t'u zgjojnë atyre këtë dëshirë, kërkesë dhe nevojë së pari janë të mëdhenjtë dhe të afërmit e tyre. Nëse shfaqet një herë dëshira dhe vullneti për të kaluar nga bota virtuale, e përkohshme dhe false te ajo e vërteta dhe e përhershme, shpella që do t'i mbrojtë të rinjtë nga fatkeqësia e humbjes së kohës do të hapet vetvetiu dhe ajo shpellë do të shndërrohet në një vend ringjalljeje si Kehfi dhe Hira. Shpella në fakt është një anti-dynja kundër kësaj bote që dëshiron t'i bëjë edhe të rinjtë virtualë dhe fals si vetja. Shpella është atmosfera dhe kushtet e të qenët një njeri që e do Zoti (xh.xh.) dhe Pejgamberin tonë të Nderuar (s.a.s.).

Shpella është e vërteta që qëndron në këmbë kundër asaj virtuale. Ajo është burimi i trimërisë dhe emri i mosprishjes. Është adresa e thjeshtësisë, vërtetësisë, dëlirësisë dhe pastërtisë. Shpella është shkolla e urtësisë dhe tevhidit. Çdo kuvend që është i mbrojtur nga erërat e femohimit dhe në të cilin fryn flladi hyjnor mund ta quajmë shpellë. Shpella është çdo rrugë që na e shpjegon nga dritarja e Zotit se përse gjendemi në këtë botë. Shpella është atmosfera në të cilën mund të frymohet përsëritshmëria e asaj lidhjes sublime dhe specifike vetëm për ne që duhet ta formojmë me Zotin (xh.xh.). Shpella është kuvend, është shërbim fetar, është dashuri, është respekt, është shqetësim dhe është përpjekje për hatër të Allahut (xh.xh.). Shpella është revistë, është shoqatë, është faltore. Shpella është mik, është takim me miqtë. Shpella është ai flladi i frymëzimit që e bën zemrën të rrahë fort në çdo takim dhe që e zgjeron kraharorin. Ajo është një vend në të cilin nuk mund t'ia dalë mbanë asnjë metodë virtuale.



Të rinjtë që janë ushtruar me kënaqësinë, programimin e shpejtësisë, fushën e interesimit dhe atmosferën shpërqendruese të botës virtuale, në fillim mund ta shohin shpellën si të mërzhitshme dhe të bezdisshme. Emri i këshillimit i të tjerëve për të vërtetën dhe durimin në ditët e sotme është përpjekja dhe mundi për t'i bërë të rinjtë të vetëdijësohen në lidhje me prehjen shpirtërore të shpellës kundrejt magjepsjes së botës virtuale. Nëse sprova e të rinjve është kurthi virtual në të cilin kanë rënë, atëherë sprova e të rriturve është që t'i vetëdijësojnë të rinjtë për këtë kurth dhe të përpiqen për t'ua bërë të dashura të rinjve vendet alternativë. Nëse e pranojmë se ai që dëshiron të bëhet njeri duhet të fillojë ta kërkojë shpellën, atëherë duhet ta dimë edhe këtë se ai që dëshiron t'i bëjë njerëz të tjerët duhet të dijë se si ta shndërrojë në alternativë shpellën që do ta propozojë kundër magjepsjes shpërqendruese të botës virtuale.

Çdo vend në të cilin shkohet, vihet, takohet dhe bisedohet për hatër të Allahut Teala, çdo punë që bëhet e kryhet, çdo shkak dhe aktivitet, çdo gjë që mund të na vijë në mendje dhe që bëhet për hir të Zotit, duhet të jetë e pjekur, e këndshme dhe e mirëfilltë deri në atë masë sa që të jetë derman për kurthin e botës virtuale të të rinjve si një shpellë në të cilën mësohet trimëria dhe mëshira. Rruga e vetme për t'i shpëtuar të rinjtë e internetit nga atmosfera virtuale që është programuar për t'i shndërruar ata në konsumatorë, është shtimi i numrit të këtyre shpellave në të cilat të rinjtë do të ndjejnë prehje shpirtërore sa herë që të hyjnë dhe të dalin. Sa më shumë që të shtohen këto shpella dhe sa më shumë që të jetë cilësore koha të cilën të rinjtë do ta kalojnë aty, aq më shumë do të jetë e mundur që të rinjtë tanë të shpëtojnë nga atmosfera false, e bezdisshme dhe e ulët e botës virtuale.

Shënime: Jean M. Twenge, i-Nesli / Brezi i Internetit, Kakmüs, 2018.



Nënat dhe baballarët duhet ta vrasin mendjen se përse është shndërruar në një fatkeqësi teknologjia të cilën tashmë e quajmë fitneja e shekullit. Ata duhet të posedojnë një mënyrë të përdoruri me maturi deri në atë masë sa që të mos preken nga kjo fatkeqësi. Gjithashtu duhet të ndjekin me përkushtim se çfarë lloj interaktiviteti kanë nxjerrë kanalet e mediave sociale.

Ata duhet ta dinë që udhëtimet virtuale të fëmijëve dhe të rinjve kërkojnë më shumë vigjilencë sesa dërgimi i tyre jashtë shtëpisë ose vendit, dhe masat paraprake duhet të merren në përputhje me këto rrethana.

Përdorimi i internetit duhet të bëhet në orë të caktuara dhe duhet të kufizohet me rregulla si përdorimi i përbashkët nga e gjithë familja. Fëmijëve nën moshën gjashtë vjeçare nuk duhet t'u jepen telefona inteligjentë, tabletë dhe mjete të tjera të ngjashme me këto.

Fëmijët dhe të rinjtë duhet të drejtohet te vendet, shoqëritë dhe mjediset në të cilat do të përjetojnë një bashkëveprim alternativë dhe të vërtetë. Aty duhet të takohen me njerëz më të mëdhenj që janë shembull në personalitet dhe karakter. Kështu duhet t'u mundësohet që të kalojnë një kohë sa më cilësore.

Të rinjtë nuk duhet të lihen në ndërgjegjen e tipave që në rrjetet e mediave sociale quhen fenomene apo siç mund t'i quajmë ndryshe, tipa që nuk kanë punë tjetër përveçse të preokupohen me gjëra të pavlera. Prindërit duhet të bëjnë kujdes së me kë kalojnë kohë të rinjtë në median sociale. Ata duhet t'i hetojnë sitet ky hyjnë të rinjtë dhe lojërat që bëjnë. Bazuar në këto, duhet të vendosin edhe kufizimet e përshtatshme.

Të rinjtë duhet të këshillohen shpesh se rregullat e edukatës dhe privatësisë që janë të vlefshme në jetë duhet të zbatohen edhe në median sociale. Atyre gjithmonë duhet t'ua kujtojmë se herët apo vonë do të kenë një faturë që do t'u shkaktojë dhimbje apo pendim për shkak të klikimeve dhe vizitave të bëra pa kriter nëpër site të panjohura.

Ne duhet t'i kërkojmë dhe t'i gjejmë ata që prodhojnë site alternative në mediat sociale dhe botët e tjera virtuale, veçanërisht duhet të nxjerrim në plan të parë site që janë të dobishme për fëmijët e të rinjtë dhe duhet të kontribuojmë që këto site të mbështeten, në mënyrë që të jenë të dobishme dhe produktive.

DHIMBJET SHPIRTËRORE TË RINISË

— Prof. dr. Sulejman Derin —

Allahu Teala e ka krijuar njeriun me trup dhe shpirt. Shpirtin tonë e ka lidhur me zemrën në një formë që nuk mund t'ia kuptojmë të fshehtë. Për shkak se zemra ka këtë lidhje me shpirtin, është shndërruar në sinonim të shpirtit. Për këtë arsye, kur të themi dhimbja e zemrës, kemi si qëllim dhimbjen e shpirtit. Përndryshe ka shumë zemra të mbushura plot me besim dhe dritë edhe pse sipas mjekësisë janë të sëmura, ka edhe shumë zemra të tjera që fizikisht janë të shëndetshme, por që përbrenda janë të ndotura me mohim të fesë dhe rebelim ndaj Zotit. Aspekti shpirtëror i njeriut është aq i fshehtë sa që këtë nuk e kuptuan dot as engjëjt, as Iblisi që u ka dhënë mësim engjëjve. Engjëjt reagues duke thënë: “Përse e krijon njeriun ndërkohë që na ke ne?” Ndërsa Iblisi tha: “Unë jam krijuar nga zjarri. Kurse Ademi është krijuar nga dheu. Unë jam më i lartë se ai.” Aspekti më interesant i kësaj çështjeje është se edhe vetë njeriu nuk ia di vlerën vetes së tij. Edhe pse është krijuar për pafundësinë dhe për të qenë mëkëmbësi i Zotit, e ka braktisur atë detyrë të madhe dhe është zhytur në punë krejt të thjeshta. Për të shpëtuar nga këto përzgjedhje të gabuara mistikët e kanë konsideruar të domosdoshme që njeriu ta njohë qëllimin e krijimit dhe veten e tij. Ndërmjet mistikëve është bërë e famshme kjo fjalë e urtë: “Ai që e njeh veten, e njeh edhe Zotin.”


Shekulli ynë nga njëra anë po dëshmon çdo ditë që kalon zbulimin e të fshehtave në lidhje me aspektin fizik dhe mjekësor të njeriut dhe

nga ana tjetër po bën sehir ndaj shtimit të injorancës në lidhje me strukturën shpirtërore të tij (njeriut). Njeriu modern dhe veçanërisht të rinjtë po i konsumojnë të gjitha energjitë e tyre pas karrierës dhe dëfrimeve momentale. Ndërsa plotësimin e nevojave shpirtërore po e lënë për në vitet e pensionit. Për shkak të kësaj, natyrisht që zemra po ngurtësohet ngaqë nuk i është dhënë ushqimi i vet dhe nuk është shfaqur kujdes ndaj saj. Si rrjedhojë, po e humbet shëndetin shpirtëror.

Esenca e të gjitha ushqimeve që hamë është dheu. Kurse ata që ushqehen vetëm me dhe, e humbin gjallërinë e tyre. Njeriu në të njëjtën kohë duhet të ulet edhe në sofrën e njerëzve të devotshëm dhe duhet të marrë prej tyre ushqime shpirtërore. Sepse njerëzit e devotshëm që janë miq të Allahut (xh. xh.), e ngjallin shpirtin tonë me ligjëratat e tyre. Kur shpirti të fitojë gjallëri, edhe trupin arrin prehjen. Në të kundërt, njerëzit do të presin te dera e psikologëve dhe psikiatristëve duke përjetuar kriza psikologjike siç i shohim shpesh përgjatë ditëve të sotme. Ndërkohë që përpiqen të mbrojnë trupat, ua shesin shpirtrat shejtanit.

Nëse e privojmë shpirtin nga këto ushqime për të cilat ka nevojë, do të kemi dhimbje të mëdha.

Shpirti, të cilit nuk i është plotësuar kjo nevojë, na paralajmëron në formën e shqetësimeve, fobive dhe depresioneve. Nëse i marrim parasysh këto paralajmërime në kohën e duhur, mund të bëhet një kapërcim



shpirtëror dhe kështu mund ta arrijmë prehjen e paqen që na e ka premtuar Zoti (xh.xh.). Sepse Allahu i Lartësuar në Librin Fisnik të Tij na njofton se nuk ka frikë e pikëllim për miqtë e Tij dhe se ata gjenden në një prehje të madhe shpirtërore. (Shik. Junus, 62.)

Bazuar në këto që thamë më sipër, krizat që i shohim në shoqëri dhe veçanërisht te të rinjtë, janë të rëndësishme nga aspekti për të treguar se diçka funksionon gabim. Ndoshta në këtë mënyrë përpqemi për të gjetur zgjidhjen e gjërave që funksionojnë gabim. Në fakt, rinia është një mundësi që Allahu ia ka dhënë njeriut. Nëse prindërit, mësuesit dhe udhëheqësit i orientojnë në mënyrë të mirëfilltë të rinjtë, vitet e rinisë janë baza e përsosjes shpirtërore. Imam Rabbani e shpjegon kështu këtë gjendje në Mektubatin e tij:

“Periudha e rinisë është koha e fitimit. Ai që është i zgjuar e di vlerën e kësaj kohe, nuk e çohet dhe e shfrytëzon. Ndoshta nuk është kështu për të jetuar deri në periudhën e pleqërisë. Edhe nëse është kështu për të jetuar deri atëherë, trupit nuk i mbetet fuqi dhe prehje shpirtërore nuk ka. Edhe nëse është kështu për të jetuar deri atë periudhë, në kohën e pleqërisë nuk mund të bëhen punë të dobishme. Ndërkohë që sot trupi dhe mendja janë funksionale, ndërkohë që ekzistenca e prindërve është një mirësi e madhe, ndërkohë që nuk kemi shqetësimin për sigurimin e jetesës ngaqë kjo barrë është mbi supet e prindërve, ndërkohë që jemi në kohën e mundësisë dhe fuqisë, me cilin pretekst puna e sotme mund të lihet për nesër? Si mund të thuhet: “E bëj nesër?” I Dërguari i Allahut (s.a.s.), ka thënë: “Ai që thotë e bëj nesër, është shkatërruar.” (Dejlemi, el-Firdevs, 2420.) Nëse punët e kësaj bote i lë për nesër dhe sot bën punët e ahiretit, kjo është diçka e bukur.”

Prej këtyre fjalëve të Imam Rabbanit kuptojmë se ai sikur i ka parashikuar problemet e të rinjve të sotëm. Sepse sot rinia i ka shndërruar në qëllim të vetëm punët e kësaj bote dhe po i nënvlerëson punët e botës tjetër. Të rinjtë tanë po e kërkojnë kënaqësinë në batakun e drogës, dëfrimit dhe argëtimit ngaqë nuk ushqehen shpirtërisht. Mevlana u thotë kështu të rinjve që e shpëtojnë veten nga fitnet e kohës dhe i drejtohen Zotit (xh.sh.):

“Lum për atë njeri që e konsideron si pasuri periudhën e rinisë dhe e paguan borxhin e tij. Këtë punë mund ta kryejë me sukses përgjatë ditëve kur është i fuqishëm e i shëndetshëm dhe përgjatë kohëve kur është i fortë, sepse periudha e rinisë jep fryte pa reshtur si një kopsht i gjelbër dhe i freskët. Njeriut të ri i rrjedhin vazhdimisht çezmat e fuqisë dhe epshit. Ai e gjallëron trupin me këto. Lum për atë njeri që ia del mbanë për ta kryer punën para se të vijë ditët e pleqërisë, para se ta lërë fuqia,

para se të shkretohet toka dhe para se të rrëshqasë kjo e fundit.” (Mesnevi, vëll. II, 1215-220)

Për prindërit ka paralajmërime serioze në fjalët edhe të Mevlanës, edhe të Imam Rabbanit. Sepse të mëdhenjtë që duhet t’ia vënë gishtin kokës, po i shtyjnë të rinjtë drejt anaforës së materializimit dhe po i edukojnë ata vetëm me shqetësimin për punën dhe ushqimin. Sigurisht që edhe të rinjtë pandehin se suksesin do ta arrijnë vetëm me një profesion të mirëfilltë dhe me një pagesë të lartë. Nëse kësaj i shtojmë edhe energjinë e pakontrollueshme të viteve të rinisë dhe mungesën e përvojës, puna jonë vështirësohet akoma më shumë. Për këtë arsye, detyra jonë më kryesore duhet të jetë që t’ua mësojmë të rinjve se sukcesi i vërtetë gjendet te veçoritë si fetaria, sakrifica, heroizmi, përmbajtja, respekti dhe dashuria. Detyra është e vështirë, por edhe shpërblimi është shumë i madh. Imam Rabbani e shpjegon siç vijon këtë situatë:

“Përgjatë periudhës së rinisë njeriun e rrethojnë dhe preokupojnë nefs dhe shejtani të cilët janë armiqtë e fesë. Pak ibadet në kohën e rinisë kundrejt këtyre është shumë i vlefshëm. Ndërsa ibadetet e shumta që bëhen në pleqëri kur nuk bëhet fjalë për një rrethim të tillë, nuk kanë edhe aq vlerë. Sipas rregullave të ushtrisë, një lëvizje apo përpjekje e vogël e ushtarit në kohën kur sulmon dhe rrethon armiku është shumë e vlefshme. Ndërsa në kohë paqeje dhe kur nuk ka rrezik prej armikut, përpjekjet nuk kanë kaq shumë kimet.” (Vëll. 1:Letra e 73-të.)

Të rinjtë që u strehuan në një shpellë për të shpëtuar besimin e tyre, u përjetësuan në Kuranin Fisnik për shkak të këtyre përpjekjeve: As’habu’l-Kehfi e arritën këtë gradë të lartë vetëm për shkak se u larguan dhe bënë hixhret nga vendi ku kundërshtojë feja. Në hadithin fisnik transmetohet: “Ibadeti përgjatë periudhës së fitneve për mua është si hixhreti.” (Muslim, Fiten, 25, nr. 2948.) (Mektubat, vëll. I, letra e 85-të.) Imami u jepte rëndësi të veçantë dhe i afronte nxënësit e singertë dhe të devotshëm ndërmjet muridëve të tij. Sido që të jenë kushtet, Zoti (xh.xh.), do t’i mbrojë nga çdo lloj fitnesh të rinjtë që i drejtohen Atij me singëritet. Allahu Teala na bëftë ne dhe të gjithë të rinjtë prej atyre që u japin rëndësi dhe përparësi punëve të botës së përtejme dhe që e konsiderojnë adhurimin ndaj Allahut si çështje primare! Na i ndriçoftë zemrat me dhikër dhe na e mundësoftë të shpëtojmë nga kurthet e nefsit dhe shejtanit!

Amin!..



VLERA TË PASTRA PËR BOTËN E PASTËR TË TË RINJVE

— Doç. dr. Kerim Bulladë —

Vlera dhe kimeti i rinisë është kaq e qartë dhe evidente saqë për rëndësinë dhe domosdoshmërinë e saj në jetën e umetit dhe popullit nuk mund të ndjehet as nevoja për ta diskutuar. Rezistenca, qëndrimi dhe fuqia jonë si umet dhe si popull, madje edhe problemi i mbijetesës sonë në këtë vend, s’do shpjegim se gjendet te edukimi material e shpirtëror i të rinjve, shkurtimisht te arsimi dhe edukimi i tyre.

Rreth konceptit të rinisë janë bërë përkufizime të ndryshme. Disa prej tyre po i japim, në mënyrë që të na ndihmojnë për ta kuptuar temën më qartë. Në aspektin

psiko-social rinia përkufizohet si një proces që fillon me pubertetin dhe vazhdon deri në moshën 22-25 vjeçare. Fillimi i këtij procesi te vajzat konsiderohet ardhja e menstruacioneve, kurse të djemtë shkarkimet seminale (ejakulimet).¹

Pejami Safa (v. 1961), e përkufizon rininë me një metodë dhe stil të ndryshëm: “Kuptimi i rinisë në fjalorin e natyrës është freskia. Lulëzimi i një fidani të freskët në trup, shkëlqimi i një gjetheje të freskët në lëkurë, shpërthimi i fijeve të freskëta në flokë, rrjedhja e një burimi të freskët te sytë, e kuqja e frutës së freskët te buzët dhe gjallëria e freskët në ecje. Kuptimi i rinisë në fjalorin e shoqërisë është diçka shumë më e lartë se freskia. Ajo është një gjallëri që lind nga kontakti me xhevahirin e ndjenjës kombëtare. Një dritë mishërimi në zgjuarsin që lind nga nevoja për të kuptuar çështjet të cilat na i ka radhitur përpara shoqëria. Tingulli i telave që e lidhin njeriun me njeriun në zemër. Përgatitja në vullnet për t’u gjuajtur nga harku e për t’u hedhur drejt synimeve më kuptimplota sesa të jetosh në mënyrë kafshërore. Një njeri i prapambetur dhe një popull i prapambetur është ai që e gjen kuptimin e rinisë vetëm në fjalorin e natyrës. Njeri i përparuar dhe popull i përparuar është ai që e shton edhe kuptimin e rinisë në fjalorin e shoqërisë. Në këtë mënyrë i riu nuk mjaftohet vetëm me të qenët një fidan i freskët dhe një qenie e gjallë, por bëhet një njeri i vetëdijshëm, i zgjuar, i kulturuar, i përgatitur, i vullnetshëm dhe këmbëngulës.”²

Të rinjtë bëjnë një jetë më të përshtatshme dhe të afërt me natyrshmërinë esenciale të tyre. Ngaqë zemra e tyre, e cila është vendi i besimit, është më e pastër dhe e dëlirë, është më e predispozuar për ta pranuar udhëzimin dhe imanin. Por kur të mos marrë edukim fetar, kjo natyrshmëri e pastër ndotet, njolloset dhe prishet më shpejt

sesa pandehet. Nisur nga ky aspekt, të ushqyerit, të përforcuarit dhe të gjallëruarit e kësaj natyrshmërie të pastër dhe esenciale me parimet e besimit dhe moralit, mbartin një rëndësi të veçantë.

Këtë vlerësim të Prof. Dr. Maz'har Osman Uzmanit që tregon rëndësinë e edukimit shpirtëror e fetar, e konsiderojmë mjaft të rëndësishëm: "...Edukimi më bazik në këtë botë për shoqërinë është feja. Sugjerimet që u bëhen më vonë shoqërive që nuk mbështeten te përshtatshmëria dhe që nuk kanë edukim fetar, nuk janë influencuese edhe nëse janë të fuqishme. Çdo individ është i lidhur me traditën fetare në formë trashëguese dhe nga lindja. Në edukimin e familjes që formohet mbi fenë, ka baza më serioze. Sigurisht se edhe edukimi i shkollës është një mbështetje e fuqishme e cila duhet të merret në konsideratë, por nëse bazat e kësaj i formojmë që në fillim, influencon në mënyrë më të mirëfilltë. Edukimi fetar nuk e lejon njeriun që t'i bëjë keq dhe t'i shkaktojë dhimbje vetes, familjes, atdheut, popullit dhe të gjithë botës. Në këtë periudhë është kuptuar se faktori kryesor i vuajtjeve fizike në jetë është shpirtëror. Sëmundjet dhe vuajtjet më të mëdha qetësohen dhe shërohen duke e lartësuar shpirtin me ngushëllime fetare. Nëse u jepet edhe edukim kulturor dhe qytetar të rinjve që janë të lidhur ndaj fesë, moralit e traditës dhe që kanë marrë edukim të kësaj natyre, bëhen njerëzit më të lumtur. Nëse shëtisni të gjithë botën do të vini re se edhe njerëzit me kulturë të lartë në çdo vend janë të lidhur ndaj fesë, kombësisë, nderit familjar dhe traditës. Një njeri që nuk di të respektojë fenë dhe moralin, vështirë se mund të shfaqë respekt ndaj ligjit.³

Siç është shprehur edhe Maz'har Osmani, ata që janë të lidhur dhe që i respektojnë rregullat e fesë dhe moralit, i respektojnë edhe ligjet e shoqërisë. Në planin e pasmë të ryshfetit, manipulimit të njeriut dhe dhunimit të të drejtave të jetimëve, të varfërve dhe të vobektëve, gjendet besimi i dobët ose mungesa e besimit. Një prej problemeve themelore të rinisë në ditët e sotme është mosmarrja në mënyrë të mjaftueshme e mësimi shpirtëror dhe fetar. Nisur nga ky aspekt, mësimi dhe edukimi fetar është një fuqi që e garanton pavarësinë dhe të ardhmen e një umeti dhe populli.

Edukimi është përkufizuar në këtë mënyrë në fjalorin turqisht-turqisht të botuar nga Institucioni i Gjuhës Turke: Aktiviteti për mësimin, zhvillimin dhe edukimin në një degë të caktuar të shkencës apo në ndonjë degë të caktuar të artit. Të edukosh do të thotë të injektosh sjellje të ndryshme, dije dhe mirësjellje te dikush duke ndikuar në zhvillimin fizik të tij në përputhje me mendjen e vet dhe duke ia mundësuar të zhvillohet në një aspekt të caktuar sipas objektivave të caktuara më parë. Kurse të arsimosh do të thotë të japësh informacionet e nevojshme sipas një qëllimi të caktuar, organizimi i aktiviteteve që lehtësojnë mësimin, sigurimi i mjeteve dhe udhërrëfimi.⁴

Dija që jepet e privuar nga qëllimi dhe synimi, nga një aspekt nuk mund të jetë gjë tjetër përveçse hamallëk i informacionit. Siç shprehet në këto rreshta që i atribuohen Junus Emresë: "Dija është të



dish. Dija është të njohësh veten. Nëse nuk e njeh veten, përse gjithë ky lexim? Dija është që njeriu ta njohë Zotin. Nëse lexon dhe nuk e njeh Atë, atëherë kjo nuk është gjë tjetër përveçse një përpjekje e dështuar.", dija që nuk ka ndonjë qëllim dhe që nuk vihet në praktikë, nuk është gjë tjetër përveçse një përpjekje e dështuar. Për këtë arsye, duhet t'i kushtohet më shumë rëndësi dimensionit të urtësisë dhe vetëdijesimit në sistemin tonë të edukimit.

Pavarësisht kësaj, duket shumë qartë edhe domosdoshmëria për t'u dhënë të rinjve tanë dije të saktë fetare dhe edukim shpirtëror në kohën e duhur. Përderisa kjo çështje të neglizhohet, atëherë të rinjtë tanë absolutisht do të ndikohen nga rryma dhe ideologji të humbura fetare.

■ **REFERENCAT:** 1) Adnan Zijallar, Gençlerin Ruhî ve Sosyal Problemleri – Problemet shpirtërore dhe sociale të të rinjve, Gençligin Ruhî ve Mânevî Problemleri – Probelemet shpirtërore dhe spirituale të rinisë, Stamboll, më 1987, (Tartışmalı İlmî Toplantılar Dizisi – Seria e mbledhjeve shkencore të diskutueshme, 7), fq. 19; Mustafa Tavukçuoğlu, Avrupalı Türk Gençlerinin Kültürel Kimlik Problemleri – Problemet e identitetit kulturor të të rinjve turq nga Evropa (teblig - predikim) Gençlik Dönemi ve Eğitimi – Periudha dhe edukimi I rinisë, Stamboll, 11-13 Aralık 1998, (Tartışmalı Toplantılar Dizisi - Seria e mbledhjeve shkencore të diskutueshme, 29) fq. 207. 2) Pejami Safa, Seçmeler – Pjesë të zgjedhura (Yeni Mecmua, 19 Maj, 1939), Përgatitën, Faruk Timurtash - Ergyn Geze, Stamboll, 1970 (1000 Temel Eser) fq. 31. 3) Raporti i kulturës së drogës dhe marrjes së masave, Stamboll, 1992, fq. 181 (revista që botohet nga qendra e përgjithshme e Yesilay Cemiyeti). 4) Shykry Haluk Akallën dhe të tjerë, Fjalori turqisht-turqisht, Türk Dil Kurumu – Institucioni i Gjuhës Turke, Ankara, 2009, fq. 607, 1533.



BREZI I RI, BREZI I VJETËR

— Ali Riza Temel —

Njeriu mbart një dobësi e cila është përvetësimi i të resë dhe braktisja e të vjetrës pa i llogaritur dobitë dhe dëmet e tyre. Andaj thuhet: “Çdo e re është e mirë.” Në fakt nëpërmjet përvojës mund të dihet nëse është e mirë apo e dëmshme çdo gjë e re. Kështu që nuk mund të jepet gjykim i menjëhershëm për diçka nëse është e dobishme apo e dëmshme. Sa bukur shprehet poeti ynë kombëtar, Mehmet Akifi: “E vjetra nuk mund të hidhet ngaqë është e vjetër. Ajo mund të hidhet nëse është e keqe. Edhe e reja nuk mund të merret ngaqë është e re. Ajo mund të merret nëse është e mirë.”

Sëmundja për ta braktisur të vjetrën tërësisht dhe për t’iu drejtuar të resë nën emrin modernizim (!), ka prishur natyrshmërinë e brezit. Janë lëkundur vlerat themelore që e mbajnë në këmbë shoqërinë dhe kanë dalë në pah çështje e breza pa

mbështetje, pa rrënjë dhe pa qëllime. Në Kuranin Fisnik thuhet:

“Pas atyre erdhën brezni, që e braktisën faljen e namazit dhe ndoqën epsheet e veta. Ata do të pësojnë dënimin e madh.” (Merjem, 59) Shka-ku më i rëndësishëm i braktisjes së vlerave që i mbajnë individët dhe shoqëritë në këmbë dhe i rendjes pas të resë në mënyrë të pavetëdijshme, siç shprehet edhe në ajet, është mbajtja në plan të parë të dëshirave vetjake. Të rezistosh kundrejt dëshirave vetjake është e vështirë. Kjo rezistencë kërkon një vullnet të hekurt dhe vetëllogaritje të fortë. Njerëzit pa vullnet rrokullisen majtas e djathtas si gjethe përpara erës. Për rrjedhojë nuk mund të formohet një shoqëri e shëndoshë me njerëz egoistë dhe interesaxhinj që janë skllevër të dëshirave.



Stili i jetës që kanë nxjerrë në pah materializmi dhe kapitalizmi i tmerrshëm, i ka zhvlerësuar vlerat shpirtërore dhe morale. Si rrjedhojë është formuar një botë në të cilën është përjashtuar feja dhe ka dalë në plan të parë interesi. Në këtë botë është thelluar ndryshimi i botëkuptimit dhe perceptimit ndërmjet brezit të vjetër dhe brezit të ri dhe kanë dalë në pah njerëz pothuajse të botëve të ndryshme. Të jetuarit kaq shumë ndryshe në të njëjtën kohë dhe terren, dashje pa dashje shkakton përplasje. Për këtë arsye, në vend të pajtimit të të vjetrës me të renë, bukuritë e vjetra po ndëshkohen kundrejt gjërave të shëmtuara të reja.

Në një shoqëri ku turpi konsiderohet ndrojtje, paturpësia konsiderohet shkathtësi, ndarja e gjërave më të tjerët konsiderohet naivitete dhe sakrificat konsiderohet budallallëk, nuk mund të flitet për humanizëm. Stili i jetës që formohet dhe ekspozohet duke u përjashtuar vlerat shpirtërore e morale dhe fatura e këtij shkatërrimi e kalbjeje që nxjerr në pah ky stil jete është jashtëzakonisht shumë e rëndë. Kjo fatura sa vjen e bëhet edhe më e rëndë. Shoqëritë në të cilat ka humbur respekti ndaj të madhit dhe dashuria ndaj të voglit dhe në të cilat janë lëkundur konceptet si të drejtat, drejtësia, harami, hallalli, detyra, përgjegjësitë, etj. nuk kanë të ardhme. Sado që të përparojë teknologjia, shkatërrimi dhe prishja bëhen në dimensione të frikshme nëse nuk është i qëndrueshëm themeli shpirtëror e moral. Nuk mund të jetë e njëjtë shembja e një kasolleje me shembjen e një gradaçele. Mbeturinat e një teknologjie të ndërtuar mbi egoizmin nuk mund të pastrohen lehtë.

Ky stil i ri jete që është ndërtuar mbi shfrytëzimin, dobësitë njerëzore dhe dëshirat vetjake, po e zvarrit njerëzimin drejt tragjedisë nën atmosferën e një festivali dhe argëtimi. Vlerat familjare po lëkunden, humnera ndërmjet të pasurit dhe të varfrit po thellohet, po përhapet prostitucio-

ni, droga, plaçkitja dhe bastisja, po shtohen garat për armatimin, masakrat, terrori, mafia e destabiliteti dhe po humbet fuqia e ndjenja për të bërë rezistencë kundrejt të keqes dhe padrejtësisë.

Këto gjëra negative nuk po i përmendim për të vizatuar një tablo plot pesimizëm. Nëse bëhet fjalë për një zjarr, atëherë gjëja më e logjikshme është gjetja e zgjidhjeve dhe marrja e masave për ta fikur në vend që të neglizhohet.

Është e vërtetë se martesat janë pakësuar dhe divorcet janë shtuar. Bashkëshortët po i harrojnë për një kohë të shkurtër fjalët që i kanë thënë përgjatë aktit të martesës se do ta mbështesin njëri-tjetrin në ditë të mira dhe në ditë të këqija. Ata po shkojnë drejt ndarjes duke bërë pretekst qoftë edhe problemin më të vogël. Në këtë mënyrë po shuhen vatrat familjare dhe struktura e shoqërisë po lëkundet që nga themelet. Ndërkohë që në të kaluarën ka qenë shumë e fortë struktura e familjes së gjerë, struktura e familjes së vogël përgjatë ditëve të sotme po përjeton tronditje të mëdha. Vatra familjare e formuar me shpenzime dhe përpjekje të mëdha, po shkatërrohet me pretekste të pavlera. Familja është një institucion i shenjtë, jo një kompani që mbështetet te interesi. Ajo është vatra në të cilën edukohen brezat e mirë dhe të dobishëm. Çimentoja e kësaj strukture është dashuria dhe respekti. Nusja është vajza e vjehrrës, kurse dhëndri është djali i vjehrrit. Për shkak se këta janë amanet ndaj njëri-tjetrit, duhet të shfaqet më shumë kujdes ndaj tyre.

Në të kaluarën edhe pse mundësitë e edukimit dhe arsimit kanë qenë të kufizuara, dashuria dhe respekti kanë qenë më të përhapur ndërmjet njerëzve. I vogli i hapte rrugën të madhit, nuk e ngrinte zërin, bënte kujdes ndaj uljes dhe ngritjes dhe i respektonte më shumë urdhrat dhe ndalesat. Kurse tani, edhe pse edukimi dhe arsimi janë përhapur kudo, edhe pse është rritur përqindja e atyre që janë të arsimuar, respekti po pakësohet, rregullat po shkelen lehtësisht dhe egoizmi



e interesat personale po kalojnë në plan të parë. Çfarë dobie mund të kenë për shoqërinë edhe nëse mbarojnë disa fakultete të rinjtë që nuk ia lirojnë vendin të madhit në autobus, metro dhe tramvaj dhe që bëjnë sikur nuk e shohin njeriun me aftësi të kufizuara, të sëmurin, shtatzënë apo nënën me fëmijë të vogël? Siç kanë shkuar dëm shpenzimet e bëra për edukimin e këtyre, ata po bëhen shembull i keq edhe për të tjerët me sjelljet e tyre indiferente.

I riu sipas sistemit të mistikës që ishte një vatrë edukimi për rininë myslimane ideale të Anadolllit, duhet ta ketë dorën e hapur (duhet të jetë bujar), derën të hapur (mikpritës) dhe sofrën të hapur. Ai duhet t'i ketë sytë e mbyllur kundrejt haramit, gjuhën e lidhur kundrejt fjalëve të këqija dhe duhet ta ruaj nderin e namusin. Edukimi që jepej dhe stili i jetës që përjetohej, e bënte të mundur realizimin e këtyre mirësive.

Vlerat që përfaqësonin brezin e vjetër po nëpërkëmben nën maskën e modernizmit. Mungesa e edukatës dhe respektit po konsiderohet si qytetari.

I ndjeri, Mehmet Akifi e shpreh si më poshtë këtë tablo që ka arritur dimensione edhe më të rënda në ditët e sotme:

“Turpi është zhdukur, ndërsa pafytyrësia është përhapur në çdo vend

Sa fytyra të shëmtuara paska fshehur një perde e hollë

Nuk ka besnikëri, nuk ka aspak respekt ndaj premtimit, fjala amanet ka mbetur pa kuptim

Gënjeshtër ka marrë vlerë, tradhtia është bërë e dobishme, kurse e vërteta nuk ekziston në asnjë vend

Zemrat janë bërë të pamëshirshme, ndjenjat janë bërë të ulëta dhe shpresat të shuara

Kuptimi që shfaqet nga shikimet është përçmim ndaj robërve të Allahut.”

Një prej shkaqeve që brezi i ri është bërë kaq i papërgjegjshëm dhe përtac është shtimi i mundësive, lehtësimi i jetës dhe shtimi i luksit e harxhimit të tepërt. Për rrjedhojë të rinjve po u jepet një jetë falas pa përjetuar asnjë lloj vështirësie. Të ushtruarit me këtë luks dhe me këtë jetë të tillë falas, është shndërruar në karakter për ata. Për këtë arsye, veten gjithmonë e shikojnë jo në pozitën e dhënësit, por në atë të marrësit. Si

rezultat, fatura e ardhjes së tyre në këtë botë u ngarkohet nënave dhe baballarëve. Ata dëshirojnë të thonë: “Meqë na keni sjellë në këtë botë, atëherë gjithmonë na mbani në kurriz.” Ndërkohë që thonë kështu, asnjëherë nuk e llogaritin se në të ardhmen edhe vetë do të bëhen nëna dhe baballarë.

Ky ndryshim në botëkuptim dhe sjellje ndërmjet brezave patjetër që duhet të eliminohet. Në të kundërt, kjo situatë e përshpejton kalbjen dhe rënien ditë pas dite. Struktura e shoqërisë nuk mund ta përballojë këtë.

Në të vërtetë e reja dhe rinovimi janë rregulla të pandryshueshme të jetës. E rëndësishme është që ato të vazhdojnë në linjën pozitive dhe të jenë të lidhura me rrënjët. E reja pa rrënjë nuk është e qëndrueshme. Ajo që nuk ushqehet nga e kaluara, nuk mund të jetë e shëndetshme në të ardhmen. Frutat që vendosen në degët e pemës së krishtlindjeve kalben për një kohë të shkurtër. Jeta është si një lum i cili nuk shteron. Rrjedhja e tij në mënyrë të vazhdueshme është e lidhur me burimin.

Kjo humnerë ndërmjet brezit të ri dhe brezit të vjetër te ne ka filluar me aventurën e perëndimorizimit. Pas një periudhe është shndërruar në politikë të edukimit. Fëmijëve në shkollën fillore u bëhen sugjerime në formën: “Harroje të vjetrën dhe përmbaju rrugës së re!” Për rrjedhojë në pah ka dalë tabloja që e shpreh poeti Nexhip Fazëlli:

“Çdo kat i shtëpisë tri katëshe prej druri është një botë më vete!

Kati i sipërm: Gjyshja qan me tespihe në dorë,

Kati i mesëm: Nëna ime që lozën dhe të dashurit e saj (fëmijët)

Kati i poshtëm: Klithmat e motrës sime.

Shtëpinë time që e kam prerë në mes si një copë djathi me krimba

Urdhëroni dhe shiheni atë nga vendi ku është ndarë, ja shtëpia ime!”

E gjithë çështja është që të gjithë pjesëtarët e familjes, pra, të moshuarit dhe të rinjtë të gjenen në një linjë të përbashkët botëkuptimi dhe sjelljeje.

JAHJA

SI NJË MODEL I RINISË



— Murat Kaja —

Në natyrshmërinë e njeriut janë vendosur veçoritë e imitimit dhe marrjes për shembull. Këto dy veçori gjithmonë janë përdorur në edukimin e njeriut. Pejgamberët, dijetarët dhe njerëzit e devotshëm u janë treguar si shembull njerëzve. Këtyre të fundit u është sugjeruar që të shkojnë në gjurmët e atyre. Për t'u realizuar kjo, duhet që (njerëzve) t'u tregohen jeta dhe morali i pejgamberëve dhe i njerëzve të devotshëm. Njerëzit duhet të inkurajohen me anë të këtyre. Rëndësia e kësaj është theksuar edhe në ajetin e mëposhtëm në të cilin thuhet:

“Ne po t'i tregojmë ty disa nga historitë e të dërguarve, për të ta forcuar zemrën. Në këtë sure të ka ardhur ty e vërteta. Ajo është këshillë dhe kujtesë për besimtarët.” (Hud, 120)

Ebu Hanife (v. 150/767) rahmetull-llahi alejh, ka thënë në lidhje me këtë çështje: “Historitë që flasin rreth dijetarëve të devotshëm dhe që na tregojnë moralin e lartë të tyre, për mua janë më të dashura se shumica e jurisprudencës islame (fikhut), sepse këto histori flasin rreth edukatës dhe moralit të miqve të Allahut (xh.xh.). Në ajetin fisnik thuhet:

“Këta janë ata, të cilët Allahu i ka udhëzuar në rrugën e drejtë, andaj edhe ti (o Muhamed) ndiq rrugën e tyre...”¹

Xhunejd Bagdadi (v. 297/909), kuddise sirruh, ka thënë: “Historitë e të devotshmëve janë një ushtri prej ushtrive të Allahut. Allahu Teala nëpërmjet tyre i forcon zemrat e muridëve.” Ndërsa atyre që kërkonin argument për këtë, u ka lexuar ajetin e mësipërm Hud, 120.²

Nëse është kaq i dobishëm të folurit rreth historisë së jetës dhe moralit të njerëzve të devotshëm, atëherë duket qartë se të folurit rreth historisë dhe moralit të pejgamberëve është akoma më i dobishëm. Sepse, njerëzve që e dëgjojnë jetën e tyre shembullore u forcohet besimi, u shtohet dëshira për të bërë adhurim, u përmirësohet morali, në marrëdhëniet e tyre me të tjerët u dominon ndjenja e drejtësisë dhe u lehtësohen vuajtjet e brengosjet. Virtytet morale mund t'u sugjerohen njerëzve në një formë më aktive dhe influencuese duke u treguar këto lloj historish. Ngaqë historitë në përgjithësi

mbartin shumë kuptime etike, ato është e mundur që t'i përsërisim në situata të ndryshme nëpërmjet aspekteve të llojllojshme të tyre. Kështu që është e mundur ta shohim se ato (historitë) gjithmonë posedojnë një fuqi orientuese. Historitë që dëgjojnë në mënyrë të vazhdueshme gdhenden në subkoshiençë (nënvetëdije). Ato mund t'u japim drejtim vendimeve të njeriut duke u kujtuar menjëherë në momentin e nevojës. Përfundimisht mund të themi se historitë posedojnë një fuqi orientuese, edukuese dhe bindëse.

Për këtë arsye, Kurani Fisnik transmeton shpesh histori të pejgamberëve dhe i vendos ato para njerëzve si model. Edhe dijetarët myslimanë i kanë dhënë rëndësi kësaj metode në veprat e tyre ngaqë e kanë parë se njerëzit mund t'i edukojnë më lehtë nëpërmjet historive. Për këtë arsye, përgjatë edukimit të njeriut vazhdimisht duhet të shtjellohet së pari jeta e të Dërguarit të Allahut, alejhi's-selam, ngjarjet që ka përjetuar Pejgamberi ynë i Nderuar (s.a.s.), pastaj jeta dhe kujtimet e pejgamberëve të tjerë dhe pastaj historitë e jetës së sahabëve të nderuar, të dijetarëve, të të urtëve dhe të të devotshmëve. Këto histori gjithmonë duhet të mbahen në rendin e ditës. Në të kundërt, njerëzit do të fillojnë ta kërkojnë nevojën për të marrë shembull dhe model të jetës së heronjve jomyslimanë dhe të romanet e historitë që i kanë shkruar jomyslimanët. Kjo nga aspekti i vetëdijes dhe qasjes Islame do të përfundojë me largimin e tyre.

Njëri prej pejgamberëve që tregohet si model në Kuranin Fisnik për njerëzit, veçanërisht për të rinjtë, është Jahjai. Fakti që ka rënë dëshmor në moshë të re dhe që nuk e arriti dot periudhën e pleqërisë, ka bërë të mundur që në mendje gjithmonë të mbetet si një i ri shembullor. Jahjai (a.s.), është një pejgamber që i përmendet emri pesë herë në Kuran³ dhe për të cilin njoftohemi se ka jetuar në të njëjtën kohë me Isain (a.s.). (Al Imran, 33-34) Ai ishte i dërguar te bijtë e Izraelit.

JETA E JAHJAIT

Jahjai (a.s.), ishte biri i Zekerijjas. Edhe ai e kishte prejardhjen nga pejgamberët Sulejmani, Davudi dhe

Jakubi.⁴ Isai (a.s.) dhe Jahjai janë djem tezesh me njëri-tjetrit.⁵ Kurani Fisnik nuk flet shumë rreth identitetit historik të Jahjait. Më së shumti i jepet rëndësi ardhjes së tij në këtë botë dhe personalitetit të tij. Këto tema i shtjellojnë pesëmbëdhjetë ajetet e para të sures Merjem. Së pari flitet për mëshirën e Allahut (xh.xh.), ndaj Zekerijjas. Ai i ishte përgjyruar Zotit me një zë të fshehtë:

“O Zoti im! Eshtrat tashmë më janë dobësuar, koka më ndriçon nga thinjat dhe asnjëherë nuk kam mbetur i zhgënjyer nga lutja ime për Ty, o Zoti im! Unë u frikësohem (sjelljeve të) të afërmeve të mi pas meje, ndërsa bashkëshortja ime është beronjë; andaj, më dhuro nga ana Jote një pasardhës, që të më trashëgojë mua dhe familjen e Jakubit. O Zoti im, bëje atë të pëlqyeshëm (për Ty)!” (Merjem, 4-6) Pastaj është lutur: **“...O Zoti im, mos më lër vetëm (pa fëmijë), e Ti je trashëgimtari më i mirë.”** (Enbija, 89)

Transmetohet se Zekerijja e ka bërë një kërkesë të tillë pasi pa se Merjemes Allahu i jepte rrësk në një formë të mrekullueshme pa ndonjë shkak.⁶ Kësaj mund t'i shtojmë edhe këtë shkak: Shorti që u hodh për përkujdesjen dhe sigurinë e Merjemes në moshë të vogël që preokupohej me ibadet në faltore, i pati rënë Zekerijjas. Ndërsa preokupohej vazhdimisht me të, vuri re sesi ajo bënte një jetë të bukur adhurimi dhe posedonte ndjenja të pasura. Andaj mund të shprehemi se ai iu drejtua Zotit duke i kërkuar një fëmijë “që i ishte dorëzuar Allahut, të pastër dhe të ndershëm” si Merjemja, alejha’s-selam, duke e pëlqyer shumë gjendjen e saj.

Edhe Allahu Teala na njofton se robërit e Tij të devotshëm i përgjyerojnë në formën: **“...O Zoti ynë, dhurona nga gratë tona dhe trashëgimtarët tanë, ç’është prehe për sytë tanë dhe bëna shembull për të mirët!”** (Furkan, 74)

Hasan el-Basriu (v. 110/728), ka thënë në lidhje me këtë ajet: “Ky ajet fisnik do të thotë: «Na jep gra dhe pasardhës që do t'i binden Allahut!» Sepse besimtarin nuk e gëzon dhe nuk është prehe për sy e tij asgjë më tepër sesa ta shohë duke iu bindur Allahut personin që e do.” (Buhari, Tefsir, 25.)

Allahu Teala e përgëzoi Zekerijjan me një fëmijë djalë që do të quhej “Jahja” dhe e njoftoi atë se ky emër nuk i ishte vënë askujt më parë. Ka pasur prej atyre që kanë thënë se ndërmjet kësaj luteje të Zekerijjas (a.s.) dhe përgëzimit që iu dha, kanë kaluar dyzet vjet.⁷ Kjo situatë tregon se duhet të vazhdojmë të insistojmë në lutje pa u nxituar. Edhe

Pejgamberi ynë i Nderuar (a.s.), ka thënë:

“Robit i pranohet lutja përderisa të mos kërkojë diçka që është gjynah apo diçka që do të shkaktojë zemërim me të afërmin e tij apo përderisa të mos nxitojë.” Atë e pyetën:

“O i Dërguari i Allahut! Çfarë do të thotë të nxitosh?”

I Dërguari i Allahut, alejhi’s-selam, u përgjigj:

“Robi thotë: «U bënë shumë herë që lutem, por Zoti nuk ma pranon lutjen.» Ai bezdiset dhe e braktis lutjen për shkak se nuk i është pranuar lutja menjëherë. (Ja, pikërisht këtu ai ka nxituar.)” (Muslim, “Dhikr”, 92.)

Zekerijja (a.s.), u gëzua kundrejt këtij sihariqi. Ai përjetoi një habi të madhe dhe pyeti se si mund të kishin një fëmijë ndërkohë që bashkëshorten e kishte beronjë dhe vetë kishte arritur në pikën e fundit të pleqërisë. Ai nuk kishte dyshim në realizimin e një gjëje të tillë, por pyeti për natyrën e kësaj çështjeje. Allahu Teala i tha se siç e kishte krijuar edhe atë kur nuk kishte qenë asgjë, ashtu e kishte të lehtë ta krijuar edhe Jahjain. Nisur nga kjo, Zekerijja (a.s.), kërkoi një shenjë për t’iu qetësuar zemra kundrejt kësaj çështjeje së përgëzimit për të cilin e njoftuan engjëjt. Allahu Teala i tha se shenja që dëshironte ishte se nuk do të fliste dot tri ditë me njerëzit edhe pse kishte një gjendje shëndetësore krejt të shëndetshme. Sipas transmetimit Zekerijja (a.s.), nuk foli dot në mëngjesin e natës që mbeti shtatzënë bashkëshortja e tij.⁸ Nisur nga kjo, Zekerijja (a.s.), doli nga faltorja, shkoi te populli i tij dhe u tha atyre me shenja që ta adhuronin Allahun mëngjes e mbrëmje. (Shik. Merjem, 7-11.)

Si shtesë ndaj këtyre që thamë më sipër, në suren Al Imran njoftohet se Zekerijja ka kërkuar nga Zoti një fëmijë të pastër e të bekuar dhe se engjëjt e kanë informuar ndërkohë që po bënte ibadet në faltore duke i thirrur dhe duke e përgëzuar me Jahjain i cili do ta aprovonte Allahun, do ta aprovonte Isain dhe i cili do të ishte një prej pejgamberëve të nderuar, që e dominonte nefsin dhe që ishte prej të devotshmëve. Ndërsa kur Zekerijja (a.s.), pyeti duke u habitur se si do të realizohej kjo, përgjigja u dha në formën: **“Allahu do të bëjë atë që dëshiron.”** Pasi u njoftua se nuk do të flasë dot tri ditë, u urdhërua në formën: **“Përmende Zotin shumë dhe madhëroje atë mëngjes e mbrëmje!”** (Shik. Al Imran, 38-41.)

Muhammed ibn Ka’bi (v. 108/726), thotë: **“Nëse Allahu i Madhëruar do t’i jepte leje dikujt për ta**



lënë dhikrin, do t'i jepte leje Zekerijjas kur i tha: **“... Shenjë për ty është se tri ditë nuk do t'u flasësh dot njerëzve, veçse me shenja...”** (Al Imran, 41) Por pas kësaj thotë: “Veçanërisht përmende shumë Zotin dhe madhëroje mëngjes e mbrëmje!” (Taberi, 6: 391.)

Sipas Zemahsheriut (v. 538/1144), Zekerijja (a.s.), nuk foli dot me njerëzit, në mënyrë që përgjatë asaj kohe t'ia dedikonte gjuhën përmendjes së Allahut dhe të mos preokupohej me gjëra të tjera si falënderim për këtë mirësi të madhe të Allahut (xh.xh.).⁹

Sipas transmetimeve të ndryshme atë kohë Zekerijja (a.s.), ishte shtatëdhjetë apo shtatëdhjetë e disa vjeç.¹⁰ Po ashtu është thënë edhe se ai vetë ka qenë 92 apo 120 vjeç, ndërsa bashkëshortja e tij ka qenë 98 vjeç.¹¹

Allahu Teala i çoi selam Jahjait ditën kur lindi. Në të njëjtën mënyrë njoftoi se do t'i çonte selam edhe ditën që do të vdiste, edhe ditën që do të ringjallet. (Shik. Merjem, 15) Domethënë, njoftoi se do ta mbronte atë nga çdo lloj e keqeje, mëkati, vështirësie, ndëshkimi e frike dhe se do ta shpëtonte.

FËMIJËRIA DHE RINIA E JAHJAIT

Që kur Jahjai (a.s.), ishte në moshë të vogël, Allahu Teala i dha atij urtësinë, butësinë e zemrës, pastërtinë shpirtërore dhe dëlirësinë. Ai ishte një njeri që kishte frikë prej Allahut, i devotshëm dhe që sillej mirë ndaj nënës e babait. Asnjëherë nuk ishte një njeri i ashpër dhe i padëgjueshëm. (Shik. Merjem, 12-14.)

Transmetohet se Jahjai (a.s.), ka kaluar një jetë fëmijërore jashtëzakonisht shumë të pjekur. Transmetohet se në moshën tetë vjeçare ka filluar t'i shërbejë Bejtu'l-Makdisit, se ka shërbyer aty përgjatë ditës deri në moshën pesëmbëdhjetë vjeçare dhe se natën e kalonte duke bërë ibadet me lot në sy.¹² Ibnu'l-Esiri (v. 630/1233) ka transmetuar se ai nuk i dëshironte aspak gratë dhe se nuk ka lozur me fëmijët.¹³ Kur fëmijët i shkonin pranë dhe i thoshin: “Eja të lozim pak!”, ai u thoshte: “Mos vallë jemi krijuar për të lozur?” Thuhet se ajeti: **“...Dhe Ne, kur ende ishte fëmijë, i dhamë mençuri.”** (Merjem,

12), tregon këtë gjendje.¹⁴ Domethënë se ai ka bërë një jetë me një bindje të fortë ndaj Allahut që në fëmijëri të tij.¹⁵

Prej transmetimeve që na kanë ardhur kuptohet se Jahjai në rininë e tij ka bërë një jetë larg luksit dhe modeste. Krahës kësaj, ngrënia, pirja dhe veshja e tij ishin jashtëzakonisht shumë të thjeshta.¹⁶ Edhe njerëzve u sugjeronte që t'i ndanin me të tjerët ushqimet dhe veshjet e tepërta, që të mjaftoheshin me ato që posedonin, të qëndronin larg pangopësisë dhe tiranisë. U sugjeronte moralin e lartë dhe drejtësinë. Ai i kushtonte një rëndësi të veçantë qëndrimit larg mëkateve dhe arritjes së dëlirësisë shpirtërore duke u penduar. Gjithashtu e theksonte me insistim përgatitjen për botën e përtejme dhe ditën e llogarisë.

Që në moshë të re e mori Teuratin në dorë dhe filloi t'i këshillonte bijtë e Izraelit. Më vonë u dërgua si peygamber për bijtë e Izraelit për të punuar me sheriatin (jurisprudencën) e Musait.¹⁷

Nga Ka'b el-Ahbari (v. 32/652) transmetohet se Jahjai ka qenë një i ri me fytyrë dhe pamje të bukur dhe me natyrë të butë.¹⁸

Bazuar te transmetimet, kuptohet se Jahjai është martirizuar në moshën tridhjetë e dy vjeçare.¹⁹ Sipas disa burimeve, ligësia e dytë prej dy ligësive për të cilat njoftohemi në suren Isra se do t'i bënë bijtë e Izraelit ishte vrasja e Jahjait dhe tentativa për të vrarë Isain.²⁰

Në hadithe njoftohet se Resulullahu (s.a.s.), përgjatë Miraxhit është takuar me Jahjain dhe Isain në qiellin e dytë, se u ka dhënë selam atyre dhe se ata i kanë thënë pasi ia kanë kthyer selamin: “Tungjatjeta o vëlla dhe peygamber i devotshëm!”²¹

Në këtë artikull pamë jetën, fëmijërinë dhe rininë e Jahjait. Në dy artikujt e ardhshëm inshallah do të shqyrtojmë virtytet etike të tij të cilat na tregohen si shembull në Kuranin Fisnik.

■ **REFERENCAT:** **1)** En'am, 90. Ibn Abdilberri, Xhamiu bejani'l-ilmi ve fadlih, korrektoi Ebi'l-Eshbal ez-Zuhejri (Daru Ibn Hazm, 1414/1994), 1: 509. **2)** Er-Risaletu'l-Kushejrije, korrektoi Abdulhalim Mahmud – Mahmud b. esh-Sherif (Kajro: Daru'l-Maarif, pa datë), 2: 354. **3)** Shik. Al Imran, 39, En'am, 85; Merjem, 7, 12, Enbija, 90. **4)** Merjem, 6; Taberi, Xhamiu'l-bejan fi te'vili'l-Kur'an, korrektoi Ahmed Muhammed Shakir (Muessesetu'r-Risale, 1420/2000), 18: 145. **5)** Buhari, “Enbija”, 43; Muslim, “Iman”, 259. **6)** Shik. Al Imran, 37-38; Taberi, 6: 359-361. **7)** Ibn Al-lan, Delilu'l-falihin, botoi Halil Me'mun Shejha (Bejrut: Daru'l-Ma'rife, 1425/2004), 7: 302. **8)** Mukatil b. Sulejman, Tefsir, korrektoi Abdullah Mahmad Shahhate (Bejrut: Daru Ihjai't-Turath, 1423), 2: 621. **9)** Zemahsheri, el-Keshshaf (Bejrut: Daru'l-Kutubi'l-Arabi, 1407), 1: 360. **10)** Mukatil, 2: 621; Taberi, 18: 143, 150. **11)** Ibnu'l-Esiri, el-Kamil fi't-tarih, korrektoi Omer Abusselam Tedmuri (Bejrut, 1417/1997), 1: 268. **12)** Ibn Kutejbe, Ujunu'l-ahbar (Bejrut: Daru'l-Kutubi'l-Ilmijje, 1418), 2: 317. **13)** Ibnu'l-Esiri, el-Kamil fi't-tarih, 1: 267. **14)** Ahmed b. Hanbel, ez-Zuhd, botoi Muhammed Abdusselam Shahin (Bejrut, 1420/1999), 65, 76. **15)** Merjem, 12; Ibnu'l-Esiri, el-Kamil fi't-tarih, 1: 268. **16)** Ahmed b. Hanbel, ez-Zuhd, 68, 76; Ibnu'l-Esiri, el-Kamil fi't-tarih, 1: 268. **17)** Tha'lebi en-Nisaburi, Araisu'l-mexhalis (Egjipt, 1370/1951), 379. **18)** Hakim, el-Mustedrek, korrektoi Mustafa Abdulkadir Ata (Bejrut, 1411), 2: 647/4150. **19)** Mustafa Asim Keksall, Peygamberler Tarihi – Historia e Peygamberëve (Ankara, 2004), 298. **20)** Mahmut Ajdën, “Jahjai”, DiA – Enciklopedia Islame e Entit për çështjet fetare të republikës së Turqisë, 43: 233-234. **21)** Ahmed b. Hanbel, Musned 2: 148; 4: 207; Buhari, “Bed'u'l-Hal”, 6, “Enbija”, 43, “Menasibu'l-ensar”, 42; Muslim, “Iman”, 259, 264.

KOHA PËR TË NISUR RRUGËN

— Selim Ajdën —

Profesor Ihsan Fazllëollu në një pjesë të librit të tij me titull “Të Gjesh Veten” shprehet: “Tradita jonë nuk e pranon pushimin në këto tri gjëra: Në ibadet, në mendje dhe në dije... Ai që bën pushim në ibadet e humb lidhjen me Allahun e Lartësuar. Ai që bën pushim në mendje, e humb lidhjen me njerëzimin. Ndërsa ai që bën pushim në dije e humb lidhjen me jetën. Kurse fundi i atij njeriu që e humb lidhjen me Zotin, me njerëzimin dhe me jetën është i qartë.” Situata në të cilën gjendet sot bota islame për fat të keq është krejt e qartë. U bënë rreth tre shekuj që civilizimi islam e ka humbur pozitën në shumë fusha kundrejt civilizimit perëndimor. Por kurrë nuk është e drejtë që të kaplohem nga dëshpërimi. Siç shprehet përsëri profesor Ihsan Fazllëollu: “Nuk duhet të harrojmë se çdo humbje është e përkohshme, sepse asnjë fitore nuk është e përhershme. Por humbja në mendje nuk ka asnjë rrugëzgjdhje. Një njeri që i fillon humbja te mendja, asnjëherë nuk mund të ketë mundësi për të arritur suksesin. Ndërkohë ne nuk jemi të obliguar me fitoren, por me përpjekjen. Kurse për të filluar ka vetëm një parim: Të nisësh rrugën... Parimet, ti dhe rruga... Pa pasur frikë se do të gabosh... Thënë me një shprehje të urtë: Gabimet që mund t’i bësh përgjatë rrugës që ke nisur me nijet të singertë, janë ushqime/furnizime për veprat e mira të tuat...”

Ashik Pashai thotë: “Kushti i parë për ta kryer punën me përsosmëri është perceptimi i mangësisë tënde. Kurse i dyti është që të kuptosh qëllimin në punën që ke bërë.” Nëse këtë shprehje të bukur do ta mbajmë vazhdimisht në mendje në lidhje me çdo punë dhe veçanërisht me zgjidhjen e problemeve të arsimit, do të ishte shumë e rëndësishme nga aspekti për të shkuar drejt qëllimit.

Për fat të keq ka një kohë të gjatë që në çështjen e arsimit shumë gjëra i kemi bërë të mangëta dhe të gabuara. Krahës kësaj, nuk e dimë se për çfarë i kemi bërë.

Ne si shoqëri akoma e kemi kokën të turbullt në kuptimin serioz të fjalës për sa i përket çështjes se çfarë duhet të presim prej arsimit. Sipas një studimi të bërë për nxënësit e gjimnazeve, doli rezultati se më shumë se shtatëdhjetë e pesë përqind e prindërve dëshirojnë që fëmijët e tyre të shkojnë në gjimnaz të përgjithshëm. Mësuesi më i mirë është bërë më-



suesi që e përgatit fëmijën për provim, jo mësuesi që i jep personalitet fëmijës... Kjo nuk duhet të jetë detyra e shkollës dhe e mësuesit... Andaj jemi të detyruar që të mendojmë përsëri si individë dhe si shoqëri se çfarë duhet të presim prej arsimit dhe se është apo jo e shëndetshme ajo gjë që presim prej arsimit.

Mirë, por çfarë duhet të bëjmë atëherë?

Gjëja që duhet bërë sigurisht se është një tërësi, por ne këtu mund të shtjellojmë vetëm një pjesë të kësaj tërësie. Këtu le t'ia vëmë veshin përsëri profesor Ihsan Fazllëogllusë i cili shprehet: “Zgjidhja para së gjithash është që t'i japim mendjes një karakter kombëtar. Kjo do të thotë kthim te historia turke. Domethënë, para së gjithash duhet të perceptojmë historinë të cilës ia kemi borxh ekzistencën tonë. Historia nga njëri aspekt është mendje, sepse edhe mendja nga njëri aspekt është historike. Zgjidhja është në histori. Ne po përfetojmë probleme ngaqë jemi një popull që kemi mbetur mbrapa historisë sonë. Ne ishim një popull filozof. Domethënë ishim një popull që e dinim se çfarë duhet të bënim, si duhet ta bënim dhe përse duhet ta bënim. Ky perceptim akoma gjendet në hirin tonë, përndryshe nuk do të flisnim dot rreth këtyre temave, por këtë hi duhet ta shndërrojmë përsëri në prush. Kjo realizohet vetëm nëpërmjet mendjes dhe informacionit. Personi apo popujt që nuk e nisin rrugën me mendje dhe informacion, më në fund shkatërrohen edhe nëse kanë njet të mirë. Kjo nuk duhet të harrohet: Ato që i kemi përjetuar si popull nga viti 1774 e deri më tani, po t'i ndodhnin ditës do të shndërrohej në natë. Por ne si popull kemi ditur ta ruajmë dritën tonë. Dëshmitari më i mrekullueshëm për këtë është lufta e pavarësisë. Andaj duhet ta fusim në funksion mendjen dhe informacionin që e ushqen atë dritë. Për këtë arsye, para së gjithash duhet ta lëmë mentalitetin e fisit që mendon si tip i vetëm dhe të fillojmë të punojmë me mentalitetin e popullit që mendon në shumë dimensionë dhe në mënyra të ndryshme në të gjithë vendin. Të tjerat vijnë vetvetiu pastaj.”

Atëherë si duhet të jetë metoda e kësaj pune?

“Metodën tonë mund ta modelojmë duke i përngjarë njerëzit që preokupohen me dije me tri gjallesa duke u frymëzuar nga Francis Baconi: Tipi i parë është dijetari si milingona. Çfarë bën milingona? Vazhdimisht mbledh, mbart dhe grumbullon në folenë e saj për t'i ngrënë në dimër. Por ato që i sjell nuk i përpunon aspak. Disa dijetarë janë të tillë. Ata

vazhdimisht mbledhin dhe grumbullojnë dije. Këta në osmanisht i quajmë malumatfurush (mbledhës të informacionit). Ndërsa tipi i dytë është dijetari si merimanga. Çfarë bën merimanga? Vazhdimisht thur rrjetë dhe pret, sepse ndonjë insekt do të kalojë andej, do të ngecë në rrjetë dhe pastaj ajo do ta hajë. Disa dijetarë janë të tillë. Vazhdimisht nxjerrin teori, krijojnë koncepte dhe formojnë modele, por përbrenda janë të zbrazët, sepse nuk mund të bëjnë fizibilitetin, nuk lexojnë dokumente arkivi, nuk studiojnë vepra të shkruara apo nuk shkojnë për të bërë hetime në terren. Ata thjeshtë ulen në tavolinë dhe bëjnë filozofi. Edhe kjo është një qasje mjaft problematike... Ndërsa dijetari i llojit tjetër është dijetari si bleta. Ai shkon lule më lule, merr nektarin, e gëlltit, e përpunon brenda vetes dhe e nxjerr. Ja pra, ne këtë e quajmë mjaltë. Edhe dija është punë e një procesi të tillë. Sigurisht se pasi të bëhet mjaltë... Material cilësor, teori cilësore... Bashkimi i këtyre të dyjave jep mjaltin...”



Të mos harrojmë se të gjitha civilizimet kanë ekzistuar me institucionet e tyre të veçanta të edukimit dhe arsimimit. Andaj nuk mund të formoni një botë që ju përket juve me institucionet e edukimit të një civilizimi tjetër. Kjo fjalë le të mos keqkuptohet. Parimet themelore të edukimit janë universale, sepse të gjithë jemi fëmijët e Ademit (a.s.)... Apo siç shprehet ministri ynë, profesor Zija Selçuku: “Ne kemi nevojë të kemi dy krahë. Kemi nevojë të mendojmë për përfaqësimin vendor të botëkuptimit universal. Për këtë arsye, jemi të detyruar të themi: Mendo në mënyrë kombëtare dhe sillu në mënyrë universale.”

Pikërisht në këtë pikë mund të themi: As “urtësia e Lindjes” nuk mjafton e vetme, as “racionalizmi i Perëndimit”, apo as “urtësia e Perëndimit” nuk mjafton e vetme, as “racionalizmi i Lindjes”. Neve na duhet vetëm njeriu që si pikë nisjeje prodhon edhe urtësinë, edhe racionalizmin... (Po ashtu edhe nisja e rrugës...)

Mevlana ka një shpjegim të mrekullueshëm që është emërtuar si metafora e kompasit e cila shpreh botëkuptimin e një myslimani. Mevlana shprehet: “Këmba me majë e kompasit është e fiksuar në fenë time, por me këmbën tjetër shëtis shtatëdhjetë e dy popujt.” Tani është koha për të nisur rrugën duke e fiksuar në civilizimin tonë këmbën me majë të kompasit dhe duke dalë në hapësirë me këmbën tjetër të lëvizshme të tij...



PARA SE TË VIJË DITA E PENDIMIT

— Ajdën Tallaj —

Besimtari e do pozitën, pasurinë, paratë dhe çdo lloj mundësie tjetër vetëm e vetëm për t'i përdorur në drejtim të kënaqësisë së Allahut Teala. Ai largohet duke shfaqur kujdes të veçantë që të mos zhytet në shpresa afatgjata, në gjëra boshe, të padobishme dhe të pakuptimta.

Hazreti Imam Gazaliu, i cili ishte prej mendimtarëve të shekullit të njëmbëdhjetë, që ka shkruar afërsisht pesëqind vepra dhe që ka edukuar nxënës për vite të gjata në Medresenë Nazimije të Bagdadit, nga e cila është përhapur civilizimi dhe dija në të gjithë botën, në veprën e tij me titull “Ihja Ulumi'd-Din” jep si shembull një popull që ka hipur në anije:

“Kapiteni e ndaloi anijen në bregun e një ishulli. Pastaj i nxori në tokë ata që gjendeshin në anije. Ai u dha leje atyre aq sa t'i kryenin nevojat e tyre dhe të ktheheshin. Për sa i përket kthimit, ai i paralajmëroi

shumë herë që të mos bëheshin vonë.

Një pjesë prej udhëtarëve, pa humbur aspak kohë, i kryen nevojat e tyre dhe u kthyen në anije duke u shqetësuar që të mos u largohej. Kur u kthyen, zunë vendet më të mira.

Ndërsa një pjesë tjetër e tyre arritën të ktheheshin me vonesë te anija për shkak se u zhytën në joshjen që u jepnin ngjyrat e llojllojshme, lulet, arrat, vreshtat dhe ndërtesat. Atyre befasisht u erdhi në mendje kthimi. Për këtë arsye, menjëherë vrapuan drejt anijes. Si rezultat, arritën të gjenin një vend të ngushtë dhe të mundimshëm.

Ndërsa disa të tjerë prej tyre u dehën nga pasuria e thesari i atij ishullit dhe e humbën veten, por në momentin e fundit ia vunë gishtin kokës. Ata nuk i lanë në asnjë lloj mënyre gjërat që i morën nga ishulli dhe për të cilat pandehnin se ishin të vlef-

shme. Këto gjëra mezi i mbartën deri te anija, por prapë se prapë u detyruan t'i mbanin në kurrizin e tyre, ngaqë në anije nuk kishte ngelur vend.

Gjithashtu, pas kishin ngelur edhe disa shokë të tyre. Ata i mbyllnin veshët dhe nuk dëshironin ta dëgjonin sirenën e anijes. Edhe pse deshën të ktheheshin në momentin e fundit, nuk gjetën vend në anije. Kështu që ngelën pa ujë, pa ushqim dhe ballë për ballë me rreziqe të tmerrshme.

“Ja, pra!” – thotë Imam Gazaliu: “Një rob me zemër të pastër dhe me kokën lart që nuk mash-trohet nga kjo botë, që e pranon atë vetëm si një mjet dhe që nuk e lejon zemrën e tij të kaplohet nga ajo, menjëherë zgjedh rrugën që e shpie te Krijuesi i tij, zë vendin e duhur dhe e përgatit veten për të dhënë llogari.”

Sa qartë që e shpjegon ky shembull gjendjen në të cilën do të bien përgjatë tubimit të madh në Ditën e Gjykimit ata që zhyten në bixhoz, lojëra, argëtime, muzikë, filma dhe gjëra të tjera të ngjashme me këto, që e kalojnë jetën pa ndonjë qëllim dhe që e harrojnë Ahiretin!

I Dashuri i Allahut, i Nderuari ynë, pagja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, thotë në një hadith që transmetohet nga Tirmidhiu: “*Çfarë (lidhjeje) ka ndërmjet meje dhe kësaj bote! Gjendja ime dhe e kësaj bote i ngjan gjendjes së një kalorësi që po ecën në një ditë vere. Kalorësit në fjalë i del një pemë përpara. Ai fle një orë nën hijen e asaj pemë. Pastaj e lë atë dhe vazhdon rrugën e tij.*”

Nëse i hedhin një sy dijetarëve osmanë dhe udhë-heqësve të edukuar të asaj periudhe, do të shohim se ata shfaqnin një kujdes të veçantë për të mos e çuar kohën dëm duke i respektuar rregullat që i ka vënë Suneti i të Dërguarit të Allahut (s.a.s.). Ata e respektuan mysafirin, e mbajtën shoqërinë, i organizuan bisedat fetare dhe i kryen vizitat ndaj njëri-tjetrit gjithmonë duke i zbatuar rregullat. Për këtë arsye, prindërit e ditëve të sotme duhet të bëhen shembull për të rinjtë edhe në të folur, edhe në sjellje. Ata nuk duhet t'i lejojnë të rinjtë që të rrëshqasin nëpër gjëra të padobishme, gjëra që i pël-qejnë nefsit, lojërat me tepri, organizime me muzikë të çmendur, filma dhe veprime që nuk përputhen me të vërtetën e realitetin. Kështu, ajeti i shtatë dhe i tetë i sures Inshirah, e cila është surja e 94-t e Kuranit Fisnik, janë udhëzuesi më i madh për ta kaluar kohën të mbushur plot:

“Prandaj, kur të çlirohesh (nga punët e ndryshme), përpigu fort (në adhurim) dhe vetëm ndaj Zotit tënd përkushtohu!”

Nisur nga ky aspekt, veçanërisht besimtarët e rinj, në çdo moment duhet ta ndjejnë veten se janë nën mbikëqyrjen e Allahut Teala dhe gjithmonë duhet të preokupohen me punë të dobishme dhe produktive. Për këtë arsye, është quajtur “masiva” çdo gjë që e lëshon njeriun në shkujdesje dhe që e pengon për të përparuar. Domethënë, kur besimtarët përpiqen t'i kryejnë punët me duart dhe fizikun e tyre, duhet të kenë si synim që t'i nxjerrin nga zemrat e tyre të gjitha dashuritë përveç dashurisë ndaj Allahut të Madhëruar dhe të Dërguarit të Tij (s.a.s.). Nëse nuk veprojmë në këtë mënyrë, shkujdesja vazhdimisht vjen duke u shtuar dhe perdja duke u trashur. Si rezultat, mund të bëhemi lodër e shejtanit, Allahu na ruajttë, duke menduar: “Gjithmonë do të jemi të shëndetshëm dhe të rinj.” Myslimanët që nuk shfaqin kujdes ndaj urdhrave dhe ndalesave të Allahut Teala, fillojnë çdo gjë ta marrin si të zakonshme. Ja pra, për njerëz të tillë Kurani Fisnik thotë kështu në ajetin e 108-të të sures Nahl:

“Këta janë ata të cilëve Allahu ua ka vulosur zemrat, të dëgjuarit dhe të parët; pikërisht këta janë të shkujdesurit.”

Ndërsa në ajetin e parë dhe të dytë të sures Enbija, Allahu Teala thotë:

“Po u afrohet njerëzve dita për të dhënë llogari, por ata vazhdojnë të jenë të shkujdesur e të shmangur (nga e vërteta). Sa herë që atyre u vjen nga Zoti i tyre ndonjë paralajmërim i ri, ata e dëgjojnë, duke u tallur me të...”

Ne duhet të shpëtojmë nga mungesa e dijes që na lëshon në shkujdesje shpirtërore akoma sa jemi të ri e të shëndetshëm dhe para se të vijë koha e sëmundjes, pleqërisë dhe e halleve e vështirësive të ndryshme. Nëse i mbledhim pjesëtarët e familjes rreth nesh dhe bëjmë mësim të rregullt çdo mbrëmje duke lexuar prej librave të tefsirit, hadithit, sijerit dhe ilmihalit, kohën do ta kalojmë në mënyrë produktive, injorancën do të mposhtim dhe do të fitojmë kënaqësinë e Zotit (xh.sh.). Nëse fëmijëve ua japim këtë traditë, edhe ua përparojmë të lexuarit, edhe ua injektojmë traditën e të lexuarit.

Në ajetin e 39-të të sures Merjem, Allahu i Lartësuar thotë duke na treguar se duhet t'ua injektojmë edhe të tjerëve ndjenjën e përgjegjësisë: **“Paralajmëroji ata (o Muhamed) për Ditën e Pikëllimit, kur do të japin llogari, ndonëse tani ata janë të shkujdesur dhe nuk besojnë.”** Prandaj, së pari le ta zbatojmë vetë, pastaj t'i paralajmërojmë edhe të tjerët...



JETA QË NUK VIHET NË PYETJE, NUK ËSHTË E JETUAR!

— Mehmet Bash —

Njeriu duhet të pyesë. Njeriu që nuk pyet, është i dënauar të skllavërohet. Çdo njeri duhet t'ia bëjë vetes pyetjet: “Përse kam ardhur në këtë botë?” dhe “Cila është urtësia e qëndrimit tim të përkohshëm në këtë botë?” Një jetë që nuk është vënë në pyetje dhe nuk i është dhënë përgjigje, nuk është reale. Një jetë e tillë, është si një çek fals.

Nëse ia dorëzojmë vullnetin tonë sistemit të kohës si një gjethe në erë, nuk mund të jemi asgjë tjetër përveçse një objekt konsumi brenda imponimit ekonomik ekzistues dhe një botëkuptimi materialist. Pra, do të ulemi vetëm në nivelin e një objekti. Nëse ia mbyllim gojën mendjes, zemrës dhe ndërgjegjes, të cilat e bëjnë njeriun më superior ndaj krijesave të tjera, atëherë nuk do të konsiderohemi më të gjallë.

Si do të jetë në fakt, po ta pyesim njëherë veten!? A kemi ardhur në këtë botë për të paguar këstet e sendeve që i blejmë me kredi? Kemi ardhur që dashurinë, të cilën nuk e tregojmë për njeriun, ta tregojmë për ndërtesat prej guri dhe makinat prej metali? Kemi ardhur për t'i vënë llozin zemrës ndaj të varfërve dhe të bëhemi servilë para të pasurve? A mos kemi ardhur në këtë botë për ta konsumuar jetën duke rendur pas gjërave të kota e të padobishme? Po, njeriu duhet të pyesë. Ai duhet ta dijë përse ka ardhur në këtë botë. Njeriu nuk e kupton dhe nuk e percepton një çështje për të cilën nuk është i vetëdijshëm. Ekzistenca jonë varet nga kuptimi që ne i japim asaj.

Ta zëmë se i shijuar të gjitha kënaqësitë e botës. Çdo ditë e jona kaloi në lumturi, pa shqetësime, pa hidhërime. Por, deri kur do të vazhdojë kështu? Çfarë tjetër ka bërë kjo botë përveçse ka bluar atë që kemi korrur në këtë jetë? Çfarë tjetër ka bërë kjo tokë që e shkelim përditë, përveçse na ka marrë të dashurit një nga një? A nuk është vendi ku do të shkojmë edhe ne?

Le ta ngremë pak kokën prej programeve të garave, ndeshjeve të futbollit dhe telenovelave ku jemi zhytur dhe të shohim trenin e jetës që është duke shkuar. A

nuk e vëmë re ndërtesën e jetës tonë se si po bëhet gërmadhë, duke iu shkëputur përditë nga një gur? A nuk u mërzitëm së pozuari lumturinë tonë falsë?

Shumica prej nesh, në bazë të besimit, e dinë shumë mirë se jeta e kësaj bote është vetëm lojë dhe argëtim. Po ashtu, në bazë të besimit, e dimë edhe se ne nuk jemi krijuar vetëm për këtë botë. E megjithatë, ne investojmë çdo gjë në jetën e kësaj bote, sikur vdekja të mos ekzistonte dhe sikur do të jetojmë përjetë në këtë botë.

Shejtani dikujt prej nesh i afrohet nga e majta dhe ai haramet i bën hallall në mënyrë të hapur. Dikujt tjetër i afrohet nga e djathta, duke ia përlyer veprat e tij të pastra me mendjemadhësi. Ai na mbyt në shirkun e fshehtë, ndërsa ne pandehim se kemi fituar. Mirëpo nuk e kuptojmë fare se kemi humbur.

Të gjithë e dimë se jeta e kësaj bote nuk është një vend i domosdoshëm, sepse, nëse do të ishte i domosdoshëm, bota nuk do të konsumohej kështu vetvetiu. Jeta shpenzohet dhe ikën duke rendur vazhdimisht pas shtëpisë, makinës dhe pozitës. Ndërkohë, pas mbetet një libër i mbushur me armiqësi, thyerje zemrash, turli farë dallaveresh dhe gjynahe të shumta.

A kaq e lirë dhe e pakuptimtë është jeta? Fakti që shumë njerëz e kanë lënë veten nën drejtimin e stomakut dhe organit seksual, a nuk tregon se ata kanë mbetur në nivelin e kafshës, në mos edhe më ulët se ato? Ndërkohë që grada më e lartë është të krijohesh si njeri dhe të dërgohesh në këtë botë si njeri, cili është kuptimi i faktit se njeriu e hedh veten në humnerën e indiferentizmit?

Ne jemi të detyruar të gjejmë të vërtetën duke ardhur rreth e qark këtyre pyetjeve dhe çështjeve. Për këtë arsye, ne themi se një jetë e cila nuk vihet në pyetje, nuk është jetuar fare. E lusim Allahun e Madhëruar që zemrat tona ta shohin bregun e së vërtetës si shpëtim dhe t'i drejtojnë anijet për në atë liman.



Siratu'l Mustekim

— Rabia Brodbeck —

Kur Ebu Bekri (r.a.), u zgjodh kalif, u shpreh:

“Unë jam zgjedhur kalifi juaj edhe pse nuk jam më i miri prej jush. Por Kurani ka zbritur dhe Pejgamberi (s.a.s.), i ka shpjeguar dispozitat e fesë. Më i dobëti i juaj te unë është i fuqishëm derisa të marrë të drejtën e vet. O njerëz! Unë pasoj vetëm rrugën e të Dërguarit të Allahut (s.a.s.). Kështu që nuk do të shpik ndonjë gjë nga vetja ime. Nëse veproj mirë, më ndihmoni. Nëse rrëshqas nga siratu'l-mustekim (rruga e drejtë), me rregulloni. Pasi e thashë këtë fjalë, i kërkoj falje Allahut edhe për vete, edhe për ju.” (Kenz, III/130, Ibn Sa'd, Mehamili, nga Urve.)

Ebu Bekr es-Siddiku (r.a.), i cili gjithmonë i qëndroi besnik Kuranit Fisnik dhe Pejgamberit tonë të Nderuar (s.a.s.), e kishte bashkuar të qenët në rrugë me jetën e tij si kalifi i Sulltanit të botëve (s.a.s.). Kurse rruga ishte rruga e të Dërguarit të Allahut (s.a.s.). Ebu Bekri (r.a.), besnikërinë që e kishte ndaj Sulltanit të botëve, Muhamed Mustafasë (s.a.s.), e konsideronte të njëjtë me besnikërinë ndaj kësaj rruge, pra, ndaj siratu'l-mustekimit. Përgjatë kësaj përpjekje gjithmonë u ka kërkuar vëllezërve myslimanë që ta këshillonin për të drejtën.

**AI QË NUK SHIKON ME
SYRIN E ZEMRËS NUK
MUND TA NJOHË TË
DËRGUARIN E ALLAHUT
(S.A.S.). AI QË NUK E
NJEH TË DËRGUARIN E
ALLAHUT (S.A.S.), NUK
MUND TA DOJË. AI QË
NUK E DO ATË, NUK MUND
TË ECË NË RRUGË ME
ATË. PEJGAMBERIN TONË
TË NDERUAR DUHET TA
DUAM DUKE ECUR NËPËR
GJURMËT E TIJ DHE DUKE
E PASUAR.**

Qenies njerëzore i është dhënë potenciali nga Allahu për ta gjetur dhe dashur Mëshiruesin Absolut. Allahu Teala e ka krijuar njeriun të aftë për ta edukuar nefsin. Njeriu ka aftësinë për të arritur pozita të larta shpirtërore. Njeriu mbart fuqinë e rezistencës e gjallërisë dhe aftësinë për të dashur. Ai mbart virtytet si dritën, dashurinë dhe mëshirën. Gjithashtu ka potencialin për të dashur pa kushte. Njeriu posedon mundësinë për ta fituar jetën, pavdekshmërinë dhe xhenetin. Posedon potencialin për të bërë vepra të mira duke bërë pendim dhe istigfar. Posedon aftësinë për

ta bërë xhihadin një stil jete. Allahu i Lartësuar thotë në Kuranin Fisnik: ***“Ne e kemi krijuar njeriun të aftë për të luftuar me vështrësitë.”*** (Beled, 4) Njeriu është qenie e nderuar, njeriu është mëkëmbës, është rob dhe qenie e përkushtuar ndaj Zotit. Allahu i Lartësuar e ka caktuar siratu’l-mustekimin, në mënyrë që njeriu ta praktikojë në jetë fuqinë e tij dhe potencialin për të dashur. Në fakt, drita e madhështisë së rrugës gjendet në thesarin e natyrshmërisë së njeriut. E fshehta e krijimit të njeriut si “ahseni takvim / krijim i përsosur” është shkaku i ekzistencës së siratu’l-mustekimit. Për këtë arsye, njeriu e ka kusht që të jetë në siratu’l-mustekim, në mënyrë që ta përdorë aftësinë për ta përparuar veten. Ndërsa njeriu më i pafat është ai që zgjedh errësirën dhe e humb aftësinë e tij.

Ata që janë në gjumin e injorancës dhe shkujdesjes, bëhen të verbër dhe të shurdhër. Atyre u mbyllet syri i zemrës dhe fillojnë të jetojnë si të vdekur. Kurse fatkeqësia më e madhe është shndërrimi i zemrës, e cila e nxë Allahun Teala ndër kohë që nuk e nxënë botët, në një zemër të vdekur. Njeriu të cilit i vdes zemra, është krijesa më e ulët, sepse e ka humbur dritën hyjnore. Allahu (xh.xh.), në Kuranin Fisnik e përshkruan si më poshtë gjendjen e atyre që janë të shkujdesur dhe në rrugë të errët: “Ata janë të shurdhër që nuk dëshirojnë ta dëgjojnë zërin e të vërtetës, memecë që gjuha nuk ua flet të vërtetën dhe të verbër që kanë frikë ta shohin madhësitë e Allahut. Për këtë arsye nuk mund ta vënë mendjen në funksion dhe nuk mund ta gjejnë të vërtetën.” (Shik. Bekare, 18.) Sa keq që ata të cilët u kanë vdekur zemrat dhe jetojnë të shkujdesur nuk mund ta dëgjojnë dot thirrjen e Pejgamberit tonë të Nderuar (s.a.s.), i cili është ftuesi më i mirë dhe fton te më e mira! Allahu i Lartësuar e përshkruar kështu këtë gjendje në Kuranin Fisnik: “O Pejgamber! Sigurisht që ti nuk mund ta bësh ta dëgjojë thirrjen tënde të vërtetë të vdekurin dhe të shurdhër nga aspekti shpirtëror. Nuk mund t’ia shpjegosh të vërtetën atij që të kthen shpinën dhe i mbyll veshët. Ti nuk mund ta shpëtosh nga batakut në të cilin është zhytur i verbëri që refuzon t’i përdorë sytë nga aspekti shpirtëror dhe nuk mund ta kthesh nga rruga e gabuar në të cilën ka hyrë. Atij nuk mund t’ia tregosh rrugën e drejtë.” (Shik. Neml, 80-81.) Në Islam nuk ka varfëri që në

fund të mos ketë pasuri, nuk ka sëmundje që të mos ketë shërim, nuk ka hall që të mos kthehet në mëshirë, nuk ka problem që të mos ketë zgjidhje dhe nuk ka vdekje që të mos ketë ringjallje. Kurse ata që dalin nga siratu’l-mustekim kaplohen nga një sëmundje që nuk ka shërim, nga një errësirë që nuk ka ndriçim dhe nga një vdekje që nuk ka ringjallje. Tashmë ata e kanë të pamundur ta arrijnë dritën e udhëzimit dhe nuk mund të marrin asnjë prej ushqimeve shpirtërore.

Një njeri që nuk di not, zhytet dhe mbytet në det. Ai që nuk e di rrugën, humbet në errësirë, devijon nga rruga dhe e braktis të vërtetën. Mevlana thotë: “Deti e mban në sipërfaqe kokën e njeriut që ka vdekur. Nëse në det bie dikush i gjallë, si mund të shpëtojë nga mbytja në të? Ja pra, pikërisht si ky, kur të vdesësh (dëliresh) nga cilësitë njerëzore, të fshehtat hyjnore do ta mbartin në sipërfaqen e detit kokën tënde.” Shemsi Tebrizi thotë në lidhje me këtë çështje: “Dorëzoju detit hyjnor. Nëse i lëkund duart e krahët ai që bie në det, deti e copëton (mbyt) atë edhe nëse është i fuqishëm si luani. Andaj veten duhet ta lësh lirshëm si i vdekur. Natyra e detit është kjo: Nëse je i gjallë, të gëlltit dhe të mbyt. Kur të mbytesh dhe të vdesësh, të nxjerr në sipërfaqe dhe të mbart. Atëherë bëje këtë që në fillim, në mënyrë që deti të të mbartë dhe ti të notosh i qetë në sipërfaqen e tij.” Mevlana Xhelaleddin Rumi dhe Shemsi Tebrizi e shpjegojnë pikën kulmore të dorëzimit ndaj Zotit me të fshehtën “vdis para se të vdesësh”. Siç nuk mbytet në det një njeri që shfaq të njëjtin dorëzim, nuk devijon as nga rruga e drejtë. Njeriu që e ka përjetuar gjendjen më sublime të dorëzimit ndaj Zotit ishte i varfër, nuk dinte shkrim e këndim dhe ishte jetim. Hazreti Ibnu’l-Arabiu e shpjegon kështu: “Nëse varfëria është heshtja e vullnetit, mosnjohja e shkrimit e këndimit janë heshtja e mendjes. Ndërsa adhurimi është heshtja e ekzistencës.”

Mevlana thotë: “O zemër e çoroditur! Ka një rruge prej shpirtit që shkon te miku. O njeri që e ke humbur rrugën! Rrugët që shkojnë te miku janë edhe të hapura, edhe të fshehta. Edhe nëse rruga të mbyllet nga të katër anët, nuk ka nevojë të frikësohesh dhe shqetësohesh, sepse thellë në zemër gjendet një rrugë që shkon te i dashuri.” Rruga që shkon në zemër është rruga e hixhretit. Rruga



që shkon në zemër është rruga e miraxhit, është rruga e takimit me Zotin, është rruga e xhenetit, afrimitetit dhe miqësisë me Zotin. Për të përparuar në këtë rrugë, zemra duhet të na digjet me zjarrin e bindjes ndaj Zotit, duhet të përpëlitet me dhimbjen e ndarjes dhe duhet të lahet (dëliret) me lotët e pendimit. Nëse një zemër e tillë bën sexhde, del në miraxh dhe aty patjetër e ndjen kënaqësinë e xhenetit, sepse fillon ta shikojë. Aty shikon bukuri në hyjnore të Allahut (xh.xh.). Përjeton kënaqësitë hyjnore që i ka përjetuar Pejgamberi ynë i Nderuar (s.a.s.), i cili ka thënë: *“Drita e syve më është dhënë në namaz.”* Dhe zhytet në dritën e ajeteve: *“Mua nuk më nxë as qielli, as toka, por më nxë zemra e robit besimtar.”* Dhe: *“Kudo që të jeni, Ai është bashkë me ju.”* (Hadid, 4) Dhe: *“Ne jemi më afër tij se damari i qafës.”* (Kaf, 13) Dhe: *“Kujtdo që Allahu ia hap zemrën për Islamën, ai është mbi një dritë nga Zoti i tij.”* (Zumer, 22)

Nevoja e vërtetë është nevoja për të kërkuar Allahun (xh.xh.). Sehl ibn Abdullah Tusteri thotë: “Kam vëzhguar në këtë rrugë dhe syrin e zemrës sime ua kam kthyer të vërtetave. Nuk kam parë rrugë më të afërt sesa nevoja dhe ndonjë pengesë më të madhe sesa pohimi.” Ahmed Shem’ani thotë: “Pa shikoje rrugën e Iblisit! Aty nuk do të shohësh gjë tjetër përveç pohimeve. Pastaj shiko rrugën e Ademit! Aty nuk do të shohësh asgjë tjetër përveç nevojës. O Iblis! Çfarë thua? ‘Unë jam më i mirë se ai.’ (A’raf, 12) O Adem! Çfarë thua? ‘O Zot! I bëmë padrejtësi vetes.’ (A’raf, 23)” Sa më shumë që njeriu të shkëputet nga kjo botë, aq më shumë i shtohet nevoja, mallëngjimi dhe etja për Zotin (xh.xh.). Gjithashtu i shtohet edhe mallëngjimi për botën e përtejme. Uria e djeg dhe e pastron papastërtinë në zemër dhe i hap rrugët e mbyllura që shkojnë drejt Dhu’l-Xhelali ve’l-Ikramit (Zotit). Mevlana ka thënë: “Pakësoje kohën që e ke ndarë për të kërkuar ujin dhe përpiku për të shtuar etjen! Atëherë uji do të shpërthejë e do të rrjedhë nga lart e nga poshtë!”

Ai që nuk shikon me syrin e zemrës nuk mund ta njohë të Dërguarin e Allahut (s.a.s.). Ai që nuk e njeh të Dërguarin e Allahut (s.a.s.), nuk mund ta dojë. Ai që nuk e do atë, nuk mund të ecë në rrugë me atë. Pejgamberin tonë të Nderuar duhet ta duam duke ecur nëpër gjurmët e tij dhe duke e pasuar. Gjurmëve të tij duhet të ecim duke e dashur atë. Atë duhet ta duam duke e zbatuar sunetin e tij. Vetëm duke e dashur dhe duke e njohur atë mund të ecim gjurmëve e tij. Nëse do ta ndjekim me sinqeritet Krenarinë e Gjithësisë, të Nderuarin tonë i cili është njeriu më i nderuar, do të trashëgojmë thesarin më

të madh të tij. Siç thuhet në Kuranin Fisnik: *“Thuaj: Nëse e doni Allahun, më ndiqni mua, në mënyrë që edhe Allahu t’ju dojë dhe t’ua falë gjynahet tuaja.”* (Al Imran, 31) Aq sa mund ta bëjmë Pejgamberin tonë të Nderuar udhërrëfyes për jetën tonë, aq na shtohet edhe dashuria që kemi për të. Ai është “Siraxhen Munira”, “Sahibu’l-Makami’l-Mahmud” dhe “Sahibu’l-Kur’an”. Për ne është drita e udhëzimit dhe dielli i profecisë dhe pejgamberllikut, sal-lallahu alejhi ve sel-lem. Ai që na e ka shpjeguar më bukur rrugën e drejtë është Habibull-llahu, Muhamed Mustafai (s.a.s.). Mevlana e shpreh në një formë madhështore këtë udhërrëfim të të Dërguarit të Allahut, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të: *“Rruga që shkon te Allahu është mjaft e frikshme, e mbyllur dhe me fitim. Muhamedi (s.a.s.), është njeriu i parë që e hodhi veten në rrezik dhe e çoi kalin në atë drejtim. Kushdo që hyn në atë rrugë, mund t’ia dalë mbanë vetëm me udhëzimin dhe udhërrëfimin e atij (s.a.s.), sepse ai është hapësi i parë i asaj rruge. Rrugës i janë vënë shenjat dhe shtyllat. Mos shko në këtë anë, mos shko në atë anë. Nëse shkon në atë anë, do të shkatërrohesh si populli i Adit dhe Themudit. Por nëse shkon në këtë anë, do të shpëtosh si besimtarët. I gjithë Kurani këtë shpjegon. “Në të ka shenja krejt të qarta.”* (Al Imran, 97) Domethënë se Ne (Zoti) i kemi vendosur kësaj rruge shenjat e rrugës.”

Kur i Dërguari i Allahut, Muhamed Mustafai (s.a.s.), foli rreth jetës së tij, u shpreh: *“Jeta ime në këtë botë është si pushimi nën një pemë i një njeriu që udhëton në shkretëtirë.”* Edhe pse veten e përngjau me një udhëtar, i Nderuari ynë (s.a.s.), ndjente një dashuri të madhe shpirtërore për t’i shpëtuar të gjithë njerëzit dhe i ka marrë përsipër çdo lloj vuajtjesh, mundimesh dhe problemesh të krijesave në gjithësi. Allahu (xh.xh.), thotë në ajetin fisnik: *“Ke marrë përsipër një barrë të papërballueshme.”* Çfarë është ajo barrë? Barra për t’i shpëtuar të gjithë njerëzit.

Imam Shafiu e shpreh si më poshtë domosdoshmërinë për të qenë në rrugë të Allahut dhe për t’u përpjekur për të përparuar në këtë rrugë cilatdo qofshin rrethanat: *“Nëse je në rrugë të Allahut, vrapo! Nëse e ke të vështirë të vraposh, ec shpejt! Nëse edhe këtë e ke të vështirë, vetëm ec. Nëse nuk mund ta bësh edhe këtë, zvarritu, por kurrë mos u kthe pas!”* Një këshillë të ngjashme me këtë e ka dhënë edhe Hafiz Sadi Shirazi: *“Në rrugë nuk duhet të hedhësh fjalën, por hapin. Pasi të mos ecësh, fjalës nuk i mbetet ndonjë kuptim.”*

TRAJTIMI ME DREJTËSI DHE NDËRGJEGJE

— M. Sami Ramazanollu —

Allahu Teala thotë:

“O ju që keni besuar! Të gjithë ju veproni me drejtësi dhe mbrojeni atë në çështjet tuaja. Nëse dëshmoni edhe për veprat ndërmjet njerëzve, dëshmoni me drejtësi edhe nëse kjo është kundër jush, kundër prindërve tuaj dhe kundër të afërmeve të tjerë. Mos u largoni nga drejtësia dhe ndërgjegjia qoftë i pasur apo qoftë i varfër ai për të cilin do të dëshmoni. Nuk është e lejuar për ju që të anoni nga ana e të varfrit për shkak të varfërisë së tij apo nga ana e të pasurit për shkak të pasurisë së tij. Sepse Allahu Teala është më meritues dhe ka përparësi ndaj të varfrit dhe ndaj të pasurit. Mos u largoni nga e vërtetë dhe mos e ndryshoni të vërtetën duke ndjekur dëshirat e nefsit tuaj. Nëse ndiqni dëshirat e nefsit tuaj, do të ndëshkoheni në ahiret, sepse Allahu është i Dijshëm për çdo gjë që ju punoni.” (Shik. Nisa, 132)

Fjala “kist” që përmendet në këtë ajet fisnik do të thotë drejtësi. Allahu i Madhëruar në këtë ajet deklaron për të gjithë robërit e Tij se duhet ta respektojnë fort drejtësinë, të kenë kujdes ndaj padrejtësisë dhe kur të dëshmojnë për veprimet apo për të gjitha çështjet, ta bëjnë këtë për hir të Allahut dhe se nuk është e lejuar që të anojnë nga njëra prej palëve kur të dëshmojnë. Bazuar në këtë, është vaxhib (obligim) që të dëshmojmë drejt edhe nëse bëhet fjalë kundër vetes apo prindërve apo të afërmeve të tjerë.

“O ju që keni besuar! Bëhuni të qëndrueshëm në urdhrat e Allahut dhe bëhuni dëshmues me drejtësi! Le të mos ju nxisë urrejtja ndaj njerëzve për të bërë padrejtësi. Bëhuni të drejtë, se kjo është më afër devotshmërisë dhe frikësojuni Allahut! Pa dyshim, Allahu është i Dijshëm për çdo gjë që punoni ju.” (Maide, 8)

Në hadithin fisnik thuhet:

“Të zbatosh drejtësinë për një orë është më mirë se gjashtëdhjetë vjet ibadet.”

Përsëri në një hadith tjetër fisnik thuhet:

“Janë shtatë grupe njerëzish të cilët Allahu Teala do t'i fusë nën hijen e Arshit të Lartë të Tij ditën kur nuk do të ketë hije tjetër përveç hijes së Arshit të Lartë të Tij. Ja pra, i pari prej këtyre është imami i drejtë. Domethënë, prijësi që çdo gjë e bën brenda kornizës së drejtësisë.”

Aishja (r.anha), thotë: Një gruaje nga fisi Beni Mahzum duhej t'i pritej dora në zbatim të dispozitës së sheriatit ngaqë kishte vjedhur diçka. Njerëzit që gjendeshin aty thanë: “Kush mund t'i kërkojë Resulullahut (s.a.s.), që asaj të mos i pritet dora?” Askush nuk guxoi t'i thoshte diçka atij në lidhje me këtë çështje. Vetëm Usame ibn Zejdi arriti t'i thoshte. Nisur nga kjo, i Dërguari i Allahut (s.a.s.), iu përgjigj Usames:

“Në kohën e Beni Israilëve nuk ia prisnin dorën dikujt prej fisnikëve nëse vidhte diçka. Kështu nuk zbatohej dispozita e sheriatit. Por nëse vidhte dikush nga të dobëtit dhe fukarenjtë, ia prisnin dorën. Nëse ajo vjedhësja do të ishte qoftë edhe vajza ime, Fatimja, sigurisht që do t'ia prisja dorën.” (Buhari)

Sipas një transmetimi tjetër, Pejgamberi (s.a.s.), e kritikoi Usamen (r.a.):

“A po ndërmjetëson për një dispozitë të sheriatit që është prej ligjeve hyjnore?” Domethënë, ky ndërmjetësim dhe kërkesë është diçka e papranueshme.

Hazreti Ebu Bekri (r.a.), pati thënë në hytben e parë të tij:

“I dobëti prej jush që ka të drejtë është i fortë te unë derisa ta marrë të drejtën e tij prej të tjerëve. Ndërsa i padrejti i fortë prej jush është i dobët te unë derisa t'i merret e drejta e të tjerëve. Nëse i bindem Allahut të Lartësuar dhe Resulullahut (s.a.s.), edhe ju mu bindni dhe më ndihmoni. Nëse gaboju, më tregoni rrugën e drejtë. Nëse e kundërshtoj Allahun e Madhëruar dhe Pejgamberin (s.a.s.), atëherë nuk duhet të më bindeni.”



RELIGJIONI DHE CIVILIZIMI

— Ali Byjkyçapar —

Religjioni i jep një zgjidhje të besueshme problemit për mbijetesën që është çështja më e rëndësishme e shpirtit të njeriut dhe i kujton këtij të fundit mëshirën dhe faljen e Allahut (xh.xh.). A është e mundur që të mendosh një fund për dëshirat dhe pasionet? Njeriu arrin te pragu i botëve të pafundme duke u nisur nga ekzistenca e vet.

Religjioni që në fillim e ka lidhur ndaj vetes njeriun për shkak të formave të pasura të mwsimeve të tij. Atë e ka ndihmuar nëpërmjet besimit që të gjejë lumturinë individuale dhe shoqërore. Falë kësaj njeriu ka shpëtuar nga tmërri i dyshimit që e bren shpirtin dhe ka arritur prehjen shpirtërore. Kështu religjioni i ka vendosur në vendin e tyre ekuilibrat e kësaj bote. Rruga që shkon drejt besimit ndaj Allahut (xh.xh.), kalon nëpërmjet fazave të interesimit, dyshimit, paragjyqimit, besimit dhe imanit. Nëse kjo nuk realizohet nën udhërrëfimin e një njeriu mjeshtër, mund të shkaktojë plagë të pashërueshme te njeriu.

Vallë si ndodh te shoqëritë ky ndryshim që ndodh edhe te njeriu?

Nevoja që ndjehet ndaj lidhjes me Allahun dhe ndaj religjionit herë pas here është dobësuar te individët dhe shoqëritë. Edhe në këtë çështje, interesimi i njerëzve me këtë botë ka qenë një faktor shumë i rëndësishëm dhe rrymat materialiste nuk dinë të marrin fund. Sa shumë që ka vuajtur umeti Islam prej kësaj anafore mendimi edhe në këtë shekull në të cilin jetojmë!

A është e domosdoshme që të formohet një lidhje ndërmjet religjionit dhe civilizimit?

Përgjatë kohërave kur shtohet interesi material, së pari prishet morali dhe pastaj sistemi i vlerave të lidhura me të. Kjo situatë ka ndikuar edhe te etika e punës dhe prodhimi. Kur është shtuar dëshpërimi dhe batakuri i skamjes, shpëtimi gjithmonë është

kërkuar te feja, por arritja te feja nuk ka qenë aspak e lehtë. Perceptimet e fetarisë që ndryshojnë me kohën, kanë shkaktuar shkatërrime të mëdha në strukturën tradicionale. Për rrjedhojë, lidhja ndaj religjionit ndërmjet teknologjisë dhe materializmit është bërë e parëndësishme. Kjo situatë i ka vonuar perceptimet e sakta.

Civilizimi nuk përbëhet nga dija, letërsia, artet e bukura, industria, teknika dhe kultura siç pandehet. Këto janë vetëm rezultatet dhe pamja e jashtme e civilizimit. Popujt që zhvillohen nga aspekti material dhe teknik, mund të mos jenë të civilizuar nga aspekti human. Pasi njeriu të mos u gjejë përgjigje pyetjeve të veta në kontekstin e të vërtetës dhe vlerave, do ta ketë të pamundur që ta gjejë rrugën drejt asaj që është absolute. Andaj përgjigjet që mund t'u jepen këtyre pyetjeve janë të rëndësishme: Si e koncepton jetën një civilizim? Me çfarë syri e sheh aspektin shpirtëror dhe material? Me çfarë syri e sheh këtë botë? Çfarë vlere i jep njeriut? Çfarë edukimi shpirtëror i jep njeriut, në mënyrë që ky i fundit të bëjë një jetë të lumtur? Si është caktuar marrëdhënia e njeriut me njerëzit e tjerë, me shoqërinë dhe me shtetin? Prej këtyre që thashë desha të nxjerr këto rezultate. Faktorët që e formojnë një civilizim duhet të jenë këta:

- 1- Botëkuptimi ndaj kësaj dynjaje
- 2- Edukimi dhe sjelljet që ua jep individëve
- 3- Botëkuptimi ndaj jetës dhe qëllimit
- 4- Besimi dhe mendimet themelore
- 5- Sistemi shoqëror, juridik dhe mental

Feja islame gjithmonë u ka dhënë përgjigje të sakta këtyre problemeve të njerëzimit dhe ne na ka sjellë deri këtu. Ndërkohë vazhdon të jetë eliksiri i jetës edhe për rregullimin e të nesërmes.

ÇFARË MBETET DHE ÇFARË HARROHET?

— Nuredin Jëlldëz —

Thonë se kur dijetari i madh, Malik ibn Enesi mbajti një fjalim të tillë kur shkroi veprën e tij të famshme me titull “Muvatta”. Për shkak se Muvatta do të thotë libër i shkruar, atë kohë kishte me dhjetëra libra që quheshin Muvatta. Librat emërtoheshin në formën “kjo muvatta, ajo muvatta...” Njerëzit që gjendeshin aty e pyetën imamin: “Këta libra mbajnë të njëjtin titull. Do të ngatërrohen titujt. A nuk do të ishte më mirë sikur t’i vendosnit një titull tjetër?” Ai u dha këtë përgjigje: “Sot mund të ketë shumë libra me të njëjtin titull, por nesër do të mbesë ai që ka qenë më i singertë për Allahun. Të tjerët do të humbin.”

Allahu e mëshiroftë Imam Malikun! Më në fund ndodhi ashtu siç tha. Tani ekziston vetëm njëri prej dhjetëra librave me titull Muvatta dhe ai përkujtohet me emrin e tij. Pra, thuhet Muvattaja e Malikut. Në fakt ai nuk deshë të shprehej: “Muvattaja ime është shkruar me sinqeritet të plotë. Andaj pohoj se e imja do të mbetet përgjithmonë.” Por sinqeriteti dhe dija e tij i kapërcyen shekujt dhe na e sollën librin e tij. Edhe ai si një imam i madh prej imamlarëve të umetit, edhe libri i tij na kanë ndriçuar. Na kanë takuar me Pejgamberin (s.a.s.) dhe sahabët. Allahu e mëshiroftë!

Nga Imam Maliku e deri më sot janë shkruar me mijëra libra dhe janë mbajtur me mijëra fjalime të cilat përbëjnë shembull për fjalën e imamit. Shumë njerëz janë përpjekur për ta ngritur veten në skenë. Pati shumë prej atyre që thanë “unë, unë”. Disave as emri nuk u mbeti në skenën e historisë. Ndërsa disa të tjerë mbetën sikur nuk vdiqën asnjëherë. Allahu Teala ua mori trupin, por ua la në jetë veprat e tyre. Kështu që librat e tyre mbetën në jetë. Fjalitë që dolën prej gojës së tyre shkuan gjuhë më gjuhë. Kurse shumë vepra që u pandehën të mrekullueshme, më në fund u mbeti vetëm një pamje e zbehtë.



Tashmë mund të përmendim një shembull tjetër me qëllimin për ta lehtësuar përshkrimin. Këtë shembull mund ta përmendim jo me qëllimin për të treguar fundin e dhimbshëm, por me qëllimin për të lehtësuar përshkrimin e çështjes:

Do të shqyrtojmë dy xhami të zakonshme pa ua përmendur emrat të cilat i kanë ndërtuar dy arkitektë myslimanë prej popullit të një shteti mysliman dhe që sot tërheqin pëlqimin tonë për shkak të vlerës historike që mbartin. Dy xhami që u janë hedhur themelet në të njëjtën periudhë, që e kanë të njëjtë stilin e strukturës dhe që gjenden në të njëjtin qytet: Në njërin prej saj shfaqet një pamje plot me falës të namazit të mëngjesit. Kurse në tjetrën sundon heshtja përgjatë kohëve të namazit. Ndërkohë xhamia është ndërtuar, në mënyrë që të falet namaz brenda saj. A mund të jetë e njëjtë xhamia që qëndron në këmbë për vizitorët me xhaminë që qëndron në këmbë për namazfalësit? Sipas nesh mund të jenë të mrekullueshme, por cilin kriter marrin parasysh engjëjt?

Kjo nuk është vetëm çështje e xhamisë, sigurisht. Fjalët që fliten, projektet që planifikohen, librat që shkruhen, mbledhjet që organizohen, premtimet që jepen, përpjekjet, mundimet... Të gjitha veprat që i bëjmë me identitetin tonë mysliman si mysliman... Meqë besojmë se çdo gjë e jona vrojtohet dhe se një ditë do të japim llogari për to, atëherë duhet të mbartim shqetësimin i cili mund t'i vërtetojë se sa jetëgjatë janë ato që bëjmë. Veçanërisht duhet të mbartim shqetësimin në lidhje me veprat dhe fjalët të cilat mendojmë se i bëjmë/themi për botën

e përtejme se a mund të rezistojnë apo jo deri në ahiret. Punët që harrohen para nesh ndërkohë që prisnim të shkonin në ahiret, duhet të jenë prej atyre që nuk merren në konsideratë. Veprat e mira që i bëjmë për hir të Allahut në pronën e Allahut dhe si robër të Allahut, do të jenë të vlefshme nëse Allahu (xh.xh.), i pranon. Këtë rezultat nuk e ndryshon asgjë, edhe nëse e quani sinjeritet, edhe nëse e quani dëlirësi.

Ndoshta po bëjmë vepra të mrekullueshme për ata që mund të shohin vetëm të sotmen në një periudhë kur është shumë e lehtë për t'i fryrë dhe ekzagjeruar e duke i bërë ngjyra-ngjyra veprat që i bëjnë njerëzit. Ndoshta këto vepra na bëjnë të lumtur. Edhe pse na duken të bukura veprat të cilat nuk i kemi testuar nëse mund të rezistojnë deri në kohën kur do të kemi dobi prej tyre, ato nuk do të na bëjnë asnjë dobi përderisa të jenë të dobëta për t'i rezistuar kohës. Nëse mund të shpëtojmë nga sëmundja e kamuflimit dhe ekzagjerimit që ka hedhur rrënjë në periudhën tonë dhe me të vërtetë është bërë më influencuese, atëherë me sinjeritetin tonë mund t'ia dalim mbanë për të bërë vepra më jetëgjata.

Le të shohim se çfarë do të mbetet për brezat e ardhshëm nga librat voluminozë, nga fjalët letrare, nga projektet që të shtojnë oreksin dhe nga mbledhjet në të cilat vendosen dhe mbledhen dosjet. Edhe nëse nuk mund t'i shohim ne, i shohin engjëjt dhe një ditë do të na njoftojnë për to. Le të shohim atë ditë se çfarë ka mbetur dhe çfarë është harruar.





“O njerëz! Pa dyshim, premtimi i Allahut
(Dita e Gjykimit) është i vërtetë, prandaj të mos ju mashtrojë
kursesi jeta e kësaj bote!..” (Fatir, 5)

Njeriu ka dëshira dhe instinkte që e lidhin atë pas kësaj bote, të cilat janë të gdhendura në natyrën e tij. Këto i japin formë të gjithë jetës së tij. Për sa kohë që forca dhe shëndeti i tij janë mirë, ai vazhdon të rendë pas këtyre dëshirave dhe instinkteve. Dëshira e njeriut për të vazhduar jetën dhe specien e vet, përpjekjet për t’u mbrojtur prej dëmeve, urisë, etjes etj., janë vetëm disa prej këtyre instinkteve. Gjithashtu, dëshira për arritjen e pasurisë së kësaj bote dhe mirësive të saj, si fama, ndikimi dhe sundimi i të tjerëve, arritja e sukseseve dhe e epërsisë, fitimi i respektit dhe reputacionit, etj., janë disa prej instinkteve të tjera njerëzore.

Këto ndjenja dhe instinkte, shfaqen në mënyrë të ndryshme tek njerëzit. Për shembull, synimi më i madh i jetës së disa njerëzve është pasuria. Dikush tjetër dëshiron famën dhe reputacionin dhe të gjithë jetën e shpenzon për këtë qëllim. Dikush tjetër dëshiron post dhe pozitë të lartë, arritja e të cilave është ambicia e tij më e madhe. Ndërsa synimi i dikujt tjetër, është gruaja dhe fëmijët, përveç të cilave nuk ka ideale të tjera. Ndonjëherë tek një njeri gjenden disa prej këtyre dëshirave njëherësh. Por njeriu vetëm sa sprovohet në këtë botë me këto dëshira dhe ambicie.¹ Pra, a do t’i përdorë këto si mjete apo si qëllime për arritjen e pjekurisë së tij shpirtërore. Po ashtu, a do të mund t’i kontrollojë njeriu këto ndjenja dhe dëshira?² Apo mos ndoshta do të hyjë plotësisht nën kontrollin e këtyre dhe do të bëjë një jetë pa pyetur për hallalle dhe harame?³ Nëse këto dëshira dhe instinkte bëhen qëllimet kryesore të njeriut, ato do të përbëjnë pengesën më të madhe të tij në aspektin e devotshmërisë ndaj Zotit të vet. Për rrjedhojë, kjo gjendje, në Kuran përkufizohet si idhujtarizim i dëshirave dhe epsheve të veta.⁴ Kjo, nënkupton rënien dhe uljen e njeriut.

Por nëse njeriu i përdor këto si mjete për të fituar kënaqësinë e Allahut, në këtë rast ai ngrihet dhe lartësohet.

Në Kuran, gjendja e popujve që u nënshtroan nga dëshirat dhe epsheet e veta, tregohen në këtë mënyrë duke iu drejtuar Profetit (a.s.): **“Lëri ata të hanë e të kënaqen dhe le t’i mashtrojë shpresa; ata do ta marrin vesh!”** (Hixhr, 3; shih. Teube, 69.)

Në përgjithësi, njeriu nuk merr mësim prej popujve të shkuar. Në fakt, që prej njeriut të parë e deri më sot, në këtë tokë kanë jetuar me miliarda njerëz, të cilët janë lidhur pas kësaj bote me një lakmi dhe një tamah të pakufishme. Por më në fund të gjithë janë bluar në mullirin e kësaj bote, janë bërë dhe, e nuk i kanë shpëtuar dot zhdukjes. Tashmë, në vendet ku ata kanë jetuar fryjnë vetëm erërat, emrat e tyre janë harruar, ndërsa fama e tyre është varrosur në thellësitë e historisë. Prej tyre kanë mbetur vetëm muret e kalave që kanë përdorur për t’u mbrojtur dhe për të luftuar, ose shtyllat e pallateve ku janë jetuar në luks.

Kurani flet për popujt e shkuar, të cilët kanë ndër-tuar qytetërime. Kanë gdhendur shkëmbinjtë dhe kanë ndërtuar strehime të forta e të sigurta.⁵ Në këtë mënyrë, ata kanë menduar se e kanë siguruar jetën e tyre. Sa keq! Gjithçka ishte e kotë, sepse ata kishin ardhur prej dheut dhe më në fund u kthyen në dhe, duke mos i shpëtuar dot zhdukjes.

Prej popujve të shkuar, kishte prej atyre të cilët u zhytën në kënaqësi e argëtime të pafundme të kësaj bote. Ata mendonin se do të jetonin gjithmonë aty, pranë kopshteve, të mbjellave, vreshtave dhe pemëve frutore në buzë të lumenjve.⁶ Ja pra, a nuk është pikërisht ky mendim shkaku kryesor që e largon njeriun prej Zotit të vet?

Disa prej popujve të shkuar, nuk i kishin marrë seriozisht paralajmërimet dhe thirrjet e profetëve

1. shih. Al-i Imran, 14; Teube, 24; Tegabun, 15.

2. shih. Naziat, 40.

3. shih. Merjem, 59.

4. shih. Xhathije, 23.

5. shih. Shuara, 26.

6. shih. Shuara, 146-148.

të tyre. Ata u thoshin profetëve se nuk mund të përzihehin në jetët e tyre dhe se ata mund të adhuronin, të hanin dhe të pinin çfarë të donin. Madje ata i thoshin profetëve se nuk mund të ndërhyjnë as në fitimet e tyre, duke ua treguar hallallin apo haramin.⁷ Po ashtu, u thoshin edhe se nuk mund të përzihehin as në jetën e tyre seksuale e të vendosnin kufij duke i ndaluar të vepronin si të donin.⁸

Kjo botë është si një sallë provimi. Për shekuj me radhë shumë njerëz kanë kaluar nga kjo sallë për të kryer provimin. Dikush fitoi, e dikush humbi. Tani është radha e turnit tonë. Bota na është lënë neve amanet, ndërsa ne i jemi lënë botës. Prej Allahut kemi ardhur dhe përsëri tek Ai do të kthehemi.

Jeta e njeriut në këtë botë kalon si një garë. Ndjenjat dhe instinktet që janë vendosur në natyrën e njeriut e detyrojnë atë të marrë pjesë në këtë garë. Lidhur me këtë, Kurani përdor termat “tefahur” dhe “tekathur”, që do të thonë garë për “epërsi mbi njëri-tjetrin, e mburrje” dhe për “zotërim të sa më shumë pasurie dhe fëmijësh”.

Në këtë jetë, njerëzit përpiqen të arrijnë epërsi ndaj njëri-tjetrit dhe mburren ndaj njëri-tjetrit me mundësitë, pozitat dhe titujt që posedojnë. Në çfarë do niveli qofshin, çdo njeri i përjeton këto ndjenja në botën e tij të brendshme. Mirëpo, njeriu nuk duhet ta harrojë garën e vërtetë duke u fokusuar vetëm në garën e kësaj bote. Dhe gara kryesore, siç thekson edhe Allahu në Kuran, bëhet për të arritur faljen e Allahut dhe xhenetet e Tij të pafundme: **“Garoni me njëri-tjetrin, duke kërkuar falje prej Zotit tuaj dhe një kopsht të gjerë sa qielli dhe Toka, që është e përgatitur për ata që i kanë besuar Allahut dhe të dërguarve të Tij...”**

7. shih. Hud, 87.

8. shih. Hud, 79.

(Hadid, 21) **“Për këto (mirësi), le të përpiqen ata që përpiqen!”** (Mutaffifin, 26)

Në këtë botë, njeriu kërkon nder dhe dinjitet. Që prej fëmijërisë, ai dëshiron të pëlqehet dhe të vlerësohet, të fitojë reputacion dhe respekt. Për këtë arsye, rritja në karrierë, zotërimi i titujve të ndryshëm, ngritja në poste të larta dhe shoqërimi me liderë dhe njerëz të famshëm, janë gjërat që ai i dëshiron më shumë. Ja pra, njeriu nuk duhet të harrojë kurrë një gjë ndërkohë që po lufton për të qenë me reputacion në këtë botë. Dhe ajo është fakti se nderi dhe dinjiteti arrihet vetëm me sexhden dhe bindjen ndaj Allahut.

Po, epërsia dhe virtyti i vërtetë, arrihet vetëm duke iu dorëzuar plotësisht urdhrave hyjnorë. Lidhur me këtë, ky ajet është shumë domethënës: **“Kush dëshiron lavdi e pushtet, ta dijë se e gjithë lavdia e pushteti i takojnë Allahut...”** (Fatir, 10)

Në jetën e kësaj bote, njeriu jeton gjithmonë me mendje drejt së ardhmes. Ai thur ëndrra dhe bën plane në lidhje me të ardhmen. Gjithmonë përpiqet të përgatisë diçka për të ardhmen dhe në këtë mënyrë mundohet të garantojë të ardhmen e tij, sepse një nga instinktet më themelore të njeriu është vazhdimësia e ekzistencës së vet. Mirëpo, njeriu nuk duhet ta harrojë as faktin se, përtej të nesërme, ka një “të nesërme” tjetër. Dhe kjo e nesërme, është dita kur do të jepet llogari para Allahut të Madhëruar. Atëherë, përgatitja për të nesërmen e kësaj bote, nuk duhet të bëhet pengesë në përgatitjen për të nesërmen pas vdekjes. Por përkundrazi, e nesërmja e kësaj bote duhet të vlerësohet si një kapital për të nesërmen e përjetshme. Kjo është edhe e vërteta që na tregon ky ajet fisnik: **“O besimtarë, frikësojuni Allahut dhe çdo njeri le të shikojë se ç’ka përgatitur për të nesërmen!”** (Hashr, 18)



FESTA E VËRTETË

URTËSIA E FESTËS

Jeta e kësaj bote është një kapital i dhuruar për të fituar Ahiretin. Jeta është koha e përpjekjes, adhurimit dhe shërbimit fetar.

Një shprehje e njohur thotë:

“Dynjaja është ara e Ahiretit.” (Axhluni, Keshfu’l-Hafa, I, 412.)

Nisur nga ajo që thamë më lart, jetën e kësaj bote duhet ta vazhdojmë pa u habitur dhe pa devijuar deri në frymën e fundit ndërmjet haufit dhe rexhasë, domethënë, ndërmjet frikës dhe shpresës ndaj Zotit (xh.sh.), sepse, nëse njeriu gëzohet dhe lumturohet në mënyrë absolute ndërkohë që nuk i dihet se si do të kalojë nga shtigjet e tmerrshme si fryma e fundit, Mahsheri dhe Sirati, kjo nuk është gjë tjetër për të veçse një mashtrim.

Zoti (xh.xh.), krahas kësaj të vërtete, na ka dhënë dy kohë gëzimi në vit, pra, dy festa: Bajrami i Fitrit dhe Bajrami i Kurbanit...

Edhe këto festa, duke u përputhur me të vërtetën e të qenit të kësaj bote bazë e mundit dhe përpjekjes, vend punimi dhe fitimi, janë shfaqur me kushte. Ato janë dhuruar si shpërblim i një pune të madhe apo i një sakrifikimi.

Nisur nga realiteti, kështu janë edhe lejet dhe pushimet e botës së edukimit dhe punës. Pas një sezoni të lodhshëm dhe të mundimshëm jepet një pushim i shkurtër për t’u gëzuar dhe për t’u rigjallëruar. Edhe në botën e arsimit pushimet jepen, në mënyrë që studentët, të cilët e kanë përfunduar me sukses periudhën e ngjeshur të mësimi, t’i sigurojnë nevojat familjare e sociale dhe ta përgatisin mendjen për një periudhë të re. Ndërsa studentët

që nuk e kanë përfunduar me sukses periudhën e mësimi, ditët e pushimit mund t’i përdorin për ta kompensuar atë që e kanë lënë mangët apo për të marrë pjesë në kurse, në mënyrë që t’i arrijnë studentët e tjerë...

Edhe festat e jetës shpirtërore vijnë pas një sprove të madhe devotshmërie.

Për shembull, Fitër Bajrami është dhënë në fund të muajit të madhërisëm të Ramazanit.

Muaji i madhërisëm i Ramazanit është periudha e ushtrimit për t’u larguar edhe nga gjërat hallall. Gjithashtu, ky muaj i begatë është koha e thellimit në ibadet, me bindjen ndaj Zotit (xh.xh.) dhe me leximin e Kuranit Fisnik. Besimtari, i cili arrin një delikatesë të madhe me agjërimin që e ka mbajtur me të gjitha organet, me taravitë, me lëmoshat dhe me namazet e natës, të cilave u ka dhënë më shumë rëndësi, në mënyrë që të arrijë Natën e Kadrit, në fund të muajit të madhërisëm të Ramazanit arrin festën e Fitër Bajramit. Festa e Fitër Bajramit kryen rolin e ceremonisë së diplomimit për marrjen e mësimave të devotshmërisë. Këto ditë gëzimi janë dhënë për të qenë si një Besmele formale e përpjekjes për t’i mbartur deri në Ramazanin tjetër gjërat shpirtërore të fituara në këtë Ramazan.

Kjo festë, në të njëjtën kohë, është edhe fillimi i ditëve të para për t’i reflektuar në jetë cilësitë e bukura që janë arritur në atmosferën e Ramazanit si mëshira, butësia, vëllazëria, sakrifica për të tjerët dhe cilësi të tjera të ngjashme me këto.

Në festën e Fitër Bajramit përjetohet gëzimi i vëllazërisë. Andaj, në këtë festë duhet të kërkohen vëllazërit, të gjenden, të pyeten për hallet dhe problemet e tyre dhe të ndihmohen. Të gjithë duhet t’i



ndajmë me njëri-tjetrit problemet që kemi. Gëzimet festohen së bashku, por edhe vështirësitë kapërcehen duke qenë të bashkuar.

Qoftë synimi i muajit të madhërishëm të Ramazanit apo qoftë synimi i festës së Fitër Bajramit që vjen në fund të Ramazanit, është reflektim në jetë i lidhjes së devotshmërisë, përshtypjes dhe vëllazërisë përgjatë gjithë jetës. Ndërsa festa e dytë që na e ka dhënë Zoti (xh.xh.), është:

KURBAN BAJRAMI

Së pari duhet të meditojmë. Përse kjo festë quhet Kurban Bajrami? Përgjigja na shpie që të meditojmë rreth jetës së Ibrahimit, alejhi's-selam. Allahu i Madhëruar në ajetin fisnik na njofton se edhe jeta e Hazreti Ibrahimit është usve hasene / shembull i bukur për ne.

Hazreti Ibrahim u sprovua me pasurinë, jetën dhe fëmijën e tij. Ngaqë këto sprova i kaloi me sukses, arriti nderin për t'u bërë Halilullah / Mik i Allahut.

Për sa i përket sprovës me jetën, ai u hodh në zjarr duke e flijuar jetën, duke u mbështetur te Zoti (xh.xh.) dhe duke e pranuar çdo gjë që vjen nga Ai. Për këtë arsye, zjarri u shndërrua në kopsht trëndafilash. Ai dha jetë dhe gjeti jetë.

Për sa i përket sprovës me pasurinë, ai e dha për hir të Allahut me gëzimin dhe qetësinë shpirtërore që të dhuron bujaria dhe arriti begatinë për t'u bërë Halil Ibrahim.

Për sa i përket sprovës me fëmijën, ai, duke e fituar sprovën e nënshtrimit dhe dashurisë ndaj Allahut Teala, fitoi nderimin me një kurban hyjnor. Fronet e përkohshme u shkatërruan, ndërsa zemra arriti nderimet hyjnore.

Nëse edhe ne mund të dalim me sukses nga spro-

vat me pasuri, me jetë dhe me fëmijët, ja, vetëm atëherë mund t'i arrijmë festat e vërteta.

Kurbani është rezultat i sakrificës. Ndërsa kandari i dashurisë është sakrifica. Sa dashuri kemi? Aq sa na e mundëson dashuria që kemi ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij (a.s.), që të jetojmë sipas fesë dhe t'i ftojmë edhe të tjerët që të bëjnë një jetë të tillë, aq është edhe sakrifica jonë. Aq sa mund të sakrifikojmë nga pasuria jonë, aq sa mund t'i harxhojmë jetën, energjinë, kohën dhe mundësitë tona në rrugë të Allahut Teala dhe në shërbim të fesë së Tij, aq është edhe dashuria jonë për Atë.

Aq sa të jetë sakrifica jonë, aq do të jetë edhe ndihma hyjnore që do të zbrësë nga qielli.

Pasurinë, jetën dhe të gjitha mundësitë tona duhet t'ia përkushtojmë rrugës së Allahut të Lartësuar si Hazreti Ibrahim dhe si Krenaria e Gjithësisë, i Dërguari i Allahut (a.s.). Allahu Teala thotë në ajetet fisnike të mëposhtme:

“Në të vërtetë, Allahu ka blerë nga besimtarët jetën dhe pasurinë e tyre, në këmbim të Xhenetit. Ata luftojnë në rrugën e Allahut, vrasin dhe vriten. (Ky është) premtimi i Tij i vërtetë në Teurat, Ungjill dhe Kuran.

E kush i përmbahet besëlidhjes më fort se Allahu? Andaj, gëzojuni kësaj shitjeje! Kjo është fitorja madhështore. (Këta janë) ata që pendohen, e adhurojnë Allahun, e falënderojnë Atë, agjërojnë, përkulen (në namaz), bien në sexhde (gjatë namazit), urdhërojnë vepra të mira, pengojnë të këqijat dhe u përmbahen kufijve të caktuar nga Allahu. Jepu lajmin e mirë besimtarëve!” (Teube, 111-112)

Ja pra, ne duhet të jetojmë duke i shfaqur këto sakrifica, në mënyrë që së fundi të arrijmë përfitime të kënaqshme dhe festa plot sihariqe...

“Nëse shikoni me syrin e zemrës, të cilin e përfitoni nga adhurimet, dhurimet, mirësitë dhe shërbimet që bëni, do të shihni edhe ngjyra të tjera përveç atyre që shihni zakonisht. Në vend të gurëve të rëndomtë, do të shihni perla e xhevahire. E çfarë është perla në fund të fundit? Ti vetë bëhesh det, bëhesh diell, që lundron e shëtiti në qiell.”

Njëri prej shembujve më të bukur të sakrifikimit të jetës dhe pasurisë në rrugë të Allahut Teala është gjyshi ynë hero, Sulltan Murat Hani.

SULLTAN MURATI

Natën në të cilën Sulltan Murati hyri në Fushën e Kosovës më 8 Gusht të vitit 1389, ishte nata e Beraetit. Atë natë doli një furtunë e llahtarshme. Pasi Murat Hani fali dy rekatë namaz, bëri këtë lutje me lot në sy:

“O Zot! Nëse kjo furtunë ka dalë për shkak të mëkateve të robit Tënd të dobët, Muratit, mos i ndëshko ushtarët e mi të pafajshëm!..

O Zot! Ata kanë ardhur deri këtu vetëm për të lartësuar emrin Tënd dhe për të predikuar Islamin!..

O Zot! Mos lejo që këta ushtarë besimtarë të mposhten dhe të shkatërrohen nga dora e qafirëve!.. Jepu atyre një fitore të atillë që të gjithë myslimanët të festojnë!.. Nëse do, rob i Yt, Murati, të qoftë kurban në ditën e kësaj feste!..

O Zot! Mos më bëj shkak për shkatërrimin e gjithë këtyre ushtarëve myslimanë! Më ndihmo dhe më fal fitore! Mua më ke bërë luftëtar. Më së fundi, më bëj edhe dëshmor me bujarinë dhe mirësinë tënde!

Amin!..”

Lutja e sulltanit u pranua. Pas fitores së Kosovës, sulltani ra dëshmor si rezultat i një atentati. Në këtë mënyrë, jetën e tij që ia pati dedikuar rrugës së Allahut Teala, e bëri kurban për hir të Zotit (xh. xh.).

Po ne, a mund ta përfetojmë këtë dedikim, këtë sakrificë dhe këtë përshpirtje flijimi të sinqertë në kauzën tonë të predikimit dhe përfaqësimit të Islamit? Ne habitemi për fitoret madhështore të gjyshërve tanë dhe për çlirimet e tyre që na bëjnë të përfetojmë një atmosferë feste, por a nuk është e obligueshme që edhe ne t’u ngajmë në përpjekje dhe sakrifica, në mënyrë që të japim të njëjtat rezultate?

Edhe një detyrë tjetër që kemi dhe që na shpie te këto përpjekje dhe sakrifica është:

MEDITIMI RRETH FALËNDERIMIT TË ZOTIT

Dashi që i zbriti Hazreti Ibrahimit duhet të na bëjë të meditojmë rreth nderimeve dhe mirësive që Allahu Teala na ka dhënë. Krijesat, të cilat na shërbejnë me mishin, qumështin dhe lëkurën e tyre... Bimët, pemët, ujërat, lumenjtë dhe malet, të cilat janë nënshtruar ndaj nesh në tokë... Përse janë vënë në shërbimin tonë dhe na janë nënshtruar gjithë këto mirësi? Çfarë sakrificash shfaqim ne si falënderim ndaj Zotit (xh.xh.), për të gjitha këto mirësi?

Le të meditojmë rreth vëllazërisë sonë fetare:

Të thellohesh në meditim... Të kërkosh dhe të përpiqesh për të kryer falënderimin ndaj Allahut Teala... Të jesh i përmalluar për t’i ndarë mirësitë me të tjerët dhe për t’i nderuar ata me ato mirësi...

Nëse mund ta kryejmë këtë detyrë, nëse mund të jetojmë vazhdimisht me devotshmëri ndaj Zotit (xh.sh.) dhe duke sakrifikuar, kjo do të ishte festa më e madhe për ne. Me mirësinë dhe ndihmën e Allahut Teala, kjo do të jetë festë edhe në frymën tonë të fundit.


Dhënia e frymës së fundit si mysliman është një festë shumë e madhe, sepse, nëse njeriu humb në frymën e fundit, nuk ka mundësi më për të kompensuar asgjë. I gjithë qëllimi i jetës është arritja e festës së dhënies së frymës së fundit si mysliman. Lumturia më e madhe e njeriut në detin e jetës të mbushur me furtuna dhe dallgë madhështore është dalja në bregun e paqes, domethënë, arritja e fatmirësisë për ta dhënë frymën e fundit si mysliman.

Ubejdullah Ahrari, rahmetullahi alejh, tregon:

“Një person i nderuar kish-te parë në ëndërr Hazreti Nakshibendin pasi pati ndërruar jetë. Atë e kishte pyetur:

“Çfarë të bëjmë për shpëtimin tonë të përjetshëm?” Hoxha i nderuar i kishte dhënë këtë përgjigje:

“Preokupohuni me atë që duhet të



preokupoheni në frymën e fundit!” Domethënë, siç mendoni vetëm për Allahun Teala në frymën e fundit, ashtu duhet të jeni të zgjuar edhe përgjatë jetës!”

Ndërkohë që fryma e fundit i jep fund udhëtimit në këtë botë, në të vërtetë është shkak për hedhjen e hapit të parë drejt një udhëtimi shumë më të gjatë. Njeriu tashmë pret Kiametin dhe ngjarjet e tmerrshme të tij. Ato do të jenë aq të tmerrshme, saqë edhe pejgamberët do ta kenë të vështirë dhe do të përpëliten për t’u strehuar te mëshira hyjnore prej zemërimit hyjnor.

Por edhe në ato çaste të tmerrshme, ata që kanë formuar miqësi me Allahun Teala në këtë botë, do të përjetojnë një atmosferë feste. Në ajetin fisnik thuhet:

“Pa dyshim, miqtë e Allahut nuk do të kenë arsye për t’u frikësuar dhe as për t’u dëshpëruar.” (Junus, 62)

A jemi vallë në arefenë e miqësisë me Allahun e Madhëruar? Apo Kiameti dhe procesi që vjen pas tij është një shteg plot dëshpërime e pikëllime për ne si rezultat i atyre që kemi bërë në jetën e kësaj bote?

A jemi aq të singertë që ta presim me entuziazëm vdekjen dhe takimin me të Dashurin si miku i Allahut Hazreti Mevlana dhe të tjerë si ai?

Njëra prej festave më të mëdha në atë ditë të mbushur plot me brenga dhe pikëllime është gëzimi i ndërmjetësimit.

Ata që kanë pasur moral të lartë, që kanë qenë të singertë dhe që kanë bërë vepër të mira për të fituar pëlqimin e Allahut Teala në jetën e kësaj bote, do ta shohin dobinë e këtyre në atë shteg të ngushtë. Ata që i kanë bërë fëmijët e tyre të përkushtuar ndaj Kuranit, rezultatit e përpjekjeve të tyre do ta marrin me ndërmjetësim. Ndërmjetësimi më i madh do të vijë nga i Dërguari i Allahut (s.a.s.). Nëse në këtë botë do të jemi afër shpirtërisht me të Dërguarin e Allahut (s.a.s.), edhe në botën tjetër do të arrijmë ndërmjetësimin e tij dhe do të hyjmë në Daru’s-Selam / xhenet bashkë me të, sepse Pejgamberi (a.s.), ka thënë:

“Njeriu do të jetë me atë që do.” (Buhari, Edeb, 96.)

Edhe arritja e festës së ndërmjetësimit do të jetë në raport me dashurinë, njohjen e Zotit (xh.xh.), singëritetin, devotshmërinë, bujarinë dhe sakrificën që kemi shfaqur në rrugë të Allahut Teala.

Ndërmjetësimi i të Dërguarit të Allahut (s.a.s.), do të jetë për ata që e admirojnë madhështinë materialo-shpirtërore dhe që e marrin për shembull gjendjen e tij. Pra, ndërmjetësimi është për ata që e duan në këtë mënyrë.

Në një dashuri të vërtetë gjendja e të dashurit kalon te ai që do aq sa ndjen dashuri në zemër për të dashurin.

Po ne vallë, sa kemi marrë nga edukata profetike e të Dërguarit të Allahut (a.s.)?

Sa kemi përvetësuar prej veçorive specifike dhe të zgjedhura të tij?

Andaj, ne jemi të detyruar ta marrim në llogari veten tonë:

Sa e meritojmë ndërmjetësimin e të Dërguarit të Allahut (s.a.s.)?

Përveç të tjerash, ka edhe një festë tjetër që është më sublime dhe më e lartë se dhënia e frymës së fundit si mysliman, se shpëtimi nga tmerret dhe pikëllimet e Kiametit e të Mahsherit dhe se festa e arritjes së ndërmjetësimit të të Dërguarit të Allahut (s.a.s.):

BUKURIA E ALLAHUT

Ata që arrijnë grada të larta në marifetullah / njohjen e Allahut Teala, domethënë, ata që shpirtërisht e ndjejnë veten me Allahun e Madhëruar, kanë edhe një festë tjetër shpirtërore. Në ajetin fisnik thuhet:

“Për ata që i frikësohen paraqitjes para Zotit të vet, do të ketë dy kopshte!” (Rahman, 46)

Ndërsa në vazhdim të kësaj sureje, thuhet:

“Nën këta dy kopshte, do të ketë edhe dy kopshte të tjera.” (Rahman, 62)

Domethënë se edhe Xheneti është shkallë-shkallë sipas gradave të devotshmërisë... Ajo festë është

**“Sa fatlum
është ai, të cilit i
është dhënë mirësia
e ndjekjes së sunetit,
urdhrave të të
Dërguarit të Allahut
(a.s.)! Sot edhe punët
më të vogla që bëhen
duke besuar se feja e tij
është e vërtetë, renditen
në kategorinë e punëve
të mëdha...”**

(Mektubati, Rabani,
Letra 44)

festa e shikimit të Allahut të Madhëruar. Ajo është një kënaqësi shpirtërore e papërkufizueshme dhe një gëzim e lumturi shpirtërore e pashoqe...

Edhe e fshehta e kaderit, i cili është shumë larg perceptimit njerëzor, do t'u zbulohet vetëm një pjese prej banorëve të xhenetit që është në gradë të lartë.

Allahu i Madhëruar na e mundësoftë që t'i arrijmë këto festa! Ndërsa festat e kësaj bote, të cilat mund t'i perceptojmë, i bëftë shkak për t'i arritur këto festa!

Gjithashtu, na e mundësoftë që t'i kuptojmë këto festa dhe t'i reflektojmë në jetën tonë cilësitë si vëllazëria, altruizmi, ibadeti, devotshmëria, bujaria dhe sakrifica, të cilat janë kusht shpirtëror i këtyre festave. Po ashtu, na e lehtësoftë që t'ia japim hakun çdo gjëje në dukje dhe ta perceptojmë thelbin e tyre, sepse zbatimi i Islamit vetëm në dukje asnjëherë nuk përputhet me vullnetin hyjnor.

Vetë Allahu i Lartësuar na fton për të menduar në thelbin e dispozitave të Tij, duke thënë:

“Tek Allahu nuk arrin as mishi, as gjaku i tyre, por arrin përkushtimi juaj. Kështu, Ai i ka vënë ato në shërbimin tuaj që ju ta madhëroni Allahun sepse ju ka udhëzuar. Dhe, jepu lajmin e mirë, punëdrejtëve!” (Haxh, 37)

Ndërsa Hazreti Mevlana thotë:

“Mos tento të bësh kurban hijen e dhisë!” Domethënë, mos e harro thelbin e ibadetit të kurbanit duke u preokupuar vetëm me formën e tij!

Besimtarët duhet ta kuptojnë thelbin e të gjitha ibadeteve.

“Perceptoje të vërtetën e namazit dhe mos qëndro te gjeometria e çështjes apo lëvizjet e edukimit fizik!..”

Edhe Allahu i Lartësuar thotë në Kuranin Fisnik:

“Kurrresi mos iu nënshtro atij (o Muhamed), por bëj sexhde dhe afroju Zotit tënd!” (Alak, 19)

“Perceptoje të vërtetën e agjërimit dhe mos qëndro te një pehriz e thatë!..”

Domethënë, medito rreth vlerës së mirësive që të janë dhuruar! Asnjëherë mos i harro ata që janë në grada më të ulëta se ti në aspektin material! Shijoji kënaqësitë shpirtërore të urisë dhe thellohu në mëshirë, dhembshuri, modesti e bujari!

“Perceptoje të vërtetën e haxhit dhe mos e pandeh

si një shëtitje apo aventurë turistike atë udhëtim të shenjtë!..”

Sepse në haxh nuk ka “refes”, “fisk” dhe “xhidal”. Domethënë, dëshirat epushore, mëkatet dhe debatet janë të ndaluara. Aty nuk ka vepra dhe sjellje të pasinqerta.

“Perceptoje të vërtetën e zekatit, infakut dhe sadakasë!..”

Kuptoje se nuk po jep nga ajo që të përket ty, por po i jep Allahut Teala atë që është e Allahut. Andaj, jep jo sikur po bën mirësi, por sikur po dorëzon një amanet, sepse Allahu i Lartësuar thotë:

“..Ata e që caktojnë një pjesë të pasurisë së tyre për lypësin dhe për nevojtarin.” (Mearixh, 24-25)

“Në pasuritë e tyre ka pasur pjesë për lypësit dhe nevojtarët.” (Dharijat, 19)

“Perceptoje të vërtetën e kurbanit dhe mos e pandeh Kurban Bajramin si ditën e kasapit apo festën e mishit!..”

Kurban do të thotë që jetën, pasurinë, fëmijët, shkurtimisht, të gjitha mirësitë që na ka dhënë Allahu Teala t'i shndërrojmë në shkak për të arritur miqësinë e Tij.

Qëllimi thelbësor i therjes së kurbanit është zgjimi i zemrave për sa i përket çështjes së nënshtimit ndaj Allahut të Madhëruar dhe i adhurimit me devotshmëri.

Nëse në jetën e kësaj bote mund t'i perceptojmë siç duhet adhurimet, veprat, festat dhe çdo gjë tjetër, me ndihmën e Allahut, do të jetë e lehtë arritja e festave të vërteta në frymën e fundit dhe në proceset pas saj.

Aliu, radijallahu anh, thotë:

“Bëj një jetë aq të përsosur, saqë njerëzit t'i marrë malli për ty sa të jesh në këtë botë dhe të përma-llohen pasi të ndërrosh jetë!”

Lum për ata që lënë një zë të mirë në këtë botë dhe nën këtë kupë qielli!

O Zot!.. Na bëj të arrijmë mirësitë hyjnore duke na dhënë suksese në sprovat me jetën, pasurinë dhe fëmijët! Na jep lumturi në frymën e fundit!.. Në atë ditë të ashpër dhe të tmerrshme, na bëj prej robërve fatlumë që do të jenë të mbrojtur nga tmerret dhe brengat dhe që do të nderohen me Xhenetin dhe bukurinë Tënde duke marrë ndërmjetësimin e Mustafasë (a.s.)!..

Amin!...

RINIA DHE KOHA E SEHERIT

— Sadik Dana —

Çdo besimtar duhet të ngrihet në kohën e seherit, të bëjë sexhde dhe të bëjë ibadet, sepse “koha e seherit është nderimi më i rëndësishëm që Allahu Teala ua ka dhuruar robërve të Tij. Koha e seherit përbëhet nga momente të shenjta dhe sublime përgjatë të cilave të gjithë të dashurit e Zotit i braktisin shtretërit e tyre të ngrohtë Në dimër dhe ia dedikojnë zemrën Krijuesit të Lartësuar. Kjo është koha kur ata e braktisin nefsën e tyre me namaz duke qarë, përgjërime, istigfare, meditime e përmendje të Allahut dhe i luten me sinqeritet Rabbu'l-Alemin (Zotit të botëve).

Koha e seherit është kohë feste në të cilën flenë njerëzit e shkujdesur dhe në të cilën rrinë bashkë me Zotin sulltanët shpirtëror duke iu përgjëruar Atij me sinqeritet dhe modesti. Kjo kohë është shkak për përparimin dhe zhvillimin shpirtëror.

Kjo është një kohë e tillë në të cilën begatia hyjnore zbret nga qielli si shi. Kjo begati shfaqet në zemrat e atyre që e kalojnë me ibadet kohën e seherit. Këtë ibadet e shoqërojnë të gjitha krijesat shpirtërore dhe engjëjt e nderuar.”

Para së gjithash jetën tonë patjetër duhet ta fusim në sistem. “Për këtë arsye, të mos rimë zgjuar deri në orët e vona të natës dhe të bëhemi prej atyre që nuk e dinë vlerën e kohës së seherit.

Ata që ngrihen në seher për të bërë ibadet, ndjehen të lehtë si një zog ngaqë përparojnë shpirtërisht. Atyre u mjafton gjumi i pakët, fillojnë të hanë pak ushqim, gjithashtu i pakësojnë edhe bisedat e pavlera. Ndërsa ata që flenë shumë gjithmonë ankohen për shëndetin e tyre ngaqë e ndjejnë trupin të rënduar, të sikletosur dhe të dobësuar.”

Disa të rinj e bëjnë jetën pa sistem dhe rregull. Për shkak të kësaj, çdo gjë që bëjnë u mbetet në gjysmë. Andaj çdo gjë duhet të jetë me rregull.

Të rinj! Edhe do t'i kryejmë detyrat tona, edhe nuk do t'i neglizhojmë mësimet, edhe do të rendim në rrugën e shërbimit fetar. Do të jemi të butë, do të kalojmë mirë me të tjerët dhe do të përpiqemi për të pasur moral të lartë. Në përshtypshmëri dhe Islam nuk ka urrejtje, smirë dhe sjellje e keqe me të tjerët. Nëse bëjmë kujdes ndaj këtyre, në një aspekt do të thotë se po zhvillohemi.

Ndërkohë që i kryejmë këto, zemrën tonë do ta lidhim me Allahun e Lartësuar. A nuk

do ta kujtojmë Allahun e Madhëruar edhe ditën ndërkohë që e kujtojmë natën? Sigurisht që gjithmonë do të jemi bashkë me Të. Kushdo që e kujton Allahun Teala më shumë, ai është më i pranuar te Zoti (xh. xh.). Për shembull, kur nxënësi të shkojë në mejtep, duhet të bëjë kujdes ndaj qetësisë dhe të sillet me edukatë. Në këtë mënyrë e përkujton edhe Allahun. Pa numra dhe pa tesbihe. Andaj ditët tona do të mundohemi që t'i kalojmë në këtë mënyrë.

“Në fenë tonë elhamdulil-lah nuk ka asnjë vështirësi. Ata që shpikin vështirësi janë ata që nuk e njohin siç duhet fenë.


Allahu i Madhëruar në bazë të mëshirës hyjnore të Tij nuk u ka ngarkuar robërve përgjegjësi të rënda. Ai vetëm kërkon që robërit e Tij ta perceptojnë dobësinë e tyre dhe ta adhurojnë e t'i binden Atij me edukatë dhe një zemër të pjekur e të përkushtuar.”

Siç duhet të jemi mesatarë në ngrënie, pirje dhe të gjitha punët e kësaj bote, kështu duhet të jemi mesatarë edhe në çështjen e ibadetit. Ne duhet të qëndrojmë larg ifratit (ekstremit) dhe tefritit (mangësisë).

Shikoni sesa shumë po zhvillohet rinia tani. Në të kaluarën, pra para dyzet-pesëdhjetë vitesh nuk ka pasur një rini të tillë. Rinia e atëhershme nuk kishte mundësi për t'u edukuar. Shkaku i kësaj ishte se nuk kishte shkolla, mejtepe dhe medrese të tilla. Po ashtu nuk kishte edhe mësues kaq të aftë dhe profesionistë. Të gjithë ishin mësues pa karakter. Kur të diskutonit me ata, ta prishnin besimin. Shikoni, ju jeni një brez shumë me fat. Allahu i Lartësuar ka dhënë shkolla, udhërrëfyes dhe mësues shumë cilësorë.

Në ditët e sotme vendi ka nevojë të madhe për të rinj të edukuar. Nesër Allahu i Lartësuar do t'ju japë pozita të larta. Inshallah do të bëni shërbime të mëdha. Por ata që rendin pa ndonjë qëllim si vagabondët, nuk janë të dobishëm as për shoqërinë, as për Islamin, as për veten e tyre.

Nëse do ta përmbledhim, mund të themi: Puna që duhet të bëjmë është që ta vlerësojmë jetën të cilën na e ka dhuruar Allahu Teala. Deri kur? Derisa shpirti të na ndahet prej trupit.





BESIMTARËT E PËRGËZUAR ME “SELAM-PAQE”

— Xhafer Durmush —

Në suren Hixhr thuhet: **“Vërtet, të devotshmit** (që frikësohen nga ndëshkimi i Allahut dhe strehohen te mëshira e Tij) **do të jenë në kopshtet e Xhenetit pranë burimeve. Atyre do t’u thuhet: “Hyni atje me paqe dhe siguri”! Ne do ta heqim urrejtjen nga zemrat e tyre; ata do të rrinë ulur si vëllezër përballë njëri-tjetrit në divane. Aty nuk do t’i mundojë lodhja e prej aty kurrë nuk do të dëbohen. Lajmëroji robërit e Mi (o Muhamed) se, vërtet, Unë jam Falësi i madh, Mëshirëploti, dhe se dënimi Im është vërtet dënimi i dhembshëm!”**¹

Kurani Fisnik së pari e thërret njeriun në besim.² Ata që hyjnë në rrethin e besimit, i inkurajon për të bërë vepra të mira, për të poseduar moral të lartë³ dhe i ndalon nga veprat e këqija.⁴ Pas këtyre vijjnë ajetet e përgëzimit dhe paralajmërimit që na njoftojnë për shpërblimin e atyre që i respektojnë urdhrat e ndalesat⁵ dhe për fundin e dhimbshëm të atyre që nuk binden.⁶ Ajetet të cilave më sipër u është dhënë kuptimi me përkthim duke filluar që nga kjo fjalia e tretë, me të vërtetë na japin shumë shpresë. A e mendoni dot! Allahu i Lartësuar do t’u thotë: “Selami-paqja qoftë për ju!”, banorëve të xhenetit dhe do t’i komplotojë duke u thënë: “Hyni atje të sigurt!” Kjo është e vlefshme për të gjithë ata që janë gjallë dhe kanë mundësi për t’u bërë këtu prej banorëve të xhenetit...

Me shpresën për të qenë të përshtatshëm për këtë, tashmë le të shohim se çfarë është devotshmëria me të cilën cilësohen “besimtarët e përgëzuar”... Siç e shohim, devotshmëria është që t’i kryejmë me kënaqësi veprat prej të cilave është i kënaqur Allahu dhe të largohemi me përpikëri prej veprave që Ai zemërohet. Po ashtu do të thotë që të qëndrojmë

larg edhe nga gjërat e dyshimta duke u shqetësuar në mos tërheqim zemërimin e Allahut. Do të thotë që të mos mjaftohemi me fetvatë në ibadete dhe marrëdhënie me të tjerët, por gjithmonë të kërkojmë atë që është më e mirë dhe këtë ta shndërrojmë në stil të jetës sonë. Në Ruhu’l-Bejan thuhet se devotshmëria është tri llojesh. Këto janë: T’i kryesh urdhrat e Allahut dhe të largohesh nga gjërat që i ka ndaluar. Të mbrohesh nga epshet e kësaj bote duke kërkuar gradat e larta të botës së përtejme. Të mbrohesh nga interesat e kësaj bote duke pasur parasysh atributet hyjnore. Lloji i parë janë njerëzit e përgjithshëm, lloji i dytë janë njerëzit e lartë dhe lloji i tretë janë elita e njerëzve të lartë.⁷

Bazuar në ato që thamë më sipër mund të shprehemi se korniza e takvallëkut, domethënë e devotshmërisë është aq përfshirëse saqë i fut brenda saj të gjitha veprat e fshehta apo të dukshme të kësaj bote apo të botës tjetër. Këto fjalë na kujtojnë këtë hadith të të Dërguarit të Allahut, alejhi’s-selam, i cili na ka mësuar që të mos e nënvlerësojmë asnjë mirësi: “*Ka dyzet sevape (mirësi). Më i larti prej këtyre është t’i japësh borxh një dhi diku që ta mjelë. Ai që e bën njërin prej këtyre sevapeve duke shpresuar shpërblimin prej Zotit dhe besuar premtimeve të dhëna në lidhje me to, Allahu Teala për shkak të kësaj do ta fusë në xhenet.*”⁸ Bashkë me këtë na kujtojnë edhe këtë hadith tjetër: “*Besimi është shtatëdhjetë (apo gjashtëdhjetë) e disa pjesë. Më e larta e këtyre është të thuash «nuk ka zot tjetër përveç Allahut». Ndërsa më e ulëta është që t’i heqësh nga rruga gjërat që i shqetësojnë të tjerët. Edhe turpi është një pjesë prej besimi.*”⁹ Siç shihet, në këto hadithe nuk është folur për tridhjetë e nëntë

mirësitë e tjera dhe për gjashtëdhjetë e nëntë pjesët e tjera. Dijetarët myslimanë, nisur nga aspekti që të mos kufizohen, janë shprehur se është më mirë që nuk janë theksuar.¹⁰

Ne mund të shprehemi kështu: Çdo veprim që myslimani e bën me njet të sigurtë, mund ta mbartë atë për të kënaqësia e Krijuesit. Për shembull, një lëmoshë që e ndihmon një nevojtar, ndarja e dhimbjes me një të përvuajtur, t'i japësh ujë apo ushqim një gjallesë duke e mëshiruar dhe shumë veprime pozitive që mund të na vijnë në mendje, mund t'i përfshijmë këtu. Secila prej gjërave që përmendëm më lart dhe që bëhet në mënyrë të sigurtë, mund të na fusë edhe ne në karvanin e të përgëzuarve. Myslmani që e mbart këtë shpresë, sigurisht se nuk e neglizhon asnjë mirësi dhe nuk qëndron indiferent kundrejt asnjë vuajtjeje. Ja pra, nëse të gjitha këto i mendojmë thellë, do të kuptohet më mirë lidhja e ajeteve që japin përgëzimin se besimtarët e devotshëm do të përshëndeten me selam në xhenet me ajetet që i inkurajojnë ata për të bërë vepra të mira.

Në ajetin fisnik thuhet se urrejtja do t'u hiqet nga zemrat banorëve të xhenetit dhe pasi t'u merret ajo sëmundje prej zemrave të tyre, u jepet përgëzimi se do të ulen përballë njëri-tjetrit nëpër divane, se nuk do të kenë asnjëherë lodhje dhe se nuk do të nxirren përjetësisht prej aty. Prej këtyre shprehjeve kuptojmë se gjëja më e rëndësishme që e pengon miqësinë dhe vëllazërinë janë ndjenjat e urrejtjes, xhelozisë dhe smirës që njerëzit kanë në zemrat e tyre. Besimtari do të qetësohet aq sa mund të shpëtojë prej këtyre ndjenjave, "atij do t'i shtohen miqtë dhe do të fillojë ta përjetojë prehjen shpirtërore të xhenetit që në këtë botë. Por nuk është aq e thjeshtë për t'i pastruar këto ndjenja të dëmshme që janë vendosur fort te nefsi."¹¹ Kështu, në ajetin fisnik që po e shpjegojmë Allahu Teala e ka marrë pikërisht vetë përsipër heqjen e urrejtjes nga zemrat e banorëve të xhenetit. Atëherë duhet të me-

ditojmë thellë rreth ajetit: "...Ne do ta heqim urrejtjen nga zemrat e tyre...", i cili është plotësuesi i

përgëzimeve hyjnore në ajetet e mësipërme. Domethënë se duhet ndjeshmëri që të mos ketë thyerje të zemrës ndërmjet besimtarëve të cilat mund të bëhen shkak për të pasur urrejtje kundrejt njëri-tjetrit. Për thyerjet e zemrës në këtë lloj mënyre duhet të shfaqen përpjekje të veçanta që të rregullohen një çast e më parë. Andaj duhet të jepen përpjekje serioze, në mënyrë që të shkojmë të pastër nga kjo barrë në botën e përtejme. Fakti që jemi informuar se këto lloj sëmundjesh shpirtërore përbëjnë pengesë për miqësinë dhe dashurinë në jetën e xhenetit, është jashtëzakonisht shumë i rëndësishëm. Nuk duhet të harrojmë se kjo shprehje në ajetin fisnik në të njëjtën kohë mund të jetë edhe një recetë prehjeje shpirtërore që mund t'ia ndriçojë jetën e kësaj bote besimtarit.

Fjalitë: "...Lajmëroji robërit e Mi (o Muhamed) se, vërtet, Unë jam Falësi i madh, Mëshirëploti, dhe se dënimi Im është vërtet dënimi i dhembshëm!", në ajetet që përbëjnë temën tonë, qëndrojnë si një "husni hatime – përfundim i mirë" i llojit "hitamuhu misk – fundi i tij është misk (i mirë)". Ndërkohë që në këto ajete përgëzohemi me mëshirën e gjerë hyjnore, paralajmërohemi se nuk duhet ta harrojmë edhe ndëshkimin e dhimbshëm. Domethënë se myslimani duhet të jetë i kujdesshëm dhe gjithmonë duhet të ketë një gjendje ndërmjet shpresës dhe frikës me kusht që aspekti i shpresës të jetë më i fuqishëm. Ky duhet të jetë kushti themelor për arritjen e përgëzimit që jepet më në krye.

REFERENCAT: **1)** Hixhr, 45-50. **2)** Shik. Surja Junus, 57; 108; Surja A'raf, 158; Surja Nisa, 174-175; 170; 1.etj. **3)** Shik. Surja Bekare, 62; Surja Maide, 69; Surja Nahl, 97; Surja Kehf, 88; Surja Merjem, 60; Surja Furkan, 70, etj. **4)** Shik. Surja Nexhm, 32; Surja Haxh, 30; Surja Huxhurat, 12; Surja Maide, 90, etj. **5)** Shik. Surja Al Imran, 144; Surja Nahl, 96; Surja Ankebut, 7, etj. **6)** Shik. Surja Enbija, 29; Surja En'am, 93; Surja Junus, 52; Surja Ahkaf, 20; Surja Tahrim, 7, etj. **7)** Ruhul-Bejan, Përkthimi dhe komentimi i Kuranit Fisnik, Ismail Hakkë Burseviu, Botimet Ekram, Stamboll, 2007, vëll. 10, fq. 232. **8)** Buhari, Hibe, 35. **9)** Muslim, Iman, 58. **10)** Rregullat për jetën nga Pejgamberi në Rijazu's-Salihin, Prof. Dr. Jashar Kandemir, Botimet Erkam, 2004, Stamboll, vëll. 1, fq. 486. **11)** Hakk'ın Daveti Kur'an-ı Kerim Meali ve Tefsiri – Thirrja e Zotit, Përkthimi dhe Komentimi i Kuranit Fisnik, Prof. Dr. Omer Çelik, Botimet Erkam, Stamboll, 2013, vëll. 3, fq. 25.



NJË SHKRIM ME PIKËPYETJE

— Neslihan Nur Turk —

Nganjëherë mendja nuk mjafton, a kanë fund pyetjet dhe perceptimet?

Fryma i përket Zotit, apo jo edhe besimi dhe falja?

Kur një njeri e humb besimin ndaj vetes, do të thotë se ka pësuar humbjen më të madhe, sepse një njeri që nuk i beson vetes, në fakt ka rënë në dobësi edhe në besimin ndaj Zotit (xh.xh.). Krahës kësaj, nëse janë të mbushura me haram kafshatat që ha, dijet që merr, qilimat që shtron dhe ajri me të cilin freskohet, sepse gjërat e dyshimta janë gjërat e dashura më afër haramit, nëse kauza për të jetuar siç beson është një vend i largët ku nuk mund të shkojë dot ai njeri, atëherë kush mund të bëjë ndonjë gjë për atë?

Mendoj se një njeri që kapet fort pas të pavërtetës, edhe kthimi i tij drejt Zotit do të jetë i fortë. Asnjë njeri nuk mund të bëjë mëkat më të madh sesa të jetë frikacak. Sipas përvojës sime e kam kuptuar në mënyrë absolute se njeriut para namazit duhet t'i shohim karakterin. A nuk mjafton Hindi, radijall-llahu anha, për atë që kërkon shembull?

Morali është një cilësi shumë e rëndësishme. Të mos shkosh në orën që ke dhënë fjalën dhe të uzurposh të drejtën e jetimit dhe nevojtarit është mungesë e moralit. Të shpenzosh pa kriter dhe të falësh namaz, në mënyrë që të të shohin është mungesë e moralit. Të të mposhtë dembelizmi dhe të jetosh duke të mbajtur të tjerët është mungesë e moralit. Domethënë se morali nuk është patjetër vetëm një çështje rreth lidhjes së dy gjinive të kundërta me njëra-tjetrën. A nuk do të ishte më mirë që të mos i kush-tëzojmë fjalët në kallëpe të ngushta kuptimi, ta lëmë dhënien e mësimit të moralit këtij e atij, të mos shtypim njerëz me sukseset tona dhe të

punojmë në lidhje me ato që kemi dështuar?

Tregtarët thonë: “Ankesën tuaj na e thoni ne. Ndërsa gëzimin tuaj shprehuni miqve tuaj.” Por ja që ndodh krejt e kundërta. Ndërkohë që ankesat ndahen me të gjithë, gëzimet kanë humbur si një rrugë mbi të cilën shtrohet asfalt. Edhe më e keqja është kjo se nuk gjendet dot një njeri të cilit mund t'i shprehësh vështirësinë, nevojën dhe ankesën në vendin ku përjetohet problemi. A e meritojmë diçka të tillë?

Nëse nuk je i lumtur, shiko shkaku brenda vetes se përse nuk je i lumtur. Përpiku për ta gjetur se për shkak të mungesës së çfarë gjëje po e përjeton atë ndjenjë. Sepse prehjen shpirtërore mund ta gësh vetëm duke gjetur shkaku e vërtetë të dëshpërimit dhe duke bërë atë që duhet. Ai shkak i vërtetë në shumicën e rasteve gjendet brenda teje. Ai është fshehur aty. Andaj gjeje! Në fakt, a nuk je përgjegjës më së shumti për të ndryshuar veten dhe vetëm kaq ke fuqi të bësh?

Çdo gjë rregullohet! Koka qetësohet, zemra qetësohet, shtëpia, dhoma, dollapët dhe vatra mblidhen... Mirë, por cila është puna jote? Puna jote është që të mos shkatërrosh duke u mposhtur prej problemeve dhe të gësh rrugën për ta mbledhur veten dhe situatën. Kjo botë është vendi i sprovës! Kështu që duhet të përgatitesh në formën më të mirë për ta ndërë përgjigjen e pyetjeve të sprovës para se kjo e fundit të të vijë, sepse ajo me shumë mundësi mund të të dalë përballë në çdo moment. Për këtë arsye, shfaq përpjekjen e nevojshme, në mënyrë që të mos mbetesh i detyruar që të sorollatesh i dëshpëruar e i pikëlluar. Sepse, çrregullimi i zemrës nuk vonohet aspak

dhe përhapet në të gjithë trupin. Çdo çrregullim që reflekton në trup, i fut në vështirësi pak edhe më shumë ata që ka përreth. Bashkë me çdo njeri që e fut në vështirësi, ia shton pak edhe më shumë barrën supeve të tua me shkeljen e të drejtës së tjetrit. A është e nevojshme që ta bësh këtë?

Luani e nxjerr veten në pah nga vendi ku shtrihet, lopa nga qumështi që jep, bleta nga mjalti që bën dhe njeriu nga puna që kryen. Nëse je kuzhinier, për ty flet ushqimi që gatuan. Nëse je gjuetar, për ty flet preja jote. Atëherë ki mëshirë për veten, lëri fjalët e panevojshme dhe shtoji punët e tua të dobishme, të mira dhe të nevojshme. A nuk është një veprim më i zgjuar ky?

A nuk është preokupim me diçka të pavlerë edhe sipas jush fakti që prindërit të cilët dëshirojnë t'i edukojnë fëmijët e tyre si Hazreti Fatimja, po i edukojnë ata në institucione që kanë një edukim të pamoralshëm? Cila mendje mund ta pranojë që të ndalet në mes të rrugës, në mënyrë që të mos e përplasnin makinat? A nuk është mashtrim që të shpresosh të mos mbytesh duke u hedhur në det pa mësuar notin? Nëse ndonjë mizë të shkon rreth e rrotull dhe ulet shpesh në kokën tënde, para se të marrësh në dorë diçka për të vlarë mizën, thirri mendjes e ndërgjegjes dhe shiko se çfarë ka te ti që e tërheq mizën. Kurdo që të biesh në vështirësi, kështu vepro. Para së gjithash dhe vazhdimisht shiko pasqyrën e ndërgjegjes tënde. Nëse gjendesh në vendin e duhur dhe vepron në mënyrën e duhur, në përgjithësi nuk përjeton ndonjë problem. Por nëse gjendesh në vend të gabuar dhe vepron në mënyrë të gabuar, atëherë çfarë faji ka belaja? Nëse fajëson të tjerët, do të përjetosh kriza shpirtërore. Nëse e gjen fajin te vetja jote, do të arrish prehjen shpirtërore. Përse i thashë këto? Sepse kjo është detyra ime, sepse je i-e shtrenjtë për mua, sepse je vëlla-motra ime në fe, apo jo?

Andaj eja! Ji vetvetja dhe mos u preokupo me këdo që të del përpara! Ji vetvetja dhe mos e shpërndaj çfarëdo që të vjen në dorë! Sigurisht që nuk duhet ta marrësh mbi supe krejt barrën e kësaj bote, por edhe botës mos ia lër krejt barrën tënde. Nëse kërkon rehati për vete, jepu rehati të tjerëve. Sa njerëz të cilët i akuzon se nuk të lënë të qetë, kanë gjetur prehje shpirtërore? A je interesuar ndopak për këtë? Nëse jo, interesohu. Ndërsa që thashë për t'u interesuar, meqë më erdhi në mendje, mos i mbyll brenda vetes pyetjet e tua duke menduar se janë budallallëqe, sepse ato mund të rriten dhe Allahu na ruajt, mund t'i shkaktojnë dëme besimit tënd. Kur të gjesh dikë që i beson besnikërisë së tij, mos hezito dhe mos bëj vesvese, por interesohu duke e pyetur, në rregull?

Nëse dëgjon se janë bërë thashetheme në lidhje me ty, madje edhe nëse dëgjon se kanë thënë për ty: "Ai është një i sëmurë. Ne ia lëmë mangët atij. Andaj lërjani edhe ju!", as mos u habit, as mos kundërshto. A nuk është e vërtetë? Krejtësisht është

e vërtetë! Po, të gjithë jemi të sëmurë! Sëmundja e dikujt është vuajtje për vetë atë, kurse sëmundja e dikujt tjetër është vuajtje për të tjerët që ka rreth e rrotull. Dikush ka trupin të sëmurë, dikush ka ndjenjat, dikush tjetër ka mendimet... Pikërisht si dikush që kapet nga gripi, dikush nga lija dhe dikush tjetër nga kanceri. Ja pra, edhe sëmundjet shpirtërore kështu janë, lloj-lloj dhe shkallë-shkallë... Atëherë në vend që të mërzhitesh se kanë thënë që je i sëmurë, lutu për kryemjekun, sepse në fakt ai e ka punën të vështirë. Sepse ai nuk preokupohet vetëm me ne, por është i detyruar të preokupohet edhe me shumë të tjerë që janë të sëmurë si unë dhe ti. Madje te ai shkojnë jo vetëm problemet e të sëmurëve, por edhe të budallenjve dhe të të vdekurve që jetojnë. Nëse them: "Allahu i dhëntë vazhdimësi në shëndet atij dhe na dhëntë shërim për të sëmurët tanë!", a do të thuash amin?

Nëse dëshiron të shohësh kapacitetin tënd, vrapo derisa të të lërë fuqia. Momenti kur nuk mund të vraposh më është momenti kur e ke përdorur deri në fund aftësinë tënde dhe kur shpëton nga përgjegjësia. Nëse nuk është kuptuar mjaftueshëm, atëherë le ta shpreh edhe kështu: Ty, vëlla dhe motër, po të them që të vdesësh në rrugën që beson! A mund t'ia dalësh mbanë për ta bërë këtë?

Nganjëherë sprovohesh me gjëra që të vijnë përpara, por nuk ta japin dorën (nuk bëhen të tuat). Nganjëherë me gjëra që janë larg dhe i kërkon për t'i gjetur. Ti mund të kesh shpresë përderisa të gjendesh afër atyre që janë më të mirë se ti. Atëherë jepi nefsit tënd pjekurinë që së pari ta pranojë ekzistencën e atyre që janë më të mirë dhe pastaj fuqinë për të qëndruar bashkë me ata, sepse qëndrimi me më të mirët do të thotë që të vuash më shumë. Dikush prej tyre është si speci djegës që kur ka kafshosh thua: "U dogja!", kurse dikush tjetër është si reçeli me të cilin lyen bukën dhe e ha. Po ti si cili je? Kështu që njihe veten dhe vlerësoje. Kur them spec djegës, nuk e kam fjalën vetëm për specin, por për çdo gjë që të shkakton vuajtje.

Një njeri rreth moshës tridhjetë vjeçare ndërroi jetë për shkak të infarktit në zemër para një kohe shumë të shkurtër. Një nënë e re dha shpirt kur po bënte lindjen e dytë. Po ashtu ka shkuar (vdekur) edhe ai që sapo i kishin dalë thinjat apo sapo i kishin dalë mustaqet. A nuk ke dëgjuar aspak për këta? A ti i ke krijuar ato mirësitë që nuk i ndan dot me motrat dhe vëllezërit e tu? A nuk do të na pyesin nesër në varr të gjithëve: A ishe kaq budalla sa që nuk e mësove dot se nuk do të rriësh përgjithmonë në dynja?

Andaj rishikoje edhe një herë hallin dhe zgjidhjen e tij. Nëse halli yt është suksesi dhe lumturia e motrave dhe vëllezërve dhe zgjidhja është pikëllimi dhe turpërimi i atyre, atëherë a nuk ka ndonjë gabim këtu? Nganjëherë mendja nuk mjafton, a kanë fund pyetjet dhe perceptimet? Fryma i përket Zotit, apo jo edhe besimi dhe falja?



MARRËDHËNIA NDËRMJET DEVOTSHMËRISË DHE UDHËZIMIT NË KURAN

— Durak Pasmaz —

Në ajetin e dytë të sures Bekare, e cila është surja më e gjatë e Kuranit Fisnik, thuhet: **“Ky është Libri në të cilin nuk ka dyshim. Ai është udhërrëfyes për të devotshmit.** (Atyre u tregon rrugën e drejtë dhe i shpie drejt udhëzimit).”

Këtu na vinë në mendje dy pyetje:

1) Fjala mutteki që përmendet në ajet, në fakt do të thotë njeri që e ka gjetur rrugën e drejtë dhe është udhëzuar. A ka ndonjë kuptim dhe ndonjë dobi shprehja ‘i udhëzon njerëzit e udhëzuar’?

2) A është Kurani udhërrëfyes drejt udhëzimit vetëm për të devotshmit? A nuk ua tregon rrugën e drejtë të tjerëve? Përse udhëzimi është specifikuar vetëm ndaj të devotshmëve?

Pyetjes së parë mund t’i përgjigjemi në dy forma:

1) “I udhëzon të devotshmit-të udhëzuarit” do të thotë se i mban vazhdimisht të udhëzuar dhe i bën të qëndrueshëm në udhëzim. Në letërsinë arabe ka përdorime të këtij lloji. Për shembull, një njeriu të vlefshëm dhe të respektuar i thuhet: “Allahu të nderoftë dhe të bëftë të respektuar!” Nëpërmjet kësaj prej Allahut kërkohet që gjendja e mirësisë që ka ai person të jetë e vazhdueshme dhe e qëndrueshme. Pikërisht si shprehja: “Na udhëzo në rrugën e drejtë!”, në suren Fatiha. Ndërkohë kuptimi i kësaj shprehjeje është: “Na bëj të vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm në rrugën e drejtë.”¹

2) Kurse forma e dytë e shpjegimit është kështu: Akoma nuk është i devotshëm, por do të bëhet në të ardhmen. Ja pra, ‘muttakin’ është thënë duke marrë parasysh gjendjen në të ardhmen. Për shembull,

kuptimi i shprehjes: “E shoh veten në ëndërr duke shtypur verë.”², në suren Jusuf është: “E shoh veten në ëndërr duke shtypur rrush për të bërë verë.” Pra, këtu është theksuar gjendja e mëvonshme e rrushit.³

Edhe emërtimi në formën “muttakin-të devotshëm” që u ka bërë Allahu atyre, është bërë duke u marrë parasysh gjendja e tyre në të ardhmen.

Ndërsa pyetjes së dytë mund t’i përgjigjemi në këtë mënyrë:

Kurani Fisnik është udhërrëfyes për të gjithë njerëzit. Ai ua tregon rrugën e drejtë të gjithë njerëzve. Gjithashtu u mëson Zotin dhe të vërtetën. Duke u marrë parasysh kjo veçori e Kuranit, në ajetin e 185-të të sures Bekare është thënë: “Huden linnas / Udhëzues për të gjithë njerëzit.” Por në ajetin fisnik është theksuar kjo, ngaqë vetëm të devotshmit ndërmjet njerëzve ua vënë veshin më së miri mesazheve hyjnore në Kuran dhe janë ata të cilët përfitojnë më së shumti nga udhëzimi i tij.

Në të vërtetë, në Kuranin Fisnik ka një ajet që shprehet se Kurani është udhëzues për të gjithë njerëzit.⁴

Ka ajete që tregojnë se Kurani është udhëzues për besimtarët.⁵ Ka ajete që thonë se Kurani është udhëzues për myslimanët.⁶ Ka ajet që thotë se Kurani është udhëzues për botët.⁷ Ka ajet që thotë se Kurani është udhëzues për punëmirët.⁸ Ka ajet që thotë se Kurani është udhëzues për mendarët.⁹ Ka ajet që thotë se Kurani është udhëzues për popullin që beson në mënyrë absolute.¹⁰ Dhe së fundi ka ajete që tregojnë se Kurani është udhëzues për të de-

votshmit. Asnjëra prej këtyre shprehjeve nuk është në kundërshtim me të tjerat. Në fakt, Kurani është dërguar si udhërrëfyes drejt udhëzimit për të gjithë njerëzit, madje për të gjithë botët. Por ulul-elbab/mendarët, besimtarët, punëmirët dhe të devotshmit janë përmendur në mënyrë të veçantë ngaqë janë njerëzit që përfitojnë më së shumti prej udhëzimit të Kuranit ndërmjet të gjithë njerëzve të tjerë.

Për shembull, në ajetin e 138-të të sures Al Imran thuhet: “Kurani është një shpjegim i qartë për njerëzit dhe udhëzim e këshillë për të devotshmit / ata që bëjnë kujdes për të mos i kundërshtuar urdhrat e Allahut.” Në këtë mënyrë është bërë e qartë se Kurani Fisnik është një lajm i qartë, udhëzues dhe këshillues për njerëzit në përgjithësi dhe për të devotshmit në veçanti.

Ndërsa në ajetin e 57-të të sures Junus thuhet: “O njerëz, ju ka ardhur këshillë (Kurani) nga Zoti juaj. Ai është shërim për ata që kanë sëmundje në zemër dhe udhëzim, mëshirë dhe udhërrëfyes për besimtarët.” Në këtë mënyrë u bëhet thirrje të gjithë njerëzve. Ndërkohë tregohet edhe domosdoshmëria për t'i besuar atij, në mënyrë që të përfitohet nga këshilla dhe udhërrëfimi i tij.

Po, Kurani Fisnik është një libër udhëzimi. Është një libër udhërrëfimi. Për këtë nuk ka asnjë dyshim. Bazuar në rëndësinë e kësaj çështjeje, kjo e fundit është përsëritur nëpër ajete të ndryshme:

“Në të vërtetë, ky Kuran udhëzon drejt asaj që është më e mira dhe u jep lajmin e gëzuar besimtarëve, që bëjnë vepra të mira, se ata do të kenë shpërblim të madh.” (Isra, 9)

“...Ne ta zbritëm ty Librin, si shpjegim për çdo çështje, si udhërrëfyes, si mëshirë dhe si lajm të mirë për myslimanët.” (Nahl, 89)

Nuk ka aspak dyshim se Kurani Fisnik është një libër udhëzues. Por e rëndësishme është që ne të jemi në rrugë të drejtë, në mënyrë që të përfitojmë nga udhëzimi i tij. Me të vërtetë, a përfitojmë vallë

nga udhëzimi i Kuranit? Nëse përfitojmë, atëherë kjo është diçka mjaft e bukur. Zaten kjo është ajo që kërkohet prej nesh. Nëse nuk përfitojmë dot, atëherë çfarë duhet të bëjmë për të përfituar prej tij. Ka shumë gjëra që mund të thuhën për përfitimin tonë nga Kurani. Si përmbledhje mund të themi këto:

Për të përfituar nga udhëzimi i Kuranit Fisnik para së gjithash duhet të besojmë se ai është fjala e Allahut (xh.xh.) dhe se na është dërguar për të na treguar rrugën e drejtë dhe për të na mësuar të vërtetën. Ai që nuk beson se Kurani është fjalë e Allahut, nuk mund të përfitojë siç duhet nga të qenët e tij udhëzues dhe udhërrëfyes.

Kuranin apo përkthimin e tij nuk duhet ta lexojmë sikur po lexojmë një libër të zakonshëm, për shembull siç lexojmë një roman, por duhet ta lexojmë me kujdes duke e pranuar se ai është një tekst i shenjtë. Duhet të përipiqemi për t'i konceptuar kuptimet dhe urtësitë e tij dhe duhet të mendojmë thellë në lidhje me të.

Kur ta lexojmë Kuranin, duhet t'i lëmë mënjatë mendimet e nxituara dhe paragjykimet tona. Duhet t'ia vëmë veshin mesazhit universal të Kuranit dhe duhet të përipiqemi për ta kuptuar atë që thotë dhe atë që kërkon prej nesh.

Për këtë arsye, nuk duhet të mjaftohemi duke e lexuar Kuranin një herë të vetme siç bëjmë me librat e tjerë, por atë duhet ta lexojmë vazhdimisht. Nëse veprojmë kështu, do të vëmë re se në zemrën tonë do të lindin kuptime të reja që nuk patën lindur përgjatë leximeve të mëparshme, se do të na hapet horizonti pak më shumë dhe se zemra do të arrijë prehjen shpirtërore.

Nëse i bëjmë të gjitha këto për të përfituar nga udhëzimi i Kuranit Fisnik, prapë se prapë nuk janë të mjaftueshme. Andaj atë duhet ta lexojmë dhe t'i praktikojmë e zbatojmë në jetë ato që mësojmë prej tij. Zaten edhe libri ynë i shenjtë, Kurani Fisnik për këtë është zbritur. Pra, ky është qëllimi kryesor i tij.



PËR TË PËRFITUAR NGA UDHËZIMI I KURANIT FISNIK PARA SË GJITHASH DUHET TË BESOJMË SE AI ËSHTË FJALA E ALLAHUT (XH.XH.) DHE SE NA ËSHTË DËRGUAR PËR TË NA TREGUAR RRUGËN E DREJTË DHE PËR TË NA MËSUAR TË VËRTETËN. AI QË NUK BESON SE KURANI ËSHTË FJALË E ALLAHUT, NUK MUND TË PËRFITOJË SIÇ DUHET NGA TË QENËT E TIJ UDHËZUES DHE UDHËRRËFYES.

■ **REFERENCAT:** 1) Zemahsheri, Keshshaf, I; Nesefi, Medarik, I. 2) Jusuf, 36. 3) El-Belagatu'l-Vadiha, fq. 109-110. 4) Shik. Bekare, 185. 5) Shik. Bekare, 97; A'raf, 52, 203; Ju'nus, 57; Jusuf, 111; Nahl, 64; Neml, 2, 77; Fussilet, 44. 6) Shik. Nahl, 89, 102. 7) Shik. Al Imran, 91. 8) Shik. Lokman, 3. 9) Shik. Gafir, 54. 10) Shik. Xhathije, 20.



MBI NATYRËN E VËRTETË TË LUMTURISË

— Shah Velijullah Dehlevi —

Ti duhet ta dish se njeriu ka një përsosmëri nga forma specifike, dhe një përsosmëri nga pozita e llojit njerëzor, në terma të gjinisë së afërt dhe të largët. Lumturia (fundore), mungesa e së cilës është e dëmshme për njerëzit, dhe për të cilën njerëzit me arsye të shëndoshë përpiqen fort, është njëra prej këtyre dy përsosmërive.

Është kështu për shkak se një person zakonisht mund të çmohet për cilësi që ai i ka të njëjta me trupat minerarë, siç është gjatësia dhe lartësia e madhe, dhe në qoftë se “lumturia” (se’ade) do të përbëhej nga këto, atëherë vargmalet do të iëshin më të përmbushur në mirëqenie. Ose një person mund të çmohet për cilësi që ai i ka të njëjta me bimët, siç janë rritja e duhur dhe dukja me konture të bukura dhe trajta rrezatuese, kështu që nëse mirëqenia do të përbëhej nga këto, atëherë zambaku dhe trëndafili do të kishin një përsosmëri më të plotë. Ose një person mund të çmohet për cilësi që ai i ka të njëjta me kafshët, si forca e madhe, zëri i lartë, të qenit epsharak, të ngrënit dhe të pirit pa kufi, dhe të pasurit me bollëk të zemërimit dhe zilisë; dhe sikur lumturia të përbëhej nga këto gjëra, atëherë gomari do të kishte lumni më të plotë.

Veçoritë që janë karakteristike për njeriun, sikurse janë vritytet e kultivuara, mbështetjet e shëndosha për qytetërim (irtifatat), aftësitë prodhuese/artizanale të larta, dhe pozita e lartë – menjëherë krijohet përshtypja se këto janë lumturia e mbrame e njerëzve. Kështu, ti do të shohësh se në çdo komb të njerëzimit ata të cilët kanë përshquajtësi më të

madhe, si dhe gjykim më të shëndoshë, dëshirojnë t’i shtiejnë ato në dorë; dhe se ata i cilësojnë sitribute jo të lëvdueshme gjërat që janë të ndryshme prej tyre. Mirëpo, problemi në fjalë sërish nuk është formuluar me saktësi, për shkak se baza e këtyre (cilësive të lëvdueshme) gjendet edhe në mesin e kafshëve individuale. Kështu, guximi bazohet mbi zemërimin, mbi dashurinë për hakmarrje, mbi palëkundshmërinë në fatkeqësi, dhe mbi përparimin në situata të rrezikshme, dhe të gjitha këto gjenden me tepri te shtazët e gjinisë mashkullore. Megjithatë, ai nuk quhet “guxim” deri sa rrezatimi i nefsit racional t’i rafinojë ato, kështu që ato të bëhen të udhëhequra nga qëllimi universal dobiprurës dhe të shfaqen në sajë të një motivimi të arsyetuar. Në mënyrë të ngjashme, baza për aftësitë prodhuese/artizanale të gjymtyrëve gjendet te kafshët, si trumcaku që ndërton foleza. Dhe përnjëmend, shumë gjëra që kafshët i bëjnë natyrshëm, njeriu nuk mund t’i bëjë as me mundimin më të madh. E vërteta, përkundrazi, është se kjo lumturi është e rastësishme, dhe se lumturia e vërtetë është udhëzimi i kafshërës nga fryma rationale, bindja e pasioneve ndaj arsyes, ku fryma rationale nënshtron kafshëroren, dhe arsyeja bëhet dominante mbi pasionet. Të gjitha karakteristikat e tjera janë të papërfillshme.

Ti duhet ta dish se çështjet që përfshihen në lumturinë e vërtetë ndahen në dy kategori.

1) Njëra kategori përfshihet nën temën e shfaqjes së rrezatimit të nefsit (frymë/vete) rationale në jetën e përditshme nëpërmjet dekretit të prirjes

së lindur (xhibbile). Është e pamundur që virtyti i dëshiruar të përftohet nëpërmjet kësaj kategorie, por ndonjëherë një kredhje në këto akte mund të ndodhë për shkak të të qenit të tyre joshëse, sidomos nëpërmjet një koncepti fragmentar, si në rastin e personit të mangët; kjo në kundërdallim me përsosurinë e dëshiruar. Një shembull do të ishte personi i cili dëshiron të përftojë guxim nëpërmjet provokimit të zemërimit, konfliktit, dhe kështu me radhë; apo ai që dëshiron të përftojë gojëtarinë nëpërmjet njohjes së poezisë dhe oratorisë arabe. Virtytet (akhlak) shfaqen vetëm nëpërmjet kontaktit me pjesëtarë të tjerë të llojit, dhe mbështetjet për qytetërimin fabrikohen vetëm në kundërpërgjigje ndaj nevojave të rastit, dhe aftësitë prodhuese/artizanale të gjymtyrëve realizohen vetëm nëpërmjet veglave dhe materialeve; dhe të gjitha këtyre gjërave u vjen fundi me shuarjen e jetës së kësaj bote. Kësisoj, në qoftë se personi i mangët vdes në këtë konditë, duke qenë ai i urryer, ai mbetet pa përsosmëri. Në qoftë se imazhet e këtyre lidhjeve (dynjasore) kapen fort pas nefsit së tij, atëherë dëmi që i bëhet atij është më i madh se sa dobia.

2) Kategoria e dytë ka në shpirtin e saj pozitën e nënshtrimit nga ana e kafshërores ndaj forcës ëngjëlllore, kështu që e para sillet në përputhje me frymëzimin e ëngjëlltores dhe bojatiset nga ngjyresa e saj, ndërkohë që ëngjëllorja e pengon atë që të marrë ngjyrat e botës, dhe e pengon që mbi të të vulozen shenjat e saj si shenja e unazës-vulë mbi dyll. Kjo nuk mund të ndodhë kurrsesi nëse ëngjëllorja (forca) nuk kërkon diçka nëpërmjet natyrës së saj thelbësore dhe nëse nuk dërgon te kafshërorja një frymëzim lidhur me të, dhe ia sugjeron këtë asaj, kështu që (nga ana tjetër) kafshërorja t'i bindet asaj dhe të mos rebelohet apo ta frenojë veten nga ajo. Kështu, ajo (ëngjëllorja) nuk resht së urdhëruari dhe kafshërorja (nuk resht) së binduri, dhe gjërat vijnë në këtë mënyrë derisa forca kafshërore bëhet e mësuar dhe stërvitet me këtë. Ato gjëra që ëngjëllorja i dekreton nëpërmjet natyrës së saj thelbësore, dhe që kafshërorja është e shtrënguar t'i bëjë pavarësisht nga ngurrimi i saj, janë të atij lloji që të parën e bëjnë të lumtur dhe të dytën të brengosur, siç është imitimi i Melekutit dhe përpjekja për Xheberutin, sepse ato janë një veçanësi e ëngjëlltores, dhe kafshërorja është në distancën më të largët prej tyre. Ose (kjo vazhdon derisa) braktiset çfarëdolloj gjëje që kafshërorja dekreton, që gjen kënaqësi në të, dhe që ka neps për të në teprimet e saj.

Kjo kategori e dytë quhet aktet e adhurimit dhe ushtrimeve fetare, dhe këto marrin pjesë në për-

ftimin e virtyteve të dëshiruara të cilat mungojnë. Hulumtimi i kësaj pike kthehet në faktin se lumturia e vërtetë nuk ngërthehet përveçse nëpërmjet akteve të adhurimit. Si rrjedhojë, qëllimi universal e dobiprurës u bën thirrje individëve njerëzorë nga kamarja e formës specifike dhe i urdhëron ata këmbëngulurazi që të kryejnë përmirësimin e cilësive që janë një përsosmëri e dytë për të, në masën në të cilin ato janë të nevojshme. Ai po ashtu i urdhëron njerëzit që qëllim fundor të vëmendjes së tyre të përqendruar dhe shënjestër të vështirimeve të tyre të bëjnë rafinimin e nefsit, dhe stolisjen e saj me qëndrime që e bëjnë atë t'i përngajë asaj çka është sipër saj në gjirin e Kuvendit më të Naltë, dhe ta përgatisë atë për shpalljen e realiteteve të Xheberutit dhe Melekutit. (E urdhëron atë) që kafshëroren ta bëjë të nënshtruar ndaj ëngjëlltores, si dhe të bindur ndaj saj, dhe ta bëjnë atë një vitrinë për manifestimin e urdhërave të saj.

Kur individët njerëzorë janë të shëndetshëm në përputhje me llojin e tyre, dhe lënda e tyre është në gjendje që të manifestojë cilësitë e llojit, krejtësisht dhe plotësisht, ata e gjakojnë me zjarr këtë lumturi (fundore) dhe tërhiqen prej saj siç tërhiqet hekuri nga magneti. Ky është karakteri i lindur (khalk) sipas të cilit Zoti, qoftë Ai i Lartësuar, krijoi njeriun, dhe natyra fillestare, në përputhje me të cilën Ai, qoftë i Lartësuar, i strukturoi njerëzit. Rrjedhimisht, nuk ka pasur asnjë komb në gjirin e njerëzimit që të ketë zotëruar temperamente të ekuilibruara dhe që në gjirin e tij të mos ketë një grup të njerëzve të mëdhenj të cilët u japin rëndësi përsosmërisë së këtij karakteri të lindur dhe e cilësojnë atë si lumturia e mbrame. Mbretërit dhe burrat e mencur, dhe ata poshtë tyre, i shohin ata sikur kanë arritur atë çka është e lartësuar përmbi të gjitha lumturitë e kësaj bote, dhe se atyre u janë bashkuar ëngjëjt dhe iu janë bashkuar rrethetë të tyre kështu që ata (këta njerëz, pra) kërkojnë bekimin e tyre dhe u puthin atyre duar e këmbë. Pra, si mund të ndodhë vallë që arabët dhe jo-arabët, megjithë dallimet e tyre në zakone dhe fe dhe në distanca ndërmjet qyteteve e trojeve të tyre, të pajtohen në një gjë me një unitet të llojit – përpos për shkak të afinitetit të natyrës fillestare? E si mund të mos ishte kështu, kur ti ke pranuar se forca ëngjëlllore është e pranishme në natyrën themeltare fillestare njerëzore, dhe kur ti ke pranuar njerëzit sipërorë dhe ata më të mëdhenjtë ndër ta, dhe Zoti e di më së miri.¹

1. <https://erasmusi.org/2021/04/14/lumturia-njerezore>.

PËRBALLË ZGJIDHJES SË INFEKTUAR

— M. Ali Eshmeli —

Jeta ka plot shqetësime.

Ka prej tyre që edhe të kërcënojnë.

Ja pra;

Atëherë kur këto shqetësime valëzohen;

Pikërisht atëherë ia heq të vërtetën matematike të logjikës së njeriut. Në vendin e saj, prodhon një logjikë të çuditshme me qendër shqetësimin, sikur të jenë bërë llogari më të hollësishme.

Nga brenda është sharmante dhe plot ngjyra.

Kurse nga jashtë; mjaft logjike, e justifikuar, e arsyeshme, zgjidhëse, psikologjike, madje edhe mjaft shkencore.

Mirëpo;

I gjithë marifeti mbetet tek të arrish të jesh njeri me kredibilitet duke shfaqur qasje me plot sinjale rrezikshmërie, porsi një dinamit. Madje fshehurazi.

Duke qenë në një situatë që shpreh kënaqësinë edhe ndaj zgjidhjeve false, duke mënjanuar shpeshherë shërimin e vërtetë, edhe kur ka qëllim të mirë.

Ka plot shembuj.

Rënkimet e njerëzve që gjenden ballë për ballë me ato shqetësime që kërcënojnë, janë mjaft ashigare:

- Fëmija nuk më dëgjon më, është mbyllur shumë në vetvete, kemi mbetur të hutuar përballë tij, s'dimë ç'të bëjmë.

- Kushedi përse!? Medoemos ka një arsye.

- Si mund ta gjejmë atë arsye?

- Pa t'ju dëgjoj njëherë.

- Dakord, nuk do të mbetesh pa e gjetur arsyen.

- Ashtu është.

Pas një jave:

- E dëgjova fëmijën. Mashallah, është fëmijë mjaft i zgjuar. Mirëpo, ka gjëra që nuk ju ka thënë juve. Le t'ju them vetëm kaq: një metodë e gabuar sado e vogël qoftë, ka mundësi që ta çojë fëmijën deri në vetëvrasje.

- Çfarë thua?

- Ka edhe më shumë se kaq.

- Kaq shumë serioze qenka kjo gjë?

- Mos u merakosni! Qetësohuni! Nëse do të bëhet kujdes në një mënyrë paralele me psikologjinë



e tij, me kalimin e kohës do t'i zgjidhen të gjithë problemet. Mundet që t'i zgjasë pak gjatë. Ndaj dhe nevojitet vëmendje e vazhdueshme, mirëpo pa i ndërhyrë fare atij.

- Po mirë, çfarë duhet të bëjmë?

- Pikësëpari, mos tërhiqni vëmendje tek ai me përkushtimin tuaj.

- Pastaj?

Pastaj, principe të njëpasnjëshme të zbukuruar. Shprehje që veshit i vijnë këndshëm. Formula që bëjnë të thuhet: "Allah - Allah!"

Si dhe;

Një përmbi një këshilla të importuara nga Perëndimi.

Dhe të tjera sikur këto.

Pastaj:

- Ore, sikur fëmija po na përkeqësohet edhe më shumë!

- Se mos jeni treguar shumë diktatorë ndaj tij duke e kontrolluar herë pas here?

- Jo, kemi ndjekur me rigorozitet ato çfarë na keni këshilluar, nuk i jemi përzier fare në ato çfarë ka bërë ai.

- Duket sikur kjo gjendje tek fëmija ka ndikuar negativisht.

- Por ne po sillemi mjaft pozitivisht me të. Mirëpo, çfarëdo që t'i themi, na kundërvihet. Ka filluar edhe disa vese.

- Ato nuk përbëjnë shumë rëndësi, por janë vetëm pasqyrimet e moshës. Mjafton që ju të mos ndërhyri fare tek ai.

- Ashtu po bëjmë, por ai gjithnjë ndërhyr tek ne.

- Kjo gjë është mjaft pozitive. Kjo do të thotë se ai po i shpreh hapur ndjenjat e tij. Përndryshe, sikur ta kryejë këtë nevojë jashtë, atëherë djalli do t'i pëshpërit në vesh dhe do t'ua shkëpusë një herë e përgjithmonë prej jush.

- Çfarë të bëjmë tani?

- Hapni atij një vend më të rehatshëm në jetën tuaj. Lëreni të lirë sikur ju të mos ekzistoni fare. Le të mos qëndrojë ngusht, i shkreti, në mesin e një jete monotone dhe me mendime klishe. Mundësojani që të marrë frymë plot jetë.

- Pastaj?

Pastaj iu rreshtuan edhe këshilla të ngjashme.

Pastaj:

- Ky i yni shkoi deri aty sa nuk njeh më asgjë prej gjëje.

- Ore, mos doni të rrisni skllevër ju, a nuk ju thashë që t'i jepnit pak mundësi?

- Dakord, por ne nuk i njohëm më shumë sesa mundësitë atij.

- Me sa duket, nuk keni arritur të hyni në zemrën e tij. Nuk keni arritur të krijoni afritet me të, i keni qëndruar larg. Duhet të kishit gjetur një rrugë për në zemrën e tij.

- Ore, ne jemi më të afërmit e tij!

- Si do qoftë, nuk paskeni arritur të bëheni miq me njëri – tjetrin.

- Si do të ndodh kjo?

- Këtë duhet ta gjeni ju. Është fëmija juaj që prej kaq vitesh.

- Ashtu është, por gjithnjë e më shumë po na bëhet më i huaj me ne.

- Ndoshta nuk i keni zbatuar ashtu siç duhet ato çfarë ju kam thënë.

- Ndoshta.

- Por, kjo nuk do të thotë se tashmë s'ka zgjidhje.

- Po, duhet të ketë ndonjë gjë që duhet të bëjmë tani.

- Natyrisht.

- Çfarë është?

- Veçanërisht diskutime të llojit "e saktë – e gabuar", të mos ketë, por lëreni t'i realizojë ato çfarë ai dëshiron. Në fund, do t'ju përqafojë juve, duke ju kërkuar që ju të ndërmjetësoni. Përndryshe, do ju japë lamtumirën një herë e përgjithmonë!

- Çfarë po thoni?

- Jini më të kujdesshëm tashmë. Shqetësojeni atë më pak sesa e shqetëson një hije.

- Pastaj?

Pastaj, sërish shpjegime të llojllojshme që vazhdojnë gjatë...

Në fund fare:

- Mos! Mos!

- Çfarë ndodhi?

- Iku tashmë zemra jonë.

- Ku iku?

- Ah sikur të kishte iku diku! Sa keq që u bë viktimë e një ngatërrese ordinere në një rrugë...

- ?!

Zërat e vajtimet sikur po shponin qiellin...

Mu pranë viktimës, kukuvajkat kishin nisur vajtimet...

Bilbili i edukimit fërfëlloi flatrat në atë zhurmë dhe u vendos mbi minaren që ngjan me një elif. Vetëm që ta dëgjonte çdokush ia nisi këngës së tij:

"O njerëzit e qytetërimit më të madh dhe më të vërtetë!

A nuk ju erdhi vallë koha që të përmendeni?

Sa e sa viktima po japin rrugët e qytetërimeve të Lindjes dhe Perëndimit, a nuk po i vëreni?

Pa shikoni historinë;

Vallë, a mos ka ndonjë tjetër qytetërim, përveç atij islam, që të edukojë njeriun, t'i gjejë zgjidhje problemit të tij, madje që të shërojë edhe vetë të sëmurët?

Ju, prej shekujsh;

A nuk keni bërë gjeni fëmijët më të paditur të mundshëm dhe dijetarët më të shtypur të mundshëm nëpërmjet edukimit që bën tasavvufi?

Kuptojeni tashmë, që;

Sa e sa importime si psikologjia, pedagogjia, psikiatria etj. ju ka bërë qytetërimi perëndimor, i cili ka zënë vendin e sistemit më realist dhe më të përshtatshëm me natyrën njerëzore! Me sa e sa viruse ju ka infektuar!.. Mikrobet që ju janë injektuar juve nëpërmjet atyre emrave, për kë janë zgjidhje? Janë për ju apo për armikun? Jini të vëmendshëm tashmë ndaj atyre mikrobeve që duken si zgjidhje. Pasi ato janë vetëm;

Vetëm në fjalë, porsi një thesar zgjidhjesh çudi-bërëse.

Shumë të gjerë dhe të thellë.

Shumë të buzëqeshur.

Shumë humanë.

Shumë realistë.

Thuajse, një religjion pa të meta.

Mirëpo, e vërteta është;

Konflikti ordiner i qytetërimeve...

Në atë konflikt ekzistojnë mjaft taktika politike që janë ndërtuar me qendër humbjen e Lindjes dhe fitoren e Perëndimit.

Taktika që ngjyrosin të dukshmen dhe vrasin thelbin.

Mjafton të shikoni mjeshtrit enigmatikë të kësaj çështjeje;

Zbrazëtitë epshore që gjenden domosdo tek çdo njeri, bëjnë ndërhyrje në tru në mënyrë të çuditshme, duke e justifikuar këtë gjë. E shkatërrojnë njeriun nëpërmjet një metode të padukshme dhe të pakuptueshme. Pra, nëse sëmundja është tek veshi, ndërhyrjen e bëjnë mu në mes të syrit. Normalisht, nuk largohet shqetësimi i veshit duke ndërhyrë në sy. Kështu krijohet mundësia e një tjetër ndërhyrjeje. Pastaj edhe një tjetër. Ndërkohë, syrin verbohët tërësisht. Kurse rënkimi i veshit vazhdon.

O njerëzit qëllimmirë të qytetërimit tim!

Mendoni!

Nëse diçka është shërim dhe nëse nevoja për të është në kulmin e saj, a nuk duhet të vrapojnë të sëmurët drejt saj? Natyrisht!

Veçanërisht nëse është një shërim i shumëkërkuar.

Normalisht atëherë vetëm për të duhet të flitet. Shqetësimi që të jep nevoja për të bën që të mos analizosh të vërtetën e shërimit. A mundet që njeriu

të ketë hulumtime, dyshime apo kritika mbi shërimin ndërkohë që gjendet i kërcënuar nga shqetësimet? Si mundet?!

Pasi;

Të sëmurët janë njerëz të gatshëm të besojnë gjithçka çfarë ofrohet si shërim. Kësisoj, nëse specialistët abuzojnë me këtë pushtet që kanë, nuk u përmbysen vetëm bonsensi i të sëmurit, por edhe qendra e mirëkuptimit.

Ky rrezik;

Është aktiv në mënyrë të tepruar. Pasi emrin e ka zgjidhje. Madje zgjidhja e vetme. Mirëpo e veçanta është se është edhe më infektuese sesa virusi i kancerit. Përpjekja për zgjidhje bën që të fshehë anën infektuese. Ngaqë mikrobet janë gjallesa që nuk mund të shihen me sy të lirë, edhe sikur mos të mbulohen, nuk përbën ndonjë rëndësi. Por, kur edhe mbulohen nga sipër, atëherë të njohësh ata bëhet akoma më e vështirë sesa vetë sëmundja.

E tmerrshme!

Ndaj dhe mjeshtrit e fshehur të kësaj ngatërrese, janë porsi njerëzit që merren me xhinë dhe fall-xhorët.

Shqetësimet false, por të tmerrshme, që kanë përgatitur duke i mësuar përmendësh; në mënyrë automatike porsi një dinamit u hidhet në ndërgjegjen e tyre, në trurin e tyre dhe në shpirtin e tyre. Pastaj, sipas nevojës i plasin të gjitha me radhë.

Ajo çfarë mbetet është e lehtë pastaj.

Zgjuhuni, o njerëzit e qytetërimit tim!

Dallojini mashtrimet që janë të zbrazëta nga brenda, që ju japin një qetësi kalimtare dhe pajisuni me të vërtetën, sado e athët qoftë ajo!

Në një shoqëri që është i përhapur adhurimi që i bëhet ndonjë idhulli, cila sjellje u duket normale njerëzve e cila jonormale?

Struktura që kana ndërtuar disa sot, funksionon me një logjikë që njeriu të jetë në kaos. Arkitektët e konflikteve të rrugëve të qytetërimeve, nëpërmjet metodës së psikologjisë, mundet që ta bindin njeriun që është i sëmurë në një mënyrë shumë të lehtë, duke e shqetësuar atë. Kësisoj, po luhet me trurin e brezave. Edhe njerëzit që nuk kanë asnjëfarë lidhje me çështjen në fjalë, ngaqë i besojnë lehtësisht kësaj, në shesh del një qasje e tmerrshme dhe një zbrazëti e rrezikshme. Në atë zbrazëti po përdoret psikologjia, po përdoret pedagogjia, po përdoret psikiatria, si përfundim po përdoret njeriu.

Nga disa njerëz;

Gjithmonë ka mënyra të llojllojshme që mund të shkatërrojnë njeriun. Por metodat me qendër zgjidhjet janë më të këqijat nga mesi i tyre.

Ndaj dhe;

Mbi psikologjinë e rinisë, që është bërë pre e materializmit po luhen lojëra të fshehta dhe të pakuptue-

shme. Disa variante zgjidhëse, tashmë janë kthyer për të rinjtë në një mundësi që justifikon gabimet e tyre. Kjo është një gjendje vërtet shqetësuese, ndaj dhe është koha për klientë të natyrshëm që krijohen vetvetiu nga kuzhinierët që përgatisin këtë ushqim të çuditshëm. Pasi, kur nuk ka klientë, humbet prodhimin. Për arsye se pa klientë edhe kuzhinieri humbet, ndaj dhe është krijuar kjo mensë ku ofrohet çfarëdolloj paçavure që përgatisin kuzhinierët.

Kjo gjë është mjaft e lehtë.

Mjafton pak rol.

Trendi i të qenit në stres është në dorën e secilit dhe e varur nga dëshira e secilit. Bëje që të funksionojë për një copë kohë mekanizmi negativ i egos dhe ja ku na del përpara nesh edhe sëmundja psikologjike. Çfarëdolloj gabimi të bësh, bëje, tashmë është normale.

Ja dhe tmerri i zgjidhjes së infektuar!

Ndoshta;

Mundet që të shprehemi edhe pak më butë.

Mirëpo;

Duke anashkaluar strukturën kryesore të njeriut dhe duke mospërfillur asgjë nga të vërtetat e krijimit, madje duke u qasur porsia një qengj që pi në dy nëna, dalja nga një gjendje të infektuar, bën që të heqë justifikimet sikur të ishin zgjidhje.

Që në fakt;

Njeriu ka një anë epshore dhe një anë shpirtërore.

Egoja është ambari i së keqes, kurse zemra është kopshti i të bukurave.

Thomëni;

A nuk është e infektuar ajo strukturë që, ndërkohë që egoja duhej të edukohet me metoda të përshtatshme dhe të drejta, ajo e konsideron egon si kurorë për jetën, e cila është baza e së keqes?

Si mund të ndërtohet identiteti mbi të këqijat?

A mund të ndërtohet karakteri duke dashur gjërat e gabuara dhe gjërat shkatërrimtare të njeriut?

Natyrisht;

Është e vërtetë që përballë çdo të gabuare ekziston çdolloj faljeje, mirëpo si mund të shpjegohen qasjet e infektuara që shumojnë dhe ushqejnë të gabuarën?

Atëherë;

Nën emrin e disa qasjeve që kanë filluar të konsiderojnë veten si zgjidhja edhe më e duhur sesa feja, ç'kuptim ka vallë të normalizohen dhe të legjitimohen gjynahet, haramet, çrregullimet, imoralitetet dhe fajet, që shkatërrojnë njeriun?

Zgjidhje e infektuar!

Për kë vlen?

Vlen për ata që përpiqen të asgjësojnë këtë popull duke ardhur deri në Çanakkale.

Në fakt;

Nuk është gjë tjetër veçse një zgjidhje e infektuar.

Është një pengesë përpara së mirës.

Është vetëm një zgjidhje dinake që bën që të mos dallohen mundësitë e së keqes.

Zgjidhje në emër të djallëzisë. Kurse në emër të Zotit është vetëm një mashtrim.

Vini re;

Zgjidhja e infektuar i bën njerëzit gënjeshtarë.

Zgjidhja e infektuar është një shesh i vërtetë për të bërë përshesh për ata që mendojnë të ligën.

Zgjidhja e infektuar është një produkt sistematik që bëhet në shërbim të korrupsionit të lloj-lloj negativiteteve.

Zgjidhja e infektuar është një helm me bakllava që e përdor armiku në një pritë, me qëllim që të shkatërrojë mikun.

Zgjidhja e infektuar është një metodë shërimi që është prodhuar nga bota e jashtme me qëllim që të bëjë të sëmurë njerëzit e shëndetshëm.

Zgjidhja e infektuar ka gjetur veten më shumë në psikologji. Ka gjetur një fushë që është në modë. Ka gjetur një vend në shesh. Ka gjetur një hapësirë në klimën e interesit dhe ambicies. Ka gjetur hapësirë brenda problemeve false.

O njeriu i qytetërimit tim!

Kthehu tashmë në arkitektin e edukimit tënd! Ajo arkitekturë ka rritur Fatihë, Sinanë... Kthehu zgjidhjeve të tua. Ato zgjidhje kanë shëruar edhe të sëmurët.

Kuptojë që;

Duhe flakur tutje shqetësimet e infektuara që po të sulmojnë!

Pengoji shqetësimet plot viruse që po të kërcënojnë mushkëritë!

Tashmë;

Për shkak të problemeve të egos, mos lejo që të ndërhyjnë në mendjen tënde!

Kurrë;

S'ke nevojë për zgjidhje të infektuara!

Kur bëhet fjalë për edukimin;

Bëje të mundur që të ngrihen në këmbë shpirtat në sajë të edukimit të egos profane, përmes metodave që kanë ofruar njerëz të thjeshtë si Kadi Mahmudi dhe njerëz të rrallë si Aziz Mahmud Hydaji!

Atëherë triumfi je ti.

Atëherë, në rrugë je ti, në shtëpi ti, në atdhe ti, në Çanakkale ti, në Vjenë ti, në Egjipt ti, në Palestinë ti, në botë ti!

Atëherë;

Bismil-lah..."

EKUILIBRI

— Dr. Halis Demirxhan —

Njerëzit, siç ndodh edhe sot, në çdo periudhë të historisë e kanë dashur natyrën, e kanë punuar tokën për të përfituar prej saj, kanë kultivuar pemë dhe kanë ushqyer kafshë. Por ja që këto sjellje të njerëzve nuk do të thonë se ata e pranojnë këtë rregull: “Çdo krijesë është një vlerë në vete në natyrë.” Ekologjia, domethënë, shkenca e ambientit nuk do të thotë “ambientalizëm”. Ekologjia mund të shpjegohet edhe si mbrojtje e llojeve të specieve, trajtimi i kafshëve me mirësi dhe kundërshtimi i çdo lloj aktiviteti që mund të shkaktojë ndotjen e ambientit.

Njeriu nuk është ai që e ka filluar jetën në sipërfaqen e tokës apo që e ka vendosur ekuilibrin ndërmjet krijesave, qofshin ato bimë apo kafshë. Madje, edhe vetë njeriu është vënë në ekzistencë brenda këtij ekuilibri. Atëherë, njeriu nuk ka të drejtë të zhdukë ndonjë specie apo ta prishë peshoren/ekuilibrin në asnjë lloj mënyre.

I Dërguari i Allahut, Hazreti Muhamedi (s.a.s.), i cili i ka dhënë mësim njerëzimit edhe në fushën e të drejtave të gjallesave, ka dhënë këtë shembull:

Dikur një Pejgamber kishte shkatërruar një fole milingonash për shkak se e kishte pickuar një milingonë. Nisur nga kjo, Allahu e dënoi këtë veprim të tij. Në këtë dënim të këtij veprimi atij Pejgamberi iu tha: “Si mund ta zhdukësh një umet nga umetet e gjallesave që vazhdimisht më bëjnë dhikër Mua, vetëm e vetëm se të pickoi një milingonë?!” (Përkthimi dhe Shpjegimi i Sahihu’l-Muslim, 5, Ahmed Davudogllu Kreu i 36-të, 148.)

Ai Pejgamber duhet të ketë vendosur për të hedhur ndonjë ilaç aty duke menduar për njerëzit që mund të uleshin në atë vend pas tij. Por ja që Allahu i Lartësuar nuk e pranoi mendimin e njeriut për shfarosje. Në këtë mënyrë, urdhëroi për mëshirë duke ia bërë të ditur atij Pejgamberi se edhe ato gjallesa e madhëronin dhe e adhuronin Allahun Teala.

Edhe përgjigja, e cila mori Sulltan Sulejman Kanuni nga Ebu’s-Suud Efendi kur e pyeti për lejen e vrasjes së milingonave që dëmtojnë frutat e pemëve



në bahçe, është shumë e njohur. Siç shprehet edhe Sejri në poezinë e tij:

“Poseduesi i pozitës e pyeti Ebu’s-Suudin:

Hoxhë, a është mëkat ta vrasësh milingtonën në frut?

Dijetari i madh i tha: Nëse e vret, o sulltan,

Nesër do të vijë milingona dhe do ta marrë hakun nga Sulejmani...

Kjo cilësi ishte që e bëri padishahun sundues të botës,

Fati i Sulejmanit me këtë cilësi ishte madhështia.”

Çdo gjë është vënë nën urdhrin e njeriut, por edhe njeriu është i obliguar t’i respektojë rregullat për t’i qëndruar sa më larg shpërdorimit, padrejtësisë dhe egoizmit.

Nëse e shohim historinë e kulturës islame nga ky këndvështrim, do të vihet re se mendimi: “Kjo natyrë është krijuar mbi një rregull, mbi një masë e mbi një sistem dhe se çdo gjë dëmtohet kur prishet ky ekuilibër.”, është vënë në pah me fenë islame në një mënyrë të vetëdijshme.

Në Kuranin Fisnik, krahas thesareve të pashtershme të gjithësisë, thuhet kështu duke bërë fjalë për ekuilibrin e bimëve dhe kufizimin e mundësive mbi sipërfaqen e tokës:

“Dhe Tokën e kemi shtrirë e nëpër të kemi shpërndarë male të patundura. Ne kemi bërë

që në tokë të rritet çdo gjë në përpjesëtim. E aty kemi bërë mjetet e jetesës për ju dhe për ata që nuk i mbani ju. Nuk ka asnjë send që të mos gjenden tek Ne thesaret e tij; por prej tij Ne japim me masë të caktuar. Ne i dërgojmë erërat për pllenim dhe zbresim nga qielli ujë, prej të cilit ju japim të pini e të cilin nuk mund ta depozitoni dot.” (Hixhr, 19-22)

Përfundimisht në gjithësi nuk ka prishje dhe anarki. Universi ka një ekuilibër, një rregull dhe një qëllim. Për këtë arsye, askush nuk ka të drejtë ta prishë këtë ekuilibër dhe rregull. Ndotja e ambientit apo mospastrimi i tij nga papastërtia është një mëkat i madh nga aspekti i sistemit hyjnor në gjithësi, por ja që njerëzimi, për shkak të pangopësisë, lakmisë për të fituar epërsi superiore kundrejt të tjerëve dhe agresivitetit që e nxjerrin në pah këto, e ka futur natyrën në një gjendje saqë kërcënon edhe ekzistencën e tij. Përsëri në Kuranin Fisnik thuhet kështu kur bëhet fjalë për prishjen e tokës dhe të deteve për shkak të atyre që njerëzimi bën dhe vazhdon të bëjë:

“Shkatërrimi në tokë dhe në det është shfaqur si pasojë e punëve të këqija të njerëzve, kështu që (Allahu) do t’i bëjë “të shijojnë” pjesë nga ajo që kanë punuar, me qëllim që ata të kthehen (në përmirësim).” (Rum, 41) Për këtë arsye, përgjegjësi i vetëm për rënien në këtë gjendje të ambientit është tipi i njeriut kapitalist, imperialist dhe kolonizues.

Këta njerëz që kanë mentalitet materialist, në të cilin interesat egoiste mbahen në plan të parë, po e shkatërrojnë ambientin dhe po i përdorin burimet e resurset pa vend e pa kriter duke i shpërdoruar në mënyrë të pavetëdijshme. A mund të ngopen me mundësitë e kufizuara të kësaj bote zemrat dhe sytë e atyre që nuk ngopen me besim e iman? Ngaqë natyra është një amanet që njerëzimit i është dhënë nga Allahu, xhel-le xhelaluhu, po ashtu, ngaqë njeriu është po ai që po e ndot dhe po e shkatërron këtë amanet, do të thotë se problemi i vërtetë rezulton në ndotjen e vetë njeriut.

Në një botën që kanë ndërtuar njerëzit e privuar nga dashuria, ndërgjegjja e mëshira, njerëzit e pangopur dhe egoistë, sigurisht se nuk mund të flitet për sistem dhe harmoni. Prandaj, Allahu i Madhëruar na bëftë prej njerëzve që mjaftohen me atë që u ka dhënë, prej njerëzve besimtarë, prej njerëzve që nuk u janë ndotur sytë e zemra dhe prej njerëzve të devotshëm! Amin!..

AJO QË FITOJMË DHE HUMBASIM

— Ajla Agabegym —

Koha po kalon me shpejtësi dhe jeta e shoqërive po ndryshon. Fshatarët po shkëputen nga toka dhe po shpërngulen nëpër qytete. Bujqësia me kalimin e ditëve po e humbet vlerën që ka pasur në të kaluarën. Një stil jete duke punuar nëpër banka, duke u marrë me kamatë, duke bërë imponime të pandërgjegjshme në ekonomi, duke marrë fitime të padrejta dhe duke jetuar në luks e shpenzime kolosale... Afrimi i njerëzve me anë të rrjeteve sociale dhe ankesat për zhdukjen e kulturës dominuese... Askush nuk do t'ia dijë lëkundjes që pëson njeriu i sotëm që po shkëputet nga kultura e tij, ndërkohë që nënat, baballarët dhe mësuesit janë të habitur dhe po bëhen debate në fushën e politikës. Ajo që ne e quajmë kultura jonë, po largohet prej nesh.

Për shkak të kësaj, dalin njerëz që arratisen nga fshatrat, strehohen nëpër qytete dhe jepen pas një jete që e shohin nëpër televizorë dhe reklama duke dalë jashtë edhe jetës së qytetit...

Ndërkohë që po përpiqen për të hyrë në kapitalin e madh edhe njerëzit që thonë: “Unë e

praktikoj besimin tim.” – disa biznesmenë shkëputen nga vetja e tyre pa e kuptuar aspak këtë problem dhe lavdërohen me vendet ku jetojnë, me makinat e shtrenjta që shëtisin dhe me rrobat firmato që i blejnë. Pastaj dalëngadalë fillojnë të përzihen me njëri-tjetrin harami dhe hallalli, fillojnë të ndryshojnë tonet e zërave dhe shikimet përgjatë bisedave dhe nëpër iftare fillojnë të zhvillohen biseda që nuk përputhen aspak me frymën e muajit të Ramazanit... Pastaj, a e kemi të mundur t'ua shpjegojmë të rinjve dhe fëmijëve tanë, të cilët rriten në një mjedis të tillë, fenë islame dhe dashurinë ndaj të Dërguarit të Allahut (s.a.s.), pa pasur asnjë vështirësi? Pra, a mund ta bëjmë këtë ndërkohë që nuk i përjetojmë vetë?

Tashmë, edhe në lagjet më fetare gratë mund të bëjnë iftar nëpër tavolina që shtrohen para lokaleve. Pra, iftaret po bëhen nëpër rrugë...

Brendësia e qindra koncepteve si edu-



kata, turpi, mëkati, mëshira, fitimi hallall etj., që gjenden në kulturën tonë, po zbrazet dhe mbrojtësit e kulturës po heshtin kundrejt kësaj jete... Nën timer, baballarët apo mësuesit po bërtasin vetëm kur fatkeqësia t'ua shkojë te dera... Në këtë mënyrë, s'po e kuptojmë dot se një ditë zjarri do të vijë edhe në shtëpinë tonë.

Kur fëmija i një familjeje shumë të nderuar dhe fetare nuk gjen dot biletë për koncertin e një grupi të jashtëm (roku islamik) që vjen nga jashtë shtetit, mërzhitet për ditë të tëra (nga që biletat janë shumë shtrenjta).

Një vajzë gjimnaziste arrin t'i thotë babait të saj: "Mua patjetër më duhet të shkoj në ndonjërin prej atyre koncerteve." Babai blen edhe një biletë për vetë, në mënyrë që të mos e dërgojë vajzën vetëm. Babai ka mbaruar fakultetin e teologjisë dhe është drejtori i sektorit të kulturës në një bashki. Të dy bashkë shkojnë në koncert. Të rinjtë në këmbë emocionohen dhe dalin nga vetja. Ata thonë të njëjtat gjëra që thotë këngëtarin dhe bëjnë të njëjtat lëvizje si ai. Vajza kthehet nga babai i saj dhe i thotë: "Baba, bëji edhe ti lëvizjet që i bëj unë. Përndryshe je i detyruar të dalësh nga këtu!"

Muzika, poezia, tregimi, romani, filmi dhe teatri ushqehen nga burimet e kulturës së tyre.

Fëmijët e të mëdhenjve që ushqehen nga këto burime, por që nuk i gjallërojnë ato në shpirtin e tyre, do të ngelin nën influencën e kulturës që u është imponuar dhe do të bëhen si nënat, etërit, mësuesit, politikanët dhe intelektualët e tyre. Ndërkohë që po i them këto, po përpiqem të flas në lidhje me ata që largohen nga kultura jonë. Për fat të keq, numri i tyre çdo ditë është në shtim e sipër.

Ne kemi thënë: "Myslimani duhet të jetë i pasur!" Numri i atyre që po pasurohen po shtohet çdo ditë. Ndërkohë, mangësia jonë është kjo se asnjëherë nuk thamë: "Myslimani duhet t'i fitojë paratë dhe t'i harxhojë sipas rregullave të Islamit!"

Tashmë kemi gazetatat, televizionet, bankat, kompanitë dhe politikanët... Por a kemi projekte për fëmijët dhe të rinjtë tanë? Gjithashtu kemi edhe shtëpitë e rinisë dhe shtëpitë e informacionit që i kanë hapur bashkitë. Edhe numri i këtyre çdo ditë është në rritje. Këto ndërtesa janë shumë të bukura, por sa është numri i atyre që shkojnë atje? A kemi projekte për ta shtuar këtë numër? A përfitojnë bashkitë nga projektet e mësuesve idealistë?





“KUSH E FAL SABAHUN ME XHEMAT PASTAJ
ULET DHE E PËRKUJTON ALLAHUN DERISA DIELLI
TË LINDË, E PASTAJ FAL DY REKATE, AI FITON
SHPËRBLIMIN SIKUR TË KETË KRYER HAXH DHE
UMRE TË PLOTË, TË PLOTË, TË PLOTË.”

10 PËRGËZIME

PËR ATË QË E FAL NAMAZIN E SABAHUT ME XHEMAT

— Naim Drijaj —

PËRGËZIMI I PARË

Drita e plotë në Ditën e Gjykimit. Prej atij momenti që namazliu del nga shtëpia e tij, e rrethojnë përgëzimet nga të gjitha anët. Pejgamberi (a.s.), ka thënë: “Përgëzoji ata të cilët ecin nëpër errësirë për në xhami me një dritë (nur) të plotë në Ditën e Kiametit.”¹

PËRGËZIMI I DYTË

Ky namaz ka vlerë më të madhe sesa e gjithë bota dhe çfarë ka në të. Pejgamberi (a.s.), ka thënë: “Dy rekatet e sabahut (sunset) janë më të vlefshme se e gjithë bota dhe çka ka në të”.²

PËRGËZIMI I TRETË

Përfitimi i të mirave. Kur njeriu ulet dhe pret namazin, ai është në namaz. Pejgamberi (a.s.), ka thënë: “Kush del nga shtëpia e tij për në xhami, për çdo hap që bën atij i shënohen dhjetë të mira. Ai

që ulet në xhami që ta presë namazin është sikurse ai që bën namaz dhe regjistrohet si namazli, derisa të kthehet në shtëpinë e tij”.³

Kush nuk e fal namazin e sabahut me xhemat humb shumë shpërblime e të mira të mëdha, si: të mirat e dy rekateve para namazit të sabahut, shpërblimin e hapave për në xhami, shpërblimin e leximit të Kuranit derisa të thirret ikameti për namaz, shpërblimin e pritjes së namazit në xhami deri në ikamet. E nëse llogarit të gjitha këto të mira, do të bëhen me miliona, ngase një e mirë shpërblehet me dhjetë të mira.

PËRGËZIMI I KATËRT

Dëshmia e melekëve. Allahu i Madhëruar thotë: “Kryejë namazin prej kthimit të Diellit (nga gjysma e qiellit) deri në errësirën e natës dhe këndo Kuran në agim; me të vërtetë, falja e mëngjesit është e dëshmuar (nga engjëjt).”⁴ Pejgamberi (a.s.), ka

1. Ebu Daudi, Tirmidhiu.

2. Muslimi.

3. Ahmedi.

4. Isra, 78.

thënë: “Tubohen melekët e natës dhe melekët e ditës në namazin e sabahut”.⁵

PËRGËZIMI I PESTË

Hyrja në xhenet dhe shpëtimi nga xhehenemi. Pejgamberi (a.s.), ka thënë: “Nuk do të hyjë në zjarr ai që falet para lindjes së diellit dhe para perëndimit.”⁶ d.m.th. në namazin e sabahut dhe të ikindisë. Pejgamberi (a.s.), ka thënë: “Kush e fal namazin e sabahut dhe të ikindisë (berde tejni), hyn në xhenet”⁷

PËRGËZIMI I GJASHTË

Shikimi i Allahut (xh.sh.). Shpresohet se ai që kujdeset për faljen e namazit të sabahut dhe të ikindisë do të fitojë shikimin e Allahut të Madhëruar. Transmetohet nga Xherir bin Abdullahu (r.a.), se ka thënë: “Ishim te Profeti (a.s.), një natë, shikoi hënën e plotë dhe tha: “Ju do shihni Zotin tuaj ashtu siç po e shihni këtë hënë, nuk do të keni asnjë lloj vështirësie në shikimin e Zotit. Nëse mundeni që mos t’ju habisë djalli nga namazi (ta anashkaloni atë) para lindjes së diellit dhe para perëndimit të tij, faleni atë (dhe largojuni intrigave të djajve).” D.m.th. namazin e sabahut dhe të ikindisë.⁸ Pastaj lexoi ajetin: *“Madhëroje Zotin tënd e falënderoje Atë para lindjes së diellit dhe para perëndimit.”*⁹

Hafidh ibn Haxheri, Allahu e mëshiroftë, thotë: “Kanë thënë dijetarët: ‘Arsyeja e përmendjes së këtyre dy namazeve me tregimin e shikimit të Allahut është ngase namazi konsiderohet nga adhurimet më me vlerë. Është vërtetuar se këto dy namaze janë të vlefshme se në këto dy namaze bashkohen melekët, ngrihen veprat etj.’

5. Muttefekun alejh.

6. Muslimi.

7. Muttefekun alejh.

8. Muttefekun alejh.

9. Kaf, 39.

PËRGËZIMI I SHTATË

Arritja e shpërblimit të namazit të natës. Nga Uthman bin Afani (r.a.), transmetohet se ka thënë: “E kam dëgjuar Pejgamberin (a.s.), duke thënë: ‘Kush e fal namazin e jacistë me xhemat ka shpërblim sikur të falej gjysmën e natës, ndërsa kush e fal namazin e sabahut me xhemat ka shpërblim sikur të falej tërë natën.”¹⁰

PËRGËZIMI I TETË

Duaja e melekëve. Nga Ali bin Ebi Talibi (r.a.), transmetohet se ka thënë: “E kam dëgjuar Pejgamberin (a.s.), duke thënë: “Kush e fal namazin e sabahut pastaj qëndron në xhami, për të luten melekët.” Duaja e tyre për të është: “O Allah, fale atë, O Allah mëshiroje atë!”¹¹

PËRGËZIMI I NËNTË

Arritja e shpërblimit të haxhit dhe umres. Pejgamberi (a.s.), ka thënë: “Kush e fal sabahun me xhemat pastaj ulet dhe e përkujton Allahun derisa dielli të lindë, e pastaj fal dy rekate, ai fiton shpërblimin sikur të ketë kryer haxh dhe umre të plotë, të plotë, të plotë.”¹²

PËRGËZIMI I DHJETË

Mbrojtja e Allahut (xh.sh.). Pejgamberi (a.s.) ka thënë: “Kush e fal namazin e sabahut, ai është në mbrojtjen e Allahut. Të mos marrë guximin askush ta cenojë këtë mbrojtje të Allahut (duke e sulmuar këtë njëri) me asgjë, ngase kush e merr guximin ta cenojë këtë mbrojtje, Allahu do të hakmerret ndaj tij e më pas e hedh me fytyrë në zjarr të xhehenemit.”¹³

10. Muslimi.

11. Ahmedi.

12. Tirmidhiu.

13. Muslimi.





Hudhra, Mjaltë, Qumësht

Kura e saktë kundër parazitëve në organizëm

Papastërtitë e produkteve ushqimore, higjiena e dobët personale, infeksionet, klima e ngrohtë e kohëve të fundit sjellin shfaqjen e sëmundjeve të parazitëve, kryesisht në zorrë.

Sidomos në këtë periudhë, qendrat shëndetësore të vendit raportojnë rritje të shumëfishtë të kësaj diagnoze.

Ndërsa fëmijët ngelen më të prekurit prek kop-shteve dhe shkollave, edhe të rriturit ndikohen nga këto probleme.

Infeksionet parazitare të kësaj natyre nuk janë aspak të rralla në vendin tonë. Sidomos vjeshta është një periudhat me shfaqjen më të lartë të sëmundshmërive nga parazitët.

Fëmijët e prekur nga parazitët mund të kenë probleme me rritjen dhe zhvillimin. Të rriturit të prekur nga parazitët e zorrëve, shiriti ose llojet e Askarideve dhe lambies përjetojnë probleme të konsiderueshme shëndetësore.

Lambia është një ndër parazitët kryesorë që arrijnë në trupin e njeriut. Ky parazitë shkakton sëmundje që prek kryesisht zorrët dhe rrugët e tretjes.

Paraziti grumbullohet në zorrët e holla, në rrugët e tëmthit dhe zorrën e trashë.

Si burim infeksioni shërben personi i sëmurë ose bartës, kurse përhapja bëhet nëpërmjet rrugëve të ndryshme si ushqimet e ndotura, uji i ndotur ose nëpërmjet ndotjes midis njerëzve në rastin e duarve të palara.

Cistet e lambias arrijnë të jetojnë në ujë për disa javë dhe janë të qëndrueshëm ndaj klorit që përdoret për dezinfektimit të ujit.

Pas kalimit të një organizëm të ri, cistet kalojnë stomakun, shumohen dhe grumbullohen në sistemin e zorrëve të holla, në rrugët e tëmthit dhe deri në mëlçi.

SHQETËSIMET QË SHKAKTOJNË PARAZITËT

Probleme të aparatit tretës, fryrje dhe dhimbje barku, që ngjasojnë me dhimbjet e ulçerës, të përziera, të vjella, shkarkime diarrije disa herë në ditë, sidomos në mëngjes.

Sinjal alarmi është se kjo diarrie nuk përmirësohet nga ilaçet e zakonshme.

Parazitët dobësojnë organizmin duke



sjellë probleme në përthithjen e lëndëve ushqyese e sidomos të vitaminës B12.

Kjo shkakton këputje të fuqishme dhe të përgjithshme, madje ka shumë raste që shkaktohet anemi.

Parazitët arrijnë të shkaktojnë një temperaturë të pazakontë prej 37.5 gradë C që shtrihet për një periudhë të gjatë kohore.

Parazitët shkaktojnë shqetësime të natyrave alergjike, madje edhe nervore.

Nëse jeni të shqetësuar nga shenja të tilla, gjëja e parë që duhet të bëni është analiza e feçes dhe këshillimi me mjekun.

Infeksionet mund të shërohen përmes Flagylit ose mjekimeve të tjera të këshilluara nga mjeku, të cilat merren nga të gjithë pjesëtarët e familjes.

Duhet të tregoni shumë kujdes me peshqirët, mbulesat e shtratit, çarçafët dhe veshjet me të cilat bien në kontakt të prekurit nga parazitët.

Përveç mjekimit specifik mjaft i rëndësishëm është edhe mjekimi i shenjave të prekjes si për shembull kundër të vjellave, dhimbjes së barkut, mjekimi me hekur dhe acid folik për korrigjimin e anemisë etj.

ZGJIDHJET NATYRALE KUNDËR PARAZITËVE TË ZORRËVE

Kombinimi i qumështit me hudhra është një nga zgjidhjet më të forta tradicionale sidomos kur bëhet

fjalë për mjekimin e personave të rritur.

Kombinimi nxit fuqishëm shërimin dhe lufton parazitët, falë enzimave, antioksidantëve, fosforit dhe vetive antibiotike natyralë të hudhrës. Ja çfarë ju duhet:

Gjysëm litër qumësht

10 thelpinj hudhër

Një grimë piper i zi

Mjaltë

Në një tenxhere hidhni qumështin dhe shtoni në të çerek litri ujë. Shtoni hudhrat e shtypura dhe lërinë të ziejnë.

Përzijeni kombinimin dhe lërinë të vlojë deri sa të avullojë uji. Hiqeni nga zjarri, filtrojeni dhe lëreni të ftohet. Shtoni mjaltin dhe piperin.

Çdo ditë duhet të pini nga 250 ml të këtij kombinimi esëll në mëngjes, një orë para ushqimit. Trajtimin vazhdojeni për një muaj derisa të shikoni përmirësim të plotë.

Ju mund të zgjidhni ta përdorni këtë zgjidhje edhe si parandalues duke ulur dozën në 100 ml në ditë.

ZGJIDHJE TË TJERA NATYRALE

Përdorni sa më shumë limon, hudhra, vaj ulliri dhe uthull molle të cilat kanë veti shumë të fuqishme kundër parazitëve.

* Burimi: U.S. National Library of Medicine

Përfitimet e pirjes së vezës

Veza përçon shumë energji për organizmin.

Ajo tretet lehtë, falë enzimave natyrale që gjenden në të bardhën e saj.

Pirja e vezëve forcon sistemin imunitar dhe kjo është shumë e rëndësishme për të qenë të mbrojtur nga shumë sëmundje.

Shumica e njerëzve në ditët e sotme kanë pamjaftueshmëri proteinash dhe yndyrnash cilësore.

Vezët e pagatuara janë të tejmbushura si me proteina ashtu edhe me yndyrna të mira.

Pirja e dy ose tre vezëve organike në ditë do të pakësonte ndjeshëm gjasat e shfaqjes së sëmundjeve të rrezikshme.

Vezët organike përmbajnë edhe niacin, ribof-

lavin, biotinë, vitamina A dhe E, magnez, kalium, fosfor, mangan, hekur, jod, bakër, zink dhe sulfur.

Të verdhat e vezës janë ndër të paktat ushqime që përmbajnë sasi të mëdha të vitaminës D që për disa ekspertë është më e rëndësishme edhe se vitamina C.

SA DUHEN KONSUMUAR?

Sistemi imunitar do të reagojë menjëherë ndaj vezëve.

Do të ndiheni më energjikë dhe në formë.

Mund ta provoni me një vezë çdo ditë për një javë dhe më pas të rrisni dozën me dy.

Vezët mund t'i përzieni me qumësht.





SHKENCËTARËT BESOJNË SE KËTO FOTOGRAFI PARAQESIN KËRPUDHAT NË MARS

A mund të ketë kërpudha në planetin Mars? Në një letër të re, një ekip ndërkombëtar i shkencëtarëve nga vendet përfshirë SHBA-në, Francën dhe Kinën kanë mbledhur dhe kanë krahasuar provat fotografike që ata pretendojnë se tregojnë objekte të ngjashme me kërpudhat që po rriten në Planetin e Kuq.

Në punimin e tyre, i cili shfaqet në Përparimet e Kërkimit Shkencor në Mikrobiologji, shkencëtarët analizojnë imazhet e marra nga reverët e NASA-s Opportunity dhe Curiosity, gjithashtu edhe nga kamera Hirise nga “Mars Reconnaissance”.

Objektet në fjalë tregojnë “ekzemplarë në

formë sferike me ngjyrë të bardhë”, për të cilin ekipi i Mars Opportunity fillimisht tha se ishte një mineral i quajtur hematit.

Studimet e mëvonshme hodhën poshtë pretendimin e hematit, raportojnë mediet e huaja.

Më vonë, disa shkencëtarë shpikën termin “kërpudha marsiane” për të përshkruar objektet misterioze, për shkak të mënyrës se si i ngjajnë likeneve dhe kërpudhave, derisa në një studim tjetër, ekspertët e kërpudhave dhe likeneve i klasifikuan si “kërpudha sferike”- kërpudha të bardha, sferike që i përkasin familjes Basidiomycota janë gjetur në planetin Tokë.

ZBULOHET NJË RADIO SINJAL NË ATMOSFERËN E VENUSIT

Anija kozmike e NASA-s Parker zbuloi diçka të pazakontë gjatë një fluturimi të afërt afër Venusit në korrik të vitit 2020.

Ndërsa ishte vetëm 833 kilometra mbi sipërfaqen e këtij planeti, ai regjistroi një sinjal radio me frekuencë të ulët që vinte nga atmosfera e Venusit.

Ne duhet të zhgënjëjmë ata që menduan se ishte zbulimi i një sinjali radio nga një civilizim i huaj që fshihej nën retë e dendura të këtij planeti. Gjegjësisht, sonda Parker vuri re një sinjal me origjinë natyrore, por kjo nuk do të thotë se nuk është interesante. Gjegjësisht, ky

zbulim konfirmoi se ciklet e yllit tonë ndikojnë në atmosferën e Venusit.

Kjo është hera e parë në pothuajse tre dekada që një anije kozmike ka qenë në gjendje të lexojë matjet direkte të atmosferës së sipërme të Venusit. Të dhënat që ajo mblodhi na japin një kuptim të ri se si Venusi ndryshon për shkak të ndryshimeve ciklike në Diell.

“Unë isha jashtëzakonisht i ngazëllyer kur mora të dhëna të reja nga Venusi”, tha astronomi Glyn Collinson i Institutit të NASA-s Goddard Space Flight Institute, sipas Science Alert.

'PLANETI I FERRIT'

Afërdita është një botë magjepsëse për ne tokësorët. Ai i ngjan planetit tonë për nga madhësia dhe përbërja, madje ka një atmosferë. Nga ana tjetër, është një trup helmues dhe me shkëlqim që është ndoshta plotësisht mikpritës për zhvillimin e jetës siç e njohim ne.

Agjencitë hapësinore nuk kanë dërguar shumë misione në atë planet. Nuk ka shumë kuptim të dërgosh rover sepse ata nuk mund të mbijetojnë në një sipërfaqe me temperaturë 462 gradë Celsius. Dërgimi i anijes në orbitën e Venusit është gjithashtu problematike për shkak të reve të saj tepër të dendura plot dioksid karboni dhe acid sulfurik.

Edhe pse Afërdita nuk është planeti më i afërt me Diellin, këtë pozicion e mban Mërkuri, ai është akoma më i ngrohti në sistemin diellor.

Anija kozmike Parker u gjet pranë Venusit krejt rastësisht, domethënë misioni i saj nuk kishte asnjë lidhje me atë planet. Në mënyrë që të afrohem sa më shumë me Diellin dhe të eksplorojmë misteret e yllit tonë, sonda përdori Venusin si një llastik gravitacional; domethënë e përdori gravitetin e saj për të ndryshuar shpejtësinë dhe trajektoren.

Në njërin nga ato mbikalime, instrumentet e sondës regjistruan një radio sinjal. Collinson vuri re diçka të pazakontë brenda sinjalit, por ai nuk mund ta kuptonte menjëherë se çfarë ishte.

"Kur u zgjova të nesërmen, mendova, 'O Zot, unë e di se çfarë është kjo!'", tha Collinson.

Një sinjal i ngjashëm u vëzhgua nga anija kozmike Galileo ndërsa kalonte nëpër jonosferat e hënave të Jupiterit; shtresat e atmosferës që kemi edhe këtu në Tokë, por edhe në Mars. Jonosfera është në të vërtetë një shtresë jonizuese në atmosferën e një planeti.

NDIKIMI I CIKLEVE DIELLORË

Kur shkencëtarët kuptuan se cili ishte sinjali, ata e përdorën atë për të llogaritur dendësinë e jonosferës së Venusit dhe krahasuan të dhënat me matjet e fundit direkte nga viti 1992.

Ekspertët besojnë se ky proces ka të bëjë me ciklet diellore. Çdo 11 vjet polet e Diellit ndërrojnë vendet; jugu bëhet veri, dhe veriu bëhet jug. Nuk është e qartë se çfarë i drejton këto cikle, por ne e dimë që polet ndryshojnë kur fusha magnetike e yllit tonë është më e dobët.

Matjet nga Toka treguan se jonosfera e Venusit ndryshoi në sinkron me ciklet diellore – u bë më e dendur me maksimumin diellor dhe më e rrallë me minimumin diellor. Por shkencëtarët nuk mund ta konfirmojnë këtë pa matje të drejtpërdrejta.


Kjo është arsyeja pse ky zbulim është kaq interesant. Matjet e vitit 1992 janë bërë në një kohë afër maksimumit diellor; dhe matjet e vitit 2020 afër minimumit diellor. Të dy matjet ishin në përputhje me matjet në Tokë.

DY SHPJEGIME KRYESORE

Tani për tani, nuk është plotësisht e qartë pse cikli diellor ka një efekt të tillë në jonosferën e Venusit, por ekzistojnë dy teori kryesore.

Njëra është që kufiri i sipërm i jonosferës gjatë minimumit diellor zbret në një lartësi më të ulët, e cila parandalon rrjedhën e atomeve jonizues nga dita në anën e natës, e cila nga ana tjetër rezulton në një jonosferë më të rrallë të natës. Sipas një teorie tjetër, jonosfera e Venusit gjatë minimumit diellor rrjedh më shpejt në hapësirë.

Të dhënat nga sonda Parker nuk mund të përjashtojnë asnjë nga këto mekanizma, por shkencëtarët shpresojnë që misionet dhe vëzhgimet e ardhshme mund të sqarojnë se çfarë po ndodh saktësisht këtu.





Ju ofron:

Kushte bashkëkohore,
ushqim cilësor dhe të kontrolluar,
staf të kualifikuar.

Ju mirëpresim!



Lagja Perash, Bulevardi Mehmet Pashë Plaku,
Pranë Xhamisë Perash, Shkodër

+355 67 47 39389

1 Staf arsimor cilësor

2 Kushte arsimore sipas standarteve të larta

3 Aktivitete sociale, kulturore dhe sportive

4 Klasa dhe laboratorë të kompletuar

5 Ambiente familjare në konvikt dhe cilësi në ushqim



CIKLI FILLOR

(djem dhe vajza)

NGA KLASA E **1**-RË
DERI NË KLASËN E **5**-TË

“Thuaj:
Nëse e doni Allahun,
më ndiqni mua,
në mënyrë
që edhe Allahu t’ju dojë
dhe t’ua falë
gjynahet tuaja.”

(Ali Imran, 31)